
Agjërimi i gjashtë ditëve nga muaji Shevval	2
Mbulesa në Gjermani – Ndërmjet tolerimit shoqëror dhe kundërshtimit politik	3
Viti i parë i dhunës	7
Sinqeriteti	12
Kërkimi i diturisë	15
Dhjetë mjete për të vazhduar në veprat e mira pas Ramazanit	16
Pas muajit të Ramazanit	17
Lamtumirë Ramazan	19
Agjërimi i gjashtë ditëve të Shevvalit dhe dobia e agjërit të këtyre ditëve ...	23
Kuptimi i dëshmisë së besimit	27
Abdullah Ibën Abbas në debat me Havarixhët	30
Gruaja - shoqe dhe bashkëshorte	39
Porositë e para për fëmijën	40
Vallëzimi i grave	41
Kur gruaja sfidon burrin e saj	44
Abdurr-Rezzak ibën Afifi ibën Atijje	45
AbdulAziz ibën Abdull-llah Ibën Baz	46
Abdull-llah Ibën Abbas	49
Tavus ibën Kejsan	52
Origjinat e shirkut	57
4. Sinqeriteti dhe prania e nijetit gjatë kryerjes së veprave	61

Agjërimi i gjashtë ditëve nga muaji Shevval

Prej shenjave të pranimit të veprave është ta shohish muslimanin në gjendje më të mirë se sa ka qenë para kryerjes së asaj vepre të mirë, dhe prej shenjave të agjëritit të pranuar është shtimi i veprave të mira. Një nga këto vepra është edhe agjërimi i gjashtë ditëve nga muaji Shevval (muaji i dhjetë sipas kalendarit islamik, muaji pas Ramazanit).

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, preferonte dhe nxiste të agjërohen këto ditë.

Ebu Ejub El-Ensariu, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Kush e agjëron muajin Ramazan dhe e pason me agjërim të gjashtë ditëve të Shevvalit, i konsiderohet sikur të agjëron tërë vitin".

Ky agjërim bën pjesë në agjërimet vullnetare dhe është sunnet i argumentuar me këtë hadith. Poashtu nga ky hadith kuptojmë se mund ti agjërojmë këto ditë pandërprerë por edhe të ndara, ngase fjalët e këtij hadithi janë të përgjithshme.

Ramadan Ramadani

edicion i botuar / viti i parë / nr: 4

botues: ALBISLAM

kryeredaktor: Ramadan Ramadani

redaksia: Bekir Halimi, Talha Kurtishi, Alajdin Idriz

redaktor teknik: Azem Zaimi

www.albislam.com

albislam@albislam.com

str: 386 no: 11 lokal: 44

1000 Shkup

fax: +389 2 3290 408

Mbulesa në Gjermani – Ndërmjet tolerimit shoqëror dhe kundërshtimit politik

Më se 6 vjet me rradhë i ngjiti mësuesja muslimane Fereshta Ludin shkallët e hierarkisë juridike gjermane, për të kërkuar që të japë mësim në shkollat fillore me mbulesë. Me vendimin e datës 24 shtator 2003, Gjykata Kushtetuese Federale (GjKF) e Gjermanisë i dha asaj të drejtë: në Landin Baden-Württemberg – vendin, të cilin zj. Ludin e konsideron si vendlindjen e saj të zgjedhur vetë – nuk ka asnjë bazë ligjore, e cila ua ndalon mësuesëve të japin mësim duke qenë të mbuluara. Pavarësisht nga ky vendim, e ardhmja e znj. Ludin për sa i përket punësimit në sektorin shtetëror mbetet e hapur, duke qenë se GjKF me këtë vendim ua kaloi çështjen përsëri parlamenteve të Landeve për të vendosur me ligj se a do u lejohet apo jo mësuesëve muslimane të japin mësim të mbuluara. Sidoqoftë GjKF bëri të qartë me këtë vendim, se çdo ligj i tillë nuk guxon të prekë vetëm mësueset muslimane, por edhe të tëra simbolet dhe veshjet fetare, qofshin ato veshjet e murgeshave ose të murgjve dhe priftërinjve, qoftë edhe vetë mbulesa e kokës e mësuesve çifutë.

Për lexuesin shqiptar dhe për çdo njeri, që nuk e njeh sistemin politik gjerman, duhen sqaruar këtu disa gjëra.

Sistemi politik gjerman është sistem federal. Ky fakt ka si rrjedhojë, që Gjermania ndahet në 16 Lande, secili prej tyre me një qeveri dhe me ministri të veçanta. Politika

arsimore, ajo e brendshme dhe ligjore bien në përgjegjësinë e qeverive të Landeve. Prandaj është krejtësisht e mundshme, që në një Land mbajtja e mbulesës nga mësueset në shkollat shtetërore të jetë e lejuar, ndërkohë që në një tjetër e njejtja gjë të jetë e ndaluar. Në këtë rast bëhet fjalë vetëm për mësueset në shkollat shtetërore, të cilat gëzojnë statusin e nëpunësëve të shtetit. Nuk flitet pra për shkollat private. Gjithashtu nuk diskutohet as për mbulesën e nxënësëve, gjë e cila është krejtësisht e lejuar në të tërë Gjermaninë. Poashtu GjKF i dha të drejtë një shitëseje muslimane, e cila ishte kthyer në vendin e punës e mbuluar dhe me këtë rast u përjashtua nga puna, me arsyetimin, se mbulesa do të kishte pasoja negative për dyqanin. Me këtë vendim është sqaruar, se mbulesa si akt i praktikimit të së drejtës së besimit nuk mund të jetë shkak për pushim nga vendi i punës. Ajo që e bën të sikletshme çështjen e znj. Ludin është fakti, se shteti është i detyruar të mbajë qëndrim neutral në pikpamjet fetare. Modeli sekular gjerman ndryshon nga modeli laicist francez ose ai turk, pasi neutraliteti i shtetit praktikohet si një bashkpunim i shtetit me bashkësitë fetare, pra nuk do të thotë përjashtimin e plotë të besimit nga sfera shtetërore dhe kontrollin e këtij të fundit mbi fenë. Nga kjo politikë neutrale e shtetit gjerman muslimanët përfitojnë më shumë sesa nga

vetë politikat e disa vendeve tradicionalisht muslimane, si Turqia ose edhe Shqipëria. Rasti më i mirë për këtë neutralitet është mesimi fetar në shkollat shtetërore, i cili garantohet me kushtetutë dhe jepet si mesim besimi ose si komunikim i një të vërtete absolute, dhe jo si lëndë relativuese ose krahasuese, histori feje etj. Për fat të keq, muslimanët në Gjermani nuk përmbushin kushtin e dhënies së këtij mesimi, pasi ata nuk kanë arritur të organizojnë një bashkësi fetare, e cila do të ishte e përgjegjshme dhe partner i shtetit jo vetëm për këtë mesim, por edhe për të gjitha çështjet që prekin muslimanët në gjermani, përfshi edhe çështjen e mbulesës.

T'i kthehemi çështjes Fereshta Ludin. Ajo ka lindur në vitin 1972 në Kabul, Afganistan si vajzë e një diplomati dhe ish-ministri të brendshëm afgan. Jeton në Gjermani që nga viti 1985 dhe është e martuar me një gjerman musliman. Që nga viti 1995 znj. Ludin është nënshtetase gjermane. Në verën e vitit 1998, pak kohë pas përfundimit të Praktikës pedagogjike me notën 1,8 (nota më e lartë=1; më e ultë=5), Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit e Landit Baden-Württemberg i deklaroi, se ajo nuk mund të vihej në punë si mësuese, për sa kohë do të këmbëngulte në mbajtjen e mbulesës. Këtij qëndrimi iu bashkangjiti edhe ministria e arsimit e këtij Landi, znj. Annete Schavan, e cila njëkohësisht është edhe nënpresidente e Komitetit Qëndror të Katolikëve. Një vit më parë po kjo ministre i ishte kundërvënë vendimit të po kësaj drejtorie për ta larguar znj. Fereshta Ludin nga Praktika me argumentin, se muslimanes i duhej dhënë mundësia ta përfundonte shkollimin e saj. Kurse tani argumenti i përbashkët ishte, se gjoja mbulesa qenka edhe vetë brenda Islamit simbol kufizimi dhe distancimi dhe si i tillë simbol politik.

Këtë pozicion mbështetën edhe tre gjykata, pavarësisht nga vështirësitë e shkaktuara nga avokati i znj. Ludin: në Shtutgart jep mesim që prej 5 vjetësh një mësuese e mbuluar pa patur problem; po në të njëjtin Land punon si mësuese një murgeshë – e mbuluar! Megjithatë, as këto fakte nuk ndryshuan gjë në qëndrimin e gjykatave. Ndërkohë znj. Ludin jep mesim në një shkollë private në Berlin të financuar nga një bashkësi islame.

Sidoqoftë, znj. Ludin nuk ka qenë e para, e cila ka ecur rrugën e gjatë të gjykatave. Përveç rastit të sipërpërmendur të shitëses muslimane ka patur edhe disa raste të tjera, në të cilat gjykatat gjermane në pjesën më të madhe u kanë dhënë të drejtë muslimaneve për mbajtjen e mbulesës. Kështu Gjykata e Punës i ka dhënë të drejtë një edukatoreje kopshti të punojë e mbuluar. Gjithashtu në Landin e Hamburgut dhe në Nordrhein-Westfalen – Landi më i populluar dhe me një popullsi të konsiderueshme muslimanësh – ka disa mësuese, që japin mesim të mbuluara në shkolla shtetërore. Kjo tregon, se në Gjermani nuk zotërojnë kondita franceze, të cilat po i përjetojmë në këto momente në rastin e dy motrave me baba çifut dhe nënë me origjinë algjeriane, të dy afetarë. Duhet thënë, se, pas gjithë propozimeve qesharake nga ana e këshillit të mësuesve – p.sh. mbulesa do të ishte e lejueshme, nëse vajzat do të nxirrnin në pah balluket, veshët dhe qafën – në rastin e tyre vendimi për t'i përjashtuar nga shkolla nuk është marrë nga këshilli i mësuesve vetë, por ka qenë një direktivë nga qeveria. Por për të përjetuar konditat franceze, muslimanet nuk kanë nevojë të shkojnë deri në Francë, por mund ta përjetojnë një presion të ngjashëm edhe në Turqi ose Shqipëri. Në krahasim me këto vende, Gjermania akoma është oaz sigurie

juridike për sa i përket mbulimit të muslimanëve, pavarësisht se tendenca e këtij debati i shqetëson muslimanët me të drejtë.

Konteksti shoqëror, në të cilin u zhvillua procesi gjyqësor i znj. Ludin ishte në njëri anë ai i një frike ndaj të huajve në Gjermani. Në anën tjetër procesi gjithashtu u ndikua nga konteksti i politikës së barazimit të grave. Ky fakt solli në skenë një femine ekstreme gjermane si Alice Schwarzer, e cila në mbulesën e grave muslimane sheh një shenjë të shtypjes së grave prej burrave. E përballur me pohimin e znj. Ludin, se mbulesa përbën një aspekt të personalitetit të saj, kjo femine e akuzoi znj. Ludin, se po e përdorte mbulesën si akt politik, gjë që u mohua nga znj. Ludin.

Një kontekst tjetër ishte gjithashtu edhe ai i marrëdhënies ndërmjet shtetit dhe feve. Në seancën e hapjes në korrik 2003, kryegjykatësi kushtetues deklaroi, se në këtë proces do të vendosej ndër të tjera, se sa fe të huaj duron shteti gjerman. Kjo deklaratë, e cila u pranua si e tillë nga publiku gjerman, është problematike, sepse implikon, se Islami është shenjë e një shoqërie të huaj në dallim me Krishtërimin si shenjë dalluese e shoqërisë vendase. Kjo përsëri nuk merr parasysh, se përveç gjermanëve muslimanë të konvertuar, të cilët janë mbi 100.000, numri i shtetasve gjermanë me besim islam po rritet mbi 1 milion me anë të gjeneratës së dytë dhe të tretë me origjinë turke dhe nënshtetësi gjermane. Prezenca e këtyre njerëzve me nënshtetësi gjermane, por paraqitje, zakone dhe besim të ndryshëm nga "Shtamkultura" – kështu e karakterizoi njëherë një politikan demokristian kulturën vendase në dallim nga kulturat e tjera; kjo fjalë mund të përkthehet pak a shumë me "kulturë origjinale" ose "vendase" – aktualizon përsëri çështjen e integritetit të të huajve, aq e shu-

mëfolur dhe gjithëprezente në qarqet politike gjermane. Aq gjithëprezente sa është, po aq e padefinuar dhe e paqartë mbetet. Jo vetëm politika, por edhe pjesa më e madhe e muslimanëve e pohojnë dhe pranojnë parimisht integrimin në shoqërinë gjermane. Por mungesa e një politike dhe koncepti të qartë mbi integrimin ka bërë, që thirrjet për integrim nga ana e politikës të interpretohen jo pa bazë edhe si tentim për asimilim të popullsisë muslimane në Gjermani. Është interesant për t'u përmendur fakti, se integrimi i fundit i suksesshëm në Gjermani ka qenë ai i çifutëve të paraluftës së parë botërore. Ky integrim ka qenë aq "i suksesshëm", sa që çifutët gjermanë e shihnin veten si të sekularizuar dhe në rradhë të parë si gjermanë në dallim nga çifutët e europës lindore, të cilët e karakterizojnë veten në rradhë të parë fetarisht dhe etnikisht si çifutë. Ky dallim çoi deri aty, sa që çifutët e Mynihut ishin kundër mbajtjes së kongresit të parë cionist në Mynih, e që për këtë arsye u mbajt në Bazel të Zvicrës, pasi ata e shihnin Gjermaninë si atdheun e tyre dhe kombin gjerman si kombin e tyre, e jo Palestinën dhe çifutët e mbarrë botës. Mund të thuhet, se tek çifutët gjermanë të asaj kohe kishte ndodhur ajo, të cilën shumë muslimanë sot duan ta shmanjin: asimilimi. Vetëm Lufta e Dytë botërore dhe holokausti i dhanë fund këtij asimilimi të suksesshëm. Ndërkohë debati për integrimin e muslimanëve sa ka filluar. Sidoqoftë, në mungesë të një politike të qartë ndaj të huajve, ndaj muslimanëve dhe ndaj besimeve fetare, ky debat ka pak shanse që të japë fryte.

Për t'iu kthyer edhe njëherë çështjes Ludin pas këtij ekskursi: vedimi i GjKf ishte një fitore e vogël dhe e njëherëpërnjëherëshme për znj. Ludin. Gjykata vendosi, se znj. Ludin është cënuar në të drejtat e saj, të cilat

rrjedhin nga Ligji Themelor gjerman (Art. 33), i cili garanton për çdo gjerman dhe çdo gjermane në të gjithë vendin të njejtat të drejta dhe detyra. Gjithashtu këto të drejta, gjithnjë sipas vendimit të Gjykatës në bazë të Ligjit Themelor, dhe pranimit në detyrat shtetërore janë të pavarura nga përkatësia fetare e personit në fjalë; dëmet për shkak të përkatësisë fetare janë të papranueshme. Mbajtja e mbulesës në mesim nga znj. Ludin garantohet nga e drejta themelore e lirisë së besimit, e quajtur ndryshe e drejta pozitive e besimit. Këtu vlen parimi, se të drejtat themelore mund të shfuqizohen vetëm nga të drejta të tjera themelore me më shumë peshë. Për këtë rast, Gjykata përmend të drejtën themelore të detyrës së prindërve për edukim të fëmijëve si edhe të drejtën e vetë nxënësve për liri negative të besimit, dmth lirinë për të mos qenë nën ndikimin e një besimi. Gjithashtu përmendet, se neutraliteti i shtetit nuk do të thotë një ndarje të rreptësishme ndërmjet shtetit dhe fesë, por një qëndrim, i cili inkurajon të gjitha pikpamjet fetare dhe shekullore. Prandaj edhe shkollat duhet të jenë të hapura jo vetëm ndaj ndikimeve të krishtera, por edhe ndaj vlerave të tjera fetare dhe shekullore. Kështu interpretohet sipas gjykatës më të lartë gjermane marrdhënia ndërmjet shtetit dhe fesë, një marrdhënie, e cila mund të shërbente si shembull edhe për vende të tjera europiane si Franca, Shqipëria, por edhe Turqia. GjKF, siç shihet, ka shmangur një përgjigje përfundimtare, duke ua kthyer barrën e vendimit mbi mbulesën e mësueseve muslimane politikës dhe parlamenteve të Landeve. Çështja do të varet kështu nga raportet partiake në parlamentet përkatëse. Sidoqoftë duhet thënë, se të tëra partitë politike gjermane deklarohen kundër mbulesës së mësueseve muslimane. Si tek socialde-

mokratët, ashtu edhe tek demokristianët, liberalët dhe të gjelbërit mbizotëron mendimi, se mbulesa e mësueseve duhet ndaluar me ligj. Edhe socialdemokratët, të cilët qeverisin Landin Nordrhein-Westfalen me popullsinë më të konsiderueshme muslimane, kanë sinjalizuar, se ka nevojë për rregullim ligjor. Kjo do të shkaktonte probleme për mësueset e shumta me mbulesë, prej të cilave njëra është drejtoreshë e një shkolle. Përgatitjet për ligje për ndalimin e mbulesës së mësueseve kanë nisur tashmë në shumë Lande. Pak prej tyre kanë deklaruar, se nuk kanë nevojë për ndalesa të tilla, pasi ose nuk shohin probleme me mësueset muslimane të mbuluara, ose këto nuk egzistojnë në këto Lande. Sidoqoftë, duhet sqaruar, se cilido Land, i cili sjell një rregullim ligjor të çfarëdo forme, do të prekë në bazë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese jo vetëm muslimanet, por edhe veshjet e murgeshave, të çifutëve, kryqet në qafat e mësuesve dhe çfarëdo lloj simboli. Çdo ndalesë do të vlejë për të tëra bashkësitë fetare, përndryshe do të jetë antikushtetuese dhe do të përfundojë përsëri para Gjykatës. Kjo vlen edhe për ndalesat e simboleve fetare në sektorin administrativ, të cilat po planifikohen paralelisht në disa Lande.

Juristët gjermanë paralajmërojnë për pasojat, të cilat mund të sjellë debati i komplikuar mbi simbolet. Ky debat është i pafund për shkakun se edhe vetë pas një ngjyre mund të dallohet një simbol, i cili si i tillë duhej ndaluar. Ndërkohë një nga pozicionet më radikale mbahet nga Kisha Protestante, e cila tek mbulesa sheh një shenjë antikushtetuese, gjë që e shpall znj. Ludin dhe të tëra mësueset muslimane me mbulesë si armike të kushtetutës. Nga ky pozicion deri tek qëndrimi i feministeve ekstremiste, sipas të cilave mbulesa është shprehje e shtypjes

së guas prej burrit dhe e agresionit të këtij të fundit, s'është veçse një hap. Por nuk mungojnë as zërat në publikun jo-musliman gjerman, të cilët pohojnë kuptimin emancipues të mbulesës, shpesh duke kuptuar edhe lidhjen ndërmjet rolit të mbulesës në shoqërinë e parë muslimane në Medinë dhe kontekstit të sotëm të ndërgjegjësimit, të cilin po e përjetojnë muslimanët dhe muslimanet.

Problemi kryesor në marrëdhëniet ndërmjet muslimanëve dhe shoqërive jomuslimane, në të cilat ata jetojnë, është niveli i akceptancës i shumicës jomuslimane ndaj tyre. Kur ky nivel është shumë i ulët, si në rastin e mospranimit parimor të mbulesës nga politika – por jo nga shoqëria gjermane, në shumicën e së cilën mbizotëron një spektër i gjërë mendimi nga indiferenca deri në praninë –, në rast akceptance të ulët pra nuk

mbetet tjetër veçse t'i besohet çështja një instance, e cila tradicionalisht gëzon mirëbesimin e shoqërisë dhe të politikës dhe ka aftësi për të krijuar akceptancë. Një instancë e tillë në Gjermani është Gjykata Kushtetuese Federale, e cila kishte rastin dhe mundësinë ta integronte mbulesën si pjesë përbërëse të shtetit, por iu shmang këtij vendimi, duke hapur një debat, i cili për shkak të sistemit federal gjerman do të shpallet në 16 fronte të ndryshme. Është e kotë të shpresosh, se në fund të këtij debati politik do të ketë një happy-end, pasi politika gjermane që tani ka sinjalizuar, se ndalesat do të prekin vetëm muslimanet, dhe jo besimet e tjera. Në këtë pikë mbetet për të shpresuar, se kjo çështje do të zgjidhet në mënyrën më të mirë për muslimanet në të njëjtin vend, i cili s'pati guximin ta ndërmerre këtë hap që herën e parë.

Egin Ceka

Münster, Gjermani

07.11.2003

Viti i parë i dhunës

Këndvështrim sociologjik i dhunës

Secili njeri i mençur dhe mendjeprehtë në shoqëri refuzon dhunën si mjet për të zgjedhur mospajtimet në shoqërinë tonë, pa marrë parasysh arsyetimet e tija, sepse dhuna le pas vehte vetëm rrënim dhe se nga therrat nuk mundesh të vjelish rrushin.

Edhe përkaj shpërthimeve trishtuese që ndodhën në Rijad, ato janë në fillimin e vet dhe ka mundësi të zotërohen, me lejen e Allahut.

Dhuna në shoqëritë tona është një dukuri e re, edhe pse në të kaluarën ka pasur disa

ndodhi, siç ishin shpërthimet në Uleja, para disa viteve ose në Huber, mirëpo këto nuk i bënë shpërthimet një dukuri.

Kurse rastet e dhunës të njëpasnjëshme në vitin e fundit e bënë këtë dukuri një fenomen i cili e çrehaton të mençurin.

Kjo dukuri mundet të varroset në lindjen e saj, mirëpo edhe mundet të zhvillohet dhe të prodhon prodhimet më të këqija, e të vuan shoqëria, të rrënohet dhe të humbë sigurinë dhe qetësinë.

Dhuna kur ndodh në shoqëri, lajmëron praninë e rrezikut në këtë shoqëri, aludon

në praninë e divergjencave në mendim dhe në mosekzistimin e kanalit të shërimit të divergjencave, andaj ata që kanë mendime të kundërta përdorin dhunën për të eliminuar dallimin në mendime.

Ndoshta vendimi më i rëndë në dhunë është vendimi për transferim të civilit në luftëtar. Kurse akcionet e shpërthimit dhe ballafaqimit me armikun dhe vrasja, ato janë sjellje e zakonshme, të cilat i bën ai që e merr këtë vendim.

Ashtu sikurse ushtari stërvitet për të hyrë në betejë dhe i zhvillon përvojat e tija, kurse ushtria realizon se si duhet dhe shpik metoda të luftës, me hyrjen e tij në luftë, i tillë është edhe ai që e merr dhunën mënyrë të zgjedhjes së mosmarveshjeve, ai zhvillohet me ballafaqimet militante.

Ai që dëshiron ta eliminojë dhunën nga shoqëria, duhet ta bind, atë që anon kah dhuna, në dobinë e sjelljes civile dhe se është më meritorë për zgjedhjen e mosmarveshjes. Kjo kërkon të zhvillojmë raportet tona civile, sepse zhvillimi i tyre pakëson hapësirën e dhunës. Kjo është e mundur të ndodh në shoqërinë tonë, sidomos tani pasi që dhuna është akoma në fillimin e saj dhe se shoqëria jonë akoma është në 'vitin e parë të dhunës'. Këtë dukuri mund ta shërojnë njerëzit e mençur para se të zmadhohet dhe zhvillohet insitucioni i dhunës në shoqëri, kurse këto institucione nuk zhvillohen ndryshe përveç se me dhunë dhe luftime të brendshme.

Dhuna bazohet në dy parime të rezikshme:

- mendimi ose ideologjia e dhunës
- veprimi për të zbatuar ideologjinë e dhunës. Kjo në këtë rast është infrastruktura organizative e dhunës.

Ideologjia e dhunës, pa marrë parasysh se nga cila anë buron, a është grup, xhema, ose opozitë, ose qeveri, nga muslimanët ose

jomuslimanët, bazohet në tre çështje kryesore:

- Klasifikimi;
- Kundërshtimi;
- Dënimi.

Klasifikimi domethënë të cilësosh tjetrin me gjëra që e kundërshtojnë unën e tënd.

Kundërshtimi domethënë cilësimi i hasmit me njërin nga dy cilësitë: tradhti ose kufër.

Dënimi domethënë vrasja.

Pa marrë parasysh degëzimet ideologjike të dhunës dhe pa marrë parasysh polemikën që e ndihmon, qëllimi është arritja deri te këto tre çështje.

Infrastruktura organizative është ajo që i realizon dënimet.

Mirëpo hetohet se me shtimin e ashpërsisë së konfliktit, pakësohen rregullat morale në zbatimin e denimeve kundër hasmive. Kjo shkakton zgjerimin e qarkut të atyreve që i kaplon dënimi, kurse infrastruktura organizative përdor çdo lloj arme për të realizuar qëllimin e vet, pa marrë parasysh vlerat morale.

Për shembull, Izraeli i sulmon individat e pafajshëm palestinez me helikopterë Apaçi dhe aeroplanë F16. Kjo sjellje nuk përputhet me parimet morale, ashtu sikurse nuk përputhet me moralin ushtarak.

Ajo që duhet ta sundon ideologjinë e dhunës dhe mos ta lejojë që të bëjë zullum janë rregullat morale. Andaj sherijati ka ardhur me kërcënime të ashpra dhe insistim të madh për siç është realizimi i marrëveshjes, largimi nga mashtrimi, përcaktimi i atij që e meriton vrasjen, etj. Po mos të ishin këto rregulla do ta rëndonte krahu ushtarak atë civil.

Ideologjia e dhunës zakonisht nuk ka legjitimitet vetvetiu, mirëpo atë e merr nga sjellja e vet armikut. Gjatë konfliktit zhvillohet fuqia e klasifikimit dhe dallimit nga armiku dhe qëndrimet praktike shndërohen në

çështje ideologjike dhe parime që e zotërojnë sjelljen e infrastrukturës organizative dhe me të gjitha këto paraqet identitet të saj.

Nëse me vëmendje shikojmë aspektin fetar në këtë kontekst do të kuptojmë shkakun e vonimit të lejës për luftë në islam, pasi që kaluan trembëdhjetë vite në thirrje po në të njëjtën ide.

Zgjerimi i hapësirës së konfliktit jo që vetëm e themelon ideologjinë e dhunës, por e themelon edhe vet organizatën dhe i shtyn individët tjerë të shoqërisë që ti bashkangjiten këtij institucioni të dhunës.

Rruga për ta çveshur nga legjitimiteti i ideologjisë dhe rrëzimi i identitetit nuk është konflikti por zbutja e konfliktit, sepse konflikti e zgjeron hapësirën e elementeve dalluese, e kjo shton dallimin, kurse zbutja e konfliktit e pakëson hapësirën e gjërave të dalluara, ndoshta edhe e shton hapësirën e gjërave unike. Zgjerimi i gjërave unike dhe vetëdija për to e dobëson legjitimitetin e ideologjisë së dhunës dhe ia merr identitetin e organizatës së dhunës.

E përfundoj këtë bisedë mbi zhvillimin e dhunës me vërejtje në dy çështje:

Një: Zhvillimi i ideologjisë së dhunës dhe organizatës së saj mund të merr disa vite, ndoshta edhe nuk merr shumë kohë, kjo mvaret nga ashpërsia e dhunës dhe reagimet e të konfliktuarve.

Dy: Këtë që thash për zhvillimin e dhunës i kaplon dy palët në konflikt, qeverinë dhe xhematet e ndara nga shoqëria.

Kjo është një pjesë e zhvillimit shoqëror të institucionit të dhunës, mirëpo çka për ne në Saudi?

Shoqëria saudite sikurse thamë në fillim është akoma në 'vitin e parë të dhunës' dhe ka mundësi të ik nga kalimi në atë që vijon, mirëpo ashtu sikurse viti i parë i dhunës i ka veçoritë e saja, i ka edhe rreziqet e saja.

Para se të fillojmë të flasim për këtë temë, dëshiroj të potencoi se ne, këtu, flasim për dhunën që ndodh mes shteteve, cilido shtet, dhe grupacioneve militante dhe ideologjike, të cilat veprojnë për t'ua imponuar shoqërisë, e nuk flasim për dhunën e cila nuk buron nga ideologjia.

"Çështja e dhunës" për të cilën flet ky artikull zakonisht është një pjesë tematike e ideologjisë së dhunës. Është problemi rreth të cilit themelohet ideologjia e dhunës, ose është e drejtë e privuar në shoqëri, e cila i mungon një grupacioni dhe vepron për ta rikthyer.

Pasi që çështja e dhunës mund të jetë çështje e pranuar nga një pjesë e gjërë e shoqërisë, pasi që është çështje e prekshme, të gjith mund ta shohin, për këtë është hapësirë e dialogut mes grupacioneve të dhunës dhe mes shtresave të synuara të shoqërisë. Pranimi i këtij elementit mund t'ia lehtësojë ideologjisë.

Shembull, çështja e dhunës në organizatat komuniste buron nga dallimi klasor, kurse marksizmi është ideologjia e cila e shëron dallimin kalsor. Një njeri mund të konfirmon dallimin klasor në një shoqëri, sepse, siç thash, është çështje konstruktive, mirëpo nuk i dorëzohet zgjidhjes marksiste.

Shembull tjetër: dhuna në Algjeri buroi nga anulimi i zgjedhjeve. Është çështje konstruktive, të cilës i dorëzohen shumica e shoqërisë, mirëpo për shërimi i kësaj çështje njerëzit kanë pikëpamje të ndryshme. Përdërisa grupacionet e dhunës në Algjeri shohin se zgjidhja qëndron në xhihad ose luftë kundër pushtetit, të tjerët kanë pikëpamje tjera.

Pra, çështja e dhunës është çështje e përgjithshme dhe konstruktive, zakonisht, kurse ideologjia e dhunës, është pikëpamje e një grupacionit të shoqërisë në shërimin e kësaj çështjeje.

Çështja e dhunës zakonisht ka përmbajtje ideore dhe të të drejtave, dhe ka veçori të përgjithëshme:

1- Është çështje, e cila nuk është tërësisht e kotë, por ka një pjesë të të vërtetës, sado që është kjo sasi e vogël. Kjo pjesë grumbullon përkrahës nga shoqëria, të cilën e synon, ndoshta edhe gjen pranim masiv edhe bëhet çështje popullore.

2- Çështje që zhvillohet me zhvillimin e ideologjisë së dhunës. Shembull: ndoshta kjo çështje fillon me një çështje konstruktive siç është kërkesa e të drejtave të pakicës, probleme për të cilat mund të negociohet, e të përfundojë me refuzim të tjetrit dhe me kërkesa për pavarësi totale.

Zhvillimi i çështjes së dhunës parimisht mbështetet në natyrën e konfliktit me palën tjetër dhe sjelljes me të vërtetën të cilën e përmban çështja e tij.

3- Nuk është veçanti e atij që zbaton dhunën. Por është një gjë, në të cilën mund të participojë edhe tjetërkush, madje mund të jetë edhe tërë shoqëria, ose vetëm një grup i veçantë: qoftë grupacion ideologjik, racor, ose rajonal. Mirëpo ata që mund të pajtohen me grupacionet e dhunës në çështjen e dhunës ndoshta nuk pajtohen me ta në përdorimin e dhunës në realizimin e kërkesave të tyre dhe anulimin e asaj që e shohin padrejtësi ndaj tyre.

Kjo palë është hapësira e konfliktit të vërtetë mes grupacioneve të dhunës dhe qeverive. Nëse një grupacion i dhunës arrin sukses në arritjen deri te bindja e tyre në këtë çështje, në këto mjete për të realizuar këto të drejta, domethënë vazhdimi i dhunës dhe prania e përkrahësve të dhunës, të cilët u japin përkrahje morale dhe logjistike. Sukses i qeverisë për të arritur te ata, për ti bindur se kjo çështje nuk është reale dhe se kjo metodë është e gabuar, domethënë izolim

të grupacionit të dhunës dhe pengesë mes tyre dhe popullit, kjo domethënë përfundim të dhunës.

Çështja e dhunës zakonisht është çështje konstruktive e cila është e ndarë nga vet dhuna dhe shprehja e saj me dhunë është një prej zgjidhjeve të llojllojshme. Mund ta shprehim me metodë paqësore, me aktivitet politik, mirëpo pasiqë kjo është bërë e pamundshme, atëherë këta njerëz kanë zgjedhur metodën e dhunës.

Shembull: prej kërkesave të pakicës kurde në turqi është pranimi i nacionalitetit kurd dhe dhënia leje për të mësuar në gjuhën e tyre në shkollat shtetërore. Këto janë kërkesa civile që s'kanë të bëjnë me dhunën. Këto mund ti shprehin me llojloj mënyrash të shprehjeve civile. Mirëpo pasiqë u bë e pamundshme për ta kjo mënyrë, disa kurd përdorën metodën e dhunës.

Ata që nuk e përkrahin këtë kërkesë janë shumë, mirëpo jo secili që e përkrah kërkesën e përkrah edhe realizimin e tij me dhunë.

Dallimi mes dhunës dhe "çështjes së dhunës" është i domosdoshëm për të pakësuar dhunën dhe për ta zotëruar atë.

Nëse reagimi i forcave të sigurimit është i domosdoshëm në pengimin e krimit, ajo aspak ska fuqi në shërimin e çështjes.

"Çështja" e dhunës hyn në çështjet e mendimit dhe shërimit të tij. Duhet të jetë vetëm brenda këtyre suazave. Reagimi ndaj tyre me metoda të forcave të sigurimit, kjo mënyrë atë e bën kriminale, edhe pse ajo në vehte nuk është e tillë. Kurse shtresën që ka të bëjë me këtë çështje i konsideron kriminel ose në rrugën e realizimit të krimit. Kjo mund të shkakton që të solidarizohen me dhunën dhe thirrësit e sajë.

Ti kthehem shembullit që e përmendëm për kurdët në Turqi. Për shkak të shërimit me forca të sigurimit të çështjes së kurdëve,

shumë kurdë janë të akuzuar, madje ndoshta edhe të gjekuar dhe i ekspozohen dënimeve. Shumë herë kemi dëgjuar se ushtria turke është futur në vendet dhe fshatrat e tyre dhe i ka denuar kolektivisht. Shkaku i kësaj është mos dallimi mes çështjes për të cilën ka buruar dhuna dhe vet dhunës. Çështja kurde mund të shërohet larg nga zhurma e armës dhe shpërthimeve. Ky shërim është i vetmi që i pengon thirrësit e dhunës. Dhuna e qeverisë është ajo që u jep legjitimitet grupacioneve të dhunës.

Grupacionet e dhunës sa do që janë, kanë tre qëllime:

a) Ta bëjnë dhunën dukuri në shoqëri duke i përsëritur rastet e dhunës, sepse përsë-

ritja e rasteve sinjalizon ekzistimin e këtyre grupacioneve dhe praninë e tyre.

b) Mobilizimin e individëve të shoqërisë në çështjen e dhunës.

c) Realizimin e kërkesave të tyre dhe ngadhënjimi i çështjes për të cilën veprojnë. Qëllimi i fundit është rezultat i veprimeve të dhunës.

Qeveria e cila reziston dhunën, pa marrë parasysh se çfarë është, poashtu ka tre qëllime:

a) Çvlerësimi i çështjes së dhunës.

b) Izolimi i grupacioneve të dhunës nga shoqëria.

c) Ndalja e dhunës, e ky qëllim është rezultat i rezistencës së dhunës.


Dr. Abdull-Ilah Subejhi

Mbretëria e Arabisë Saudite

Marrë nga: www.islamtoday.net,

Përktheu: Bekir Halimi

21.11.2003



Sinqeriteti

Shumë njerëz e kuptojnë sinqeritetin si sinqeritet të gjuhës përmes të folurit vetem. Në realitet sinqeriteti është një kurrikulum i gjërë.

Kjo nuk është më shumë se njëra nga karakteristikat e personalitetit të muslimanit në të dyja përbrenda dhe perjashta; siç është të folurit e tij dhe veprat e tij.

Nga këto janë si vijojnë:

a. Sinqeriteti në transmetimin e fesë:

Kjo është, personi duhet të deklarojë hapur besimin e drejtë të ndërtuar mbi sinqeritetin ndaj All-llahut, subhanehu ve te'ala, e jo mbi hipokrizinë, mashtrimin apo mendjemadhësinë.

Kjo është pse sinqeriteti është përmendur në Kur'an si e kundërta e hipokrizisë.

“All-llahu do të shpërblejë të sinqertët për sinqeritetin e tyre dhe do të ndëshkojë hipokritët nëse ai dëshiron ose të kthehet i mëshirshëm drejt tyre.....”

Prandaj është e nevojshme të posedojmë islamin e jashtëm dhe imanin e brendëshëm është e nevojshme pëer të pasur një besim korrekt ne All-llahun, Ditën e Gjykimit, Engjujt, Librat dhe të dërguarit.

Paraqitja e jashtme duhet të konfirmojë atë të brendëshme.

Këtu është njëra nga cytjet e djallit i cili inspiron tek thirrësi në islam të neglizhojë disa vepra të jashtme nën pretendimin që realiteti i brendëshëm nuk është i tillë.

Kështu që ai i largohet kësaj në mënyrë që ti largohet mashtrimit të njerëzve .

Ky është një gabim shumë i madh. Veprat e mira që ju bëni nga jashtë është keshtu për shkak të sinqeritetit dhe drejtësisë së zemrës tuaj të gjatë sa ju nuk bëni atë për reputacion ose në mënyrë për të mashtruar besimtarët.

b. Sinqeriteti në të folurit:

Sinqeriteti në të folur shpreh një personalitet dinjitoz, burrëri, përgjegjësi dhe bujari. Askush nuk do të vazhdonte të gënjente vetëm nëse ai ka një natyrë imorale, një nefs imoral dhe një personalitet të dobët.

Nje individ me natyrë të mirë refuzon të gënjejë dhe të rivazhdojë në të, i cili është shkaku që të gjitha [shpalljet] kanë rënë dakord mbi ndalimin dhe dënimin e gënjeshtërës.

Disa thirrës në islam mund të hyjnë në paqartësi duke bërë disa dëshmi të cilat disa njerëz i keqkuptojnë atëherë më vonë ata mund të gjejnë të kundërtën e asaj çfarë keqkuptuan.

Atëherë ata e akuzojnë atë për gënjeshtër.

Në një anë paqartësia mund të dërgojë në pranimin e disa gënjeshtrove të vogla nën pretendimin që ata janë të nevojshme.

Kështu bëhu i vëmendshëm!

Nëse gjendesh në një situatë e cila do të shtyjë të gënjeshtër shmangiu asaj dhe kujto fjalët e Ebu Sufjanit përpara Herakliut kur ai ishte pyetur rreth të Dërguarit të All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem dhe ai (më vonë ia transmetoj Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem)

“Unë betohem për All-llahun nëse unë do të isha i sigurtë që ata nuk do ta kishin përcjellur një gënjeshtër nga unë, unë do të kisha gënijer rreth teje.” [Buhari]

Ky i cili ishte idhujtar në atë kohë u shmang gënimit nga frika që kjo gënjeshtër do të përcjellej ose që ai do të fyehej dikur për shkak të kësaj.

Shmangiu gënjeshtres madje edhe nëse nevojitet pr ta thënë atë ne e dimë që nderi i thirrësit të sotëm në islam është një shënjestër për një tufë shtizash dhe është e nevojshme për ate të mbyll dyert përpara se era e ndyre të hyje brenda.

Kështu që ai mund të shpëtojë.

c. Sinqeriteti në vepra:

Me këtë kuptojmë që veprat e një personi duhet të bëhen në mënyrë të pastër për All-llahun e Madhëruar e jo për të kërkuar reputacion të mirë:

“Kushdo që shpreson të takojë Zotin e Tij, ai duhet të bejë vepra të mira dhe mos ti shoqërojë askend në adhurimin e Zotit të tij” dhe “që Ai mund t’ju sprovtojë ju për të para kush prej jush është më i miri në vepra.”

Fudail bin Ajad komentoi që “cili nga ju është më i miri në vepra “Kuptohet më i sinqerti dhe më i përshtatshmi.” Ai ishte pyetur: “O babai I filanit! Çfarë është sinqeriteti dhe përshtatshmeria. Ai tha: Nëse vepra është e sinqertë dhe jo e përshtatshme ajo nuk pranohet dhe nëse është e përshtatshme dhe jo e sinqertë ajo nuk pranohet.

Nuk do te pranohet deri kur është e sinqertë dhe e përshtatshme.”

Përfshihet në subjektin e sinqeritetit në vepra posedimi i qartësisë dhe shmangia e dyshimit dhe paqartësisë.

Është transmetuar mbi autoritetin e Ebu Daudit dhe Nisasë që pas një konfrontimi me një burrë kur shokët e Pejgamberit All-llahu, qoftë i kënaqur me ta, nuk u ngritën

në këmbë për atë sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem ai i kritikoi ata kështu që ata thanë:

“O i dërguar i All-llahut ne nuk dimë çfarë është në mendjen tënde a nuk mundeshe të na e luaje syrin tënd?”

“Ai sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “Nuk është për një Pejgamber që të ketë një sy mashtrues! - Ebu Daud, Nisa, Hakimi, Ahmedi nga një thënie e Pejgamberit nga Enasi në të cilën thuhet: “Një Pejgamber nuk luan syrin” Tirmidhiu ka transmetuar që Abdullah bin Salem qoftë All-llahu i kënaqur me të ka thënë: “Kur Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem erdhi në Medine njerëzit dolën jashtë dhe thanë:

“I dërguari i All-llahut ka ardhur! I Dërguari i Allahut ka ardhur! I Dërguari i All-llahut ka ardhur!”

Kështu unë erdha përpara midis njerëzve për ta parë atë sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem dhe kur pashë fytyren e tij e dija që fytyra e tij nuk ishte fytyre gënjeshtari. Dhe gjëja e parë që ai sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem ka thënë:”

“O njerëz! Shkëmbeni selam dhe shërbeni ushqimin dhe faluni gjatë kohës që njerëzit janë duke fjetur ju do të hyni në parajsë paqësisht.” [Ahmedi, Tirmidhiu dhe Ibën Maxhxe]

Sinqeriteti i të Dërguarit të All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem përshkonte zemrën e tij drejt gjuhës se tij në mënyrë ekstreme sa që u manifestua në fytyrën e tij sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem

Çdo njeri i cili shikonte pamjen e tij të shkëlqyeshme shikonte sinqeritet dhe është transmetuar që fytyra e tij nuk ishte absolutisht fytyra e një gënjeshtari!

Ne kemi nevojë për tipe thirrësish në islam të cilët transmetojnë sinqeritetin me fjalimet dhe veprat e tyre aq shumë sa që sinqeriteti të bëhet një instikt natyral përmes venave të tij duke shpërthyer nëpërmjet

sjelljeve të tyre të jashtme kështu kur njerëzit t'i shikojnë ata ata të thonë "Këta nuk janë fytyrat e gënjeshtarëve!"

Ne gjithahstu kemi nevojë për thirrës në islam të cilët janë të zbuluar me një moral të shkëlqyeshëm që janë larg nga vetëjustifikimet dhe nuk janë neverike por ngulmojnë përmes qetësisë së tyre të cilat janë të ekuilibruar në sjelljet e tyre të folurit në të gjithë rrethanat në mënyrë të që njerëzit janë të aftë të shohin karakteristikat e tyre dhe të thonë "Këto janë karakteristikat e Pejgamberëve!"

Me të vërtetë sinqeriteti në ndërmarrjen e thirrjes në islam është një shkak për njerëzit për të pranuar fenë tonë dhe ne nuk duhet të bëhemi si aktori në skenë i cili njerezve ju paraqet të kundërtën e asaj çfarë ai është në të vërtetë.

Në këtë rast një thirrës në islam si i tillë shpejt do të demaskohet dhe njerëzit do të largohen nga ai.

Është trasmetuar që një nga të parët tanë si pasojë e fjalimeve të tij kanë bërë që njerëzit afeksionohen dhe të derdhin lot deri në atë pikë sa ju mund ti dëgjonit të qarat e tyre të fuqishme.

Ndërsa dikush tjetër mund të jap një ligjeratë më të mirë në të njëjtin grumbullim dhe mund të jetë më i ditur por që nuk do të influencojë në zemrat e tyre dhe as të kthejë ato në lot!

Kështu biri i tij e pyeti atë rreth kësaj dhe përgjigjeja ishte "Të qarat e nënës e cila ka humbur fëmion e saj nuk janë si e qara e ndonjërit i cili është paguar për të bërë kështu."

Si përfundim kushti i parë për suksesin e thirrësit në islam është:

1. Sinqeriteti i tij në ndërmarrjen e thirrjes në islam.
2. Serioziteti në te.
3. Dhe sinqeriteti në fjalët dhe veprat e tij duhet të bëhen metoda dhe karakteristika të tijat.


Fjalët e embla nuk janë shumë të rëndësishme - edhe kur ato janë te nevojshme - më i rëndësishëm është sinqeriteti që është në harmoni me vetveten dhe fjalimet e tij vijonë nga zemra.

Kohë përpara është thënë:

"Nëse një fjalë vjen nga zemra ajo do të zë vend në zemër.....dhe nëse ajo vjen nga gjuha ajo nuk arrin as tek veshët!"

Selman el-Avde

Marrë nga: 'Etikat e Daiut'
Përktheu: Ammar Ardit Kraja,
31.10.2003



Kërkimi i diturisë

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

Çka kuptojmë nga ky hadith:

1- Islami është feja e vetme që ka ngritur pozitën e diturisë dhe e ka bërë adhurim, me të cilin njeriu i afrohet All-llahut, subhanehu ve te'ala.

2- Dituria është obligimi i parë, i cili vjen edhe para bazës së bazave, në ajetin Kur'anor:

“Atëherë, dije se nuk ka zot tjetër pos All-llahut, kërkoi fajle për mëkatin tënd, ...”. (Muhammed: 19).

Pra dituria priu fjalën dhe veprën, mirëpo këtë vetëm dijetarët e kuptojnë.

3- Dituria është rruga e cila të shpien te mirësitë dhe bereqetet e dynjasë dhe ahiretit, andaj Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem ka thënë:

“Atij që All-llahu ia do të mirën ia mëson fenë”. (Buhariu).

4- Dituria e bashkon ummetin dhe anëtarët e ummetit i bën të barabartë, mes tyre nuk ka dallim, sepse dituria është obligim i të gjithëve dhe kërkohet nga të gjithë, dallim ka vetëm në sasinë e diturisë që fiton dhe hiseja yte në trashëgimin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

5- Ummeti islam qëndron dhe ngritet me dituri, andaj ajetet e diturisë, rregullat e mësimin të diturisë janë ajetet e para që janë zbritur në Kur'an:

“Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të

ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruajë me pendë. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte”. (El-Alak: 1-5).

6- Dituri nuk fitohet pa mësuar dhe duruar, ka rrugë të cilën duhet pasuar, metodë të cilën duhet përcjellur dhe synim të cilin duhet kërkuar.

7- Dijetarët që e dinë All-llahun dhe Pejgamberin, Librin dhe Sunnetin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, janë njerëzit e Zotit dhe të veçantit e Tij, ata që udhëzojnë drejt Tij dhe që nënshkruajnë në emër të Tij, andaj janë me të vërtetë trashëguesit e pejgamberëve.

8- Kërkuesi i diturisë i shton të mirat përdërisa është në rrugën e kërkimit të diturisë, sepse ajo që kërkon nuk ngopet prej saj e as që e mërzit shpirtin. Andaj All-llahu, subhanehu ve te'ala, thotë:

“...Zoti im, më shto dituri!”. (Taha: 114).

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

“Dy krijesa nuk ngopen: kërkuesi i dytirsë dhe kërkuesi i dynjasë”.

9- Dituria është e lehtë për ate që e kërkon dhe ia jep hakun, andaj është obligim për secilin musliman, qoftë mashkull ose femër.

10- Disa njerëz hadithit ia shtojnë edhe një shtesë: “dhe muslimane”. Mirëpo kjo shtesë nuk ka bazë në transmetimet e vërteta të këtij hadithi. Fjala musliman nënkupton edhe muslimanin edhe muslimanen.

Autor: **Selim Hilali**
Përktheu: Bekir Halimi
28.11.2003

Dhjetë mjete për të vazhduar në veprat e mira pas Ramazanit

Çka pas Ramazanit?

Gjatë Ramazanit isha drejtuar kah Zoti, i kisha shtuar veprat vullnetare, ndjeja kënaqësinë e adhurimeve, më shumë lexoja Kur'an, nuk e leja pas dore namazin me xhemat, ikja nga shikimi i haramit, mirëpo pas Ramazanit më iku kënaqësia e adhurimeve, të cilën e gjeja gjatë Ramazanit, nuk e gjej atë kujdes të madh që kisha për adhurimet, shumë herë më ikë namazi me xhemat, jam larguar prej shumë veprave vullnetare dhe nga leximi i Kur'anit...

Vallë, ky problem ka zgjidhje?!

Vëllau im, ja dhjetë mjete për vazhdim në vepra të mira pas Ramazanit:

1- Së pari dhe para çdo gjëje kërko ndihmë nga All-llahu, subhanehu ve te'ala, për udhëzim dhe përqëndrim në të vërtetë. All-llahu, subhanehu ve te'ala, e ka lavdëruar duanë e të thelluarëve në dije, të cilët janë lutur:

“Zoti ynë, mos na i lako zemrat tona pasi na drejtove, na dhuro mëshirën Tënde, pse vetëm Ti je dhuruesi i madh”. (Ali Imran: 8).

2- Shpeshito uljen me njerëz të mirë, kujdesu për tubimet e dijes dhe dhikrit, siç janë ligjeratat, vizitat, etj.

3- Mëso jetëpërshkrimin e burrave të devotshëm, duke lexuar në libra ose duke dëgjuar audio kaseta, në veçanti interesohu për jetëpërshkrimin e sahabeve, sepse kjo ngjallë në zemër ambicien e lartë.

4- Sa më shumë dëgjo kaseta islame me ndikim, qofshin hutbe, këshilla, etj.

5- Kujdesu për farzet, siç janë farzet e namazeve, kompenzimin e ditëve që të kanë mbetur nga Ramazani, sepse në zbatimin e farzeve ka mirësi të madhe.

6- Kujdesu për nafilet, edhe në qoftë se janë të pakta, sepse:

“Veprat më të dashura te All-llahu janë ato të vazhdueshmet, edhe pse janë pak”. Siç na ka treguar Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

7- Fillo me mësim përmendsh të Kur'anit, lexoje vazhdimisht, ate që e mëson përmendsh lexoje gjat namazeve farze dhe nafile.

8- Shtoje përmendjen e All-llahut, subhanehu ve te'ala, kërkimin e faljes (istigfarit), sepse është punë e vogël, mirëpo e shton besimin dhe e forcon zemrën.

9- Ikju maksimalisht gjërave që e prishin zemrën, siç janë shokët e këqij, televizioni, muzika, shikimi në revista imorale, etj.

10- Në fund të porosis vëllau im i dashur me pendim të shpejtë, sepse pendimi i sinqertë nuk të lejon të kthehesh sërish në mëkate, pasi që All-llahu gëzohet me të madhe me njeriun që pendohet.

Vëllau im i bekuar, mos u bën nga ata që Zotin e njohin vetëm në Ramazan. Për të tillët muslimanët e parë kanë thënë: “sa të këqinjë janë ata që All-llahun vetëm në Ramazan e njohin”.

Lamtumirë vëllau im deri në Ramazanin e ardhshëm, duke iu lutur All-llahut për ty, për shëndet dhe përqëndrim në fenë e All-llahut.

Marrë nga: saaid.net
Përshtati: Bekir Halimi
28.11.2003

Pas muajit të Ramazanit

T'i bëjmë disa vështrime me rastin e përcjelljes së Ramazanit, lusim All-llahun që të na bëjë dobi me të.

Çka fituam prej Ramazanit?

Ah, e përcollëm Ramazanin e ndershëm, me ditët e tij të bukura dhe netët e mreku-llueshme. Ah, e përcollëm muajin e Kur'anit, të devotshmërisë, durimit, xhihadit, mëshirës, faljes, shpëtimit prej zjarrit, etj. (Gjërat e lartëpërmendura nuk janë të posaçme vetëm për Ramazan...por në të gjitha ditët dhe kohët arrihet mëshira dhe falja e All-llahut... në të gjitha kohët duhet të kërkohet takvallëku dhe të furnizohet muslimani me edukatën Islame. Qëllimi për atë që përmendëm është se në këtë muaj shumfishohen sevapet, shtohen të mirat dhe ibadetet.)

A e fituam takvallëkun (devotshmërinë), dhe a e mbaruam shkollën e Ramazanit me diplomën e të devotshmëve?

A i edukuam vetvetet gjatë Ramazanit në xhihad me të gjitha llojet e tij? A i luftuam vetvetet dhe epshet tona apo na fituan shprehitë e këqija dhe pasimet e verbërta e të liga? A nxituam në ato punë të cilat janë shkaqe të rahmetit, të faljes dhe shpëtimit prej zjarrit. A vepruam... A vepruam... A vepruam...?

Pyetje të shumta dhe të rëndësishme. Ia parashton vetvetes çdo musliman i sinqertë. E pyet veten e tij dhe përgjigjet me sinqeritet:

Çka fitova prej Ramazanit?

Vërtetë ai është shkollë e besimit, stacion i shpirtit për furnizimin e tij gjatë tërë vitit

dhe për ngritjen e ideve dhe qëllimeve për jetën e mëtejshme.

Kur do të pranojë këshillën, do të ketë dobi dhe do të ndryshohet apo ta ndryshojë jetën e tij ai i cili nuk e bën këtë në muajin Ramazan?!

Me të vërtetë ai është shkollë për përmirësim, përmirësojmë veprat tona, sjelljet, adetet dhe moralet që janë në kundërshtim me ligjin e All-llahut, subhanehu ve te'ala. Thotë All-llahu, subhanehu ve te'ala: "Vërtetë, All-llahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli për derisa ata nuk e ndryshojnë vetveten" (Err-Rrad, 11)

Mos e humbni mundin tuaj

Nëse je prej atyre që përfituan prej Ramazanit... i fitove cilësitë e të devotshmëve, e agjërove si duhet, je falur me sinqeritet dhe i ke luftuar dëshirat tua epshore, falënderojë All-llahun dhe lute atë që të të përforcoj në këtë rrugë derisa të të takojë vdekja. Kujdes që mos ta humbësh atë që ke fituar gjatë këtij muaji. Si ta merr mendja nëse një grua do ta tirte një shllung lesh e pastaj prej tij të bën ndonjë fanellë apo diçka tjetër, e pasi ta mbarojë i pëlqen shumë ajo fanellë dhe fillon që ta prishë atë fije-fije. Çdo të thonin njerëzit për të?

Kjo është e njëjtë me atë i cili ju kthehet mëkateve dhe punëve të liga e largohet prej ibadeteve dhe punëve të mira pas Ramazanit... pasi që të begatohet me begatitë e ibadeteve dhe kënaqësinë e shpëtimit kthehet në gropën e mëkateve dhe punëve të

këqija! Sa njerëz të keqij janë ata të cilët All-llahun, subhanehu ve te'ala, e njohin vetëm me Ramazan.

Të dashur:

Humbja e asaj që u fitua në Ramazan mund të shihet në disa aspekte e nuk janë vetëm ato:

1. Atë që shohim nëpër xhamia, edhe atë prej ditës së parë të Bajramit. Në Ramazan xhamiat ishin përplot me xhemat, të mbledhur për të falur namazin e teravisë, që është sunnet, ndërsa tani në pes namazet e ditës që janë farz nuk shohim xhemat përveç se pak.

2. Me këngë dhe muzikë... zbuluarja e gruas dhe përzierja e saj me burra të huaj, lënia e leximit të literaturës islame etj.

3. Vajtja në vende të këqija për të bërë mëkate.

Kështu nuk bëhet falënderimi i të mirave... kështu nuk përfundohet ky muaj dhe nuk falënderohet All-llahu për atë se na ka mundësuar të falemi dhe agjërojmë...kjo nuk është shenjë se All-llahu t'i ka bërë kabull veprat tua (t'i ka pranuar), por kjo është mohim i begative dhe mosfalënderim për to.

Kjo është shenjë e mospranimit të veprave, All-llahu na ruajtë. Agjëruesi me të vërtetë gëzohet ditën e Bajramit. E falënderon All-llahun se ia mundësoi ta plotësojë agjërimin. Por prapeseprap ai qan nga frika se ndoshta All-llahu nuk ia ka pranuar agjërimin. Nga gjeneratat e para tona pas Ramazanit kishte që qanin gjashtë muaj, duke e lutur All-llahun që t'ua pranonë veprat e tyre!

Prej shenjave të pranimit të veprave është ta shohish muslimanin në gjendje më të mirë se sa ka qenë më parë, ta shohish duke nxituar drejt veprave të mira. Thotë All-llahu subhanehu ve te'ala: "Përkujtoni, kur Zoti juaj njoftoi bindshëm: nëse falënderoni do t'ua shtojë të mirat..." (Ibrahim, 7). Shtimi

në të mira ka për qëllim shtimin konkret dhe abstrakt d.m.th. shtimi i imanit dhe punëve të mira... sikur muslimani ta falënderonte All-llahun ashtu si meriton, do ta shihje duke shtuar të mirat dhe ibadetet dhe duke u larguar prej mëkateve. Falënderim don të thotë lënie e mëkateve, siç kanë thënë gjeneratat e para të muslimanëve.

"Dhe adhuroje Zotin tënd deri sa të arrijë vdekja"

Kështu duhet të jetë muslimani, të vazhdojë në respektin e All-llahut, i përqëndruar me sheriatin e Tij, i udhëzuar me fenë e Tij. Jo, atë nuk mund ta hutojë askush, e të adhurojë All-llahun në një muaj e në tjetrin jo, në ndonjë vend e në tjetrin jo, me disa njerëz e me të tjerë jo... jo, jo dhe njëmijë herë jo! Por, e din se Zoti i Ramazanit është Zot edhe i muajve tjerë, e din se Ai është Zot i të gjitha kohërave dhe vendeve... kështu që drejtohet dhe përforcohet në ligjin e All-llahut, subhanehu ve te'ala, derisa të takojë Zotin e tij të kënaqur me te. Thotë All-llahu, subhanehu ve te'ala,: "E ti përqëndrohu ashtu si je i urdhëruar, e bashk me ty (o Muhammed) edhe ata që u penduan" (Hud, 112) dhe ka thënë "Pra drejtohuni Atij dhe kërkoni falje prej tij" (Fussilet, 6) Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Thuaj besova, e pastaj përqëndro" (Transmeton Muslimi)

Nëse ka mbaruar agjërimi i Ramazanit kemi edhe agjërim vullnetar, sikurse: gjashtë ditët e muajit Shevval, çdo e hënë dhe e enjte, ditët e bardha, dita e ashures, e arafatit, etj. Nëse ka mbaruar namazi i teravisë, namaz nate mund të falish çdo natë. Thotë All-llahu subhanehu ve te'ala: "E ata flenin vetëm një pjesë të shkurtër të natës" (Dharrijat, 17)

Nëse ka mbaruar sadakatul-fitri, mund të japish zekatin vjetor që e ke obligim, pastaj

ke edhe vende tjera ku mund të inkuadrohesh me dhënien e sadakasë (lëmoshës).

Leximi i Kur'anit nuk është i veçantë vetëm për Ramazan, por ai duhet të lexohet gjatë tërë vitit.

Ja kështu... veprat e mira mund të kryhen në çdo kohë. Mundohu, o vëlla në ibadete e ki kujdes prej të kotës dhe përtacisë. Nëse nuk i vepron gjërat vullnetare, dije mirë se lënia e farzeve nuk të lejohet asnjëherë, si kurse pesë namazet e ditës, etj.

Kujdes, mos të biesh në harame qoftë ajo fjalë, punë, shikim në të apo dëgjim i tij. Kujdesuni, kujdesuni që të përqëndroheni dhe të përfërcoheni në fe gjatë tërë kohës. Ti nuk e din se kur të vjen meleku i vdekjes. Ke kujdes mos të të gjejë në mëkate. O Zot, o

Ndryshuesi i zemrave, na i përforco zemrat tona në fenë tënde.

Së fundi: Duhet të kujdesesh shumë për veprat e mira e ditën e Bajramit të gjendesh mes shpresës dhe frikës, frigoresh për mospranimin e veprave dhe shpreson në pranimin e veprave. Të mendojmë ditën e Bajramit për Ditën e daljes para All-llahut, ku prej neve do të ketë që janë të gëzuar dhe të dëshpruar.

Lus All-llahun që të pranojë prej neve dhe juve agjërimin, namazin dhe gjitha veprat tjera...t'i bëjë Bajramet tona me gëzime, të na e kthejë Ramazanin përsëri, e ne deri në atë kohë të jemi në gjendje më të mirë dhe t'i kemi përmisuar punët tona, të jetë ummeti jonë në pozitën më të lartë dhe të kthehet te Zoti i tij me kthim të mirë. Amin!

Publikimi i parë në Albislam.Com:
04.01.2001

Lamtumirë Ramazan

Vëllezër musliman!

Shumë shpejtë kalojnë ditët dhe netët. Shumë shpjetë ikin muajt dhe vitet. Kjo është gjendja e dynjasë. Shpejt kalon, asgjësohet përnjëher, nuk vazhdon në një gjendje asnjëherë. Ky është ligji i All-llahut në krijesat e Tij. Cikle dhe etapa, të cilat qarkullojnë sipas caktimit të prerë, e ...

"...Për secilin afat ekziston evidencë e caktuar". (Er-Rad: 38).

Ata që mendojnë dhe logjikojnë, ata që shohin dhe meditojnë, e kuptojnë këtë të vërtetë në mënyrë të plotë, andaj nga kalimi i kohës marin mësimin më të madh. All-llahu, subhanehu ve te'ala, thotë:

"Në krijimin e qiejve e të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt". (Ali Imran: 190).

Ummet i Islamit!

Para disa ditë u ndam nga Ramazani.

Sikurse të ishte një ëndërr e cila së shpjeti kaloi. All-llahun e falënderojmë për atë që ka caktuar dhe ka realizuar, Atij i takon falënderimi për atë që ka dhënë dhe ka dhuruar. U mbyll kjo faqe, ka fituar kush ka fituar dhe ka humbur kush ka humbur:

"Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten. E ka dështuar ai që e poshtëroi vetveten". (Esh-Shemsu: 9- 10).

Iku, kaloi, shkoi me dëshminë për punët e juaja dhe atë që keni bërë gjatë këtij muaji. Vallë iku me falënderime dhe lavdata për ne ose me qortime dhe vërejtje?

Ai që ka bërë vepra të mira, le ti plotëson punët e mira, e ai që ka mbetur mangu le ta përfundojë me të mira jetën e tij, sepse veprat vlerëson sipas përfundimit.

Vëllezër musliman!

Ummeti ka nevojë të madhe për të llogaritur vetveten në vazhdimësi dhe pa ndërprerë. Ka nevojë për momente të mendimit dhe analizave mbi gjendjen tonë. Momente nga të cilat ummeti merr mësim dhe këshilla. Që ta sheh realitetin e sajë dhe hapat e ardhmërisë, sinjalet e të tashmes dhe të ardhmes. Në këtë kohë të bekuar, sikur që ishte Ramazan, është shansë e madhe, që i tërë ummeti, individ ose shoqëri, kryetar dhe civil, ta shfrytëzojnë si urë për të vlerësuar mundin, për të përmirësuar gjendjen, para se ta ikë koha dhe të ndryshohet gjendja.

Ramazani ka dhurata dhe mësim të mëdha, të cilat duhet të realizohen. Prej tyre duhet të jetë venoshmëria për luftë të vërtetë kundër shejtanit dhe për të ecur në rrugën e shëndoshë dhe të drejtë, duke u larguar nga çdo padrejtësi dhe të keqe, i cilitdo lloj qoftë.

Robër të All-llahut!

Ligjet e Islamit përmbajnë sekrete të pa-fund, synime të shtrenjta dhe të paaritshme. Prej synimeve të agjërimit është fakti se agjërimi është mjet për të arritur devotshmërinë në ndërgjegjësinë e muslimanit. Devotshmërinë në kuptimin më të gjërë dhe më preciz. Mirëpo, ti o musliman, duhet ta bësh agjërimin tënd, shkollë, nga e cila e inspiron vendoshmërinë, vullnetin e fuqishëm për çdo të mirë, madhërim të sjelljes, drejtëm të shpirtit, përmirësim të ndjenjave, rregullim të brendësisë dhe asaj që duket, pastërti dhe

dilirësi të veprave dhe ndërgjegjeve, vullnet i mirë për të vazhduar në vlera, pa mëdyshje dhe vendosshmëri për të mira, pa plogështi. A ka kush nxiton të përmirësojë atë që ka prishur, të shërojë atë që ka sëmurë, ta forcojë atë që është dobësuar nga aspektet e mirësisë, përmirësimit dhe devotshmërisë?!

All-llahu, subhanehu ve te'ala, thotë:

“Luftoni me një luftë të denjë për hir të All-llahut, ...”. (El-Haxhxh: 78).

Vëlla musliman!

Kërkesat e Kur'anit vijnë njëra pas tjetrës duke thërritur në përqëndrim në të mira dhe qëndrueshmëri në udhëzim. All-llahu, subhanehu ve te'ala, thotë:

“Ti (Muhammed) përqëndrohu vendosmërisht ashtu si je i urdhëruar, e bashkë me ty edhe ata që u penduan (prej idhujtarisë), e mos tejkaloni (kufijtë e caktuar), se më të vërtetë Ai është shikues i asaj që veproni”. (Hud: 112).

“Dhe adhuroje Zotin tënd deri të vijë ty e vërteta (vdekja)”. (El-Hixhr: 99).

Porosi hyjnore të drejtuara të gjithë muslimanëve, qofshin individ ose shoqëri që të organizojnë çeshtjet e tyre në bazë të Islamit, që të vazhdojnë në metodën e fesë, që të përkufizohen me kufinj të e fesë, të ndalen në kufinj të e fesë, t'i përgjigjen urdhërave të fesë, të ndalen nga ndalesat, në formën dhe mënyrën më të plotë.

Dëgjo dritën peygamberike, e cila ti rezy-mon porosinë e mëdha në shprehje të bukura dhe shumë domethënëse. Porosia e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, për mbarë ummetin, porosi e cila kërkon që ta përve-tësojmë tërë besimin, kërkon prej nesh të kemi besim të shëndoshë, të kapemi për durimin gjatë adhurimeve, të largohemi nga ndalesat, të përcjellim vlerat e mira dhe sjelljet e moralshme. Peygamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i përgjigjet njeriut, i cili i thotë:

“Më thuaj në fjalë në Islam, për të cilën nuk do ta pyes askend pas teje? Tha:

“Thuaj: besova në All-llahun, e pastaj përqëndro”. (Muslimi).

Kjo porosi, i garanton tërë ummetit, pa marrë parasysh gradat dhe lëmitë, jetë të këndshme dhe të kënaqur. Besimtarëve ju realizon lumturi të përhershme dhe përfundim të sigurtë. All-llahu, subhanehu ve te'ala, thotë:

“Ata që thanë: "All-llahu është Zoti ynë dhe qëndruan besnikërisht, për ta nuk ka frikë dhe ata nuk do të pikëllohen. Të tillët janë banues të xhennetit, aty do të jenë përgjithmonë, atë e kanë shpërblim për veprat që i bënë”. (El-Ahkaf: 13- 14).

Ummeti i Islamit!

Kaluan këto ditë të bekaura, kurse ummeti ynë është i ballafaquar me llojloj pengesash, me llojloj sëmundjesh të mëdha, përjeton bela dhe telashe, të këqija dhe ngushtica, përjeton përçarje dhe dobësi, shpërndarje dhe plogështi. Gjëra të dhimbura dhe gjendje të cilat të shtynë të qajshë. A nuk ka ardhur koha të kontrollojmë këtë realitet të dhembshëm dhe rrugë të gabuar?

A nuk ka ardhur koha për të kuptuar shkaqet e vërteta të dobësisë, njohja e elementeve kryesore të sëmundjeve dhe ankesave?

All-llahu, subhanehu ve te'ala, thotë:

“A nuk është koha që zemrat e atyre që besuan të zbuten me këshillat e All-llahut dhe me atë të vërtetën që zbriti (me Kur'an), e të mos bëhen si ata, të cilëve u është dhënë libri më parë e zgjati koha dhe zemrat e tyre u shtangën e shumë prej tyre janë jash-të rrugës”. (El-Hadid: 16).

Është e rrugës që me lamtumirën e Ramazanit ti japim lamtumirën edhe gjendjes sonë të keqe dhe lëndimeve tona të shumanshme. Nuk mundemi të gjejmë rrugë të sukseshme

dhe shërim të dobishëm përveç se me iniciativa me pikënisje fetare, duke u kapur për metodën e plotë, të bazuar në Kur'an dhe sunnet. Prej kësaj metode është puna serioze dhe vërtetësia me All-llahun për ta ndihmuar këtë fe në çdo vend, duke realizuar obligimin tonë, në largimin e padrejtësisë dhe dëmit nga njerëzit e shtypur.

All-llahu, subhanehu ve te'ala, thotë:

“Besimtarët dhe besimtare janë të dashur për njëri-tjetrin, ...” (Et-Teube: 71).

Vëllezër musliman!

Muslimanët duhet të kenë vetëdije të plotë dhe perceptim gjithpërfshirës mbi kurthet e armikut dhe planet e tyre kundër muslimanëve, kundër besimit dhe sigurisë së tyre. Sa e sa gjëra të paqarta ndodhin, sa e sa planifikime gjigante hartohen, All-llahu e di përmbytjen dhe synimin e tyre. Zionizmi botëror, i cili e udhëheq botën në katastrofa dhe kriza, dëshiron që ummeti i Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, të përjetojë telashe dhe fatkeqësi, dëme dhe ngushtica. Andaj kujdesuni për këtë fe dhe për këtë ummet.

Vëllezër musliman!

Prej planeve të armiqëve janë edhe këto fushata të mediave kundër islamit dhe burimeve të tija, kundër muslimanëve fetarë dhe aktivist, kundër secilit që përpiqet për të ngritur lart fjalën e All-llahut. Qëllimi i tyre nga këto fushata është goditja e ummetit në thellësitat e saja dhe të ndikojë në komponentin më të rëndësishëm të jetës së saj.

Të vërtetën e ka thënë All-llahu kur thotë:

“Ata dëshirojnë që edhe ju të mos besoni sikurse nuk besuan vetë dhe bëheni të njëjtë”. (En-Nisa: 89).

Ummeti i Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel'lem, duhet të kuptojë synimet e fesë së vet, qëllimet e fjalës së Krijuesit të tyre, t'i mësojë parimet dhe mësimet islame, përndryshe do të

jetë kurban i tradhtuar dhe larg nga drita e udhëzimit të Zotit të tyre.

All-llahu, subhanehu ve te'ala, thotë:

"Dhe thuaj: "Veproni, All-llahu do ta shohë veprën tuaj, edhe i dërguari i Tij e besimtarët, e më vonë do të ktheheni te njohësi i të fshehtës dhe të dukshmes, e do t'ju njoftojë për atë që vepruat". (Et-Teube: 105).

Na bekoftë All-llahu me Kur'anin e Madhërishtëm, na bëftë dobi me ajetet dhe sqarimet që janë në te. E them këtë që dëgjuat dhe kërkoi falje nga All-llahu për mua dhe për mbarë muslimanët nga çdo mëkat, kërkoni falje dhe pendohuni te Ai, se është Falës dhe I Mëshirshëm.

E falënderojmë All-llahun për bamirësinë e Tij, për suksesin dhe dhuratat e Tija. Dëshmoj se ska hyjni tjetër përveç All-llahut, i Cili është një i Vetëm, pa ortak, duke e madhëruar Ate dhe dëshmoj se zotëriu dhe Pejgamberi ynë, Muhammedi është rob dhe i Dërguar i All-llahut.

All-llahu im, bekimi, paqa dhe bereqeti Yt qoftë mbi te, mbi familjen, shokët dhe vëllezërit e tij.

Biseda më e mirë është fjala e All-llahut, kurse udhëzimi më i mirë, udhëzimi i Mu-

ammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Gjërat më të këqia janë ato të shpikurat, çdo shpikje është bidat, çdo bidat është lajthitje, e çdo lajthitje dërgon në xhehenem.

O ju muslimanë!

I lumtur është ai që e ka mbushur kohën duke e përmirësuar ahiretin e tij, nuk e kanë habitur kërkesat e kësaj jete nga obligimet që i ka ndaj Krijuesit të tij, nuk e kanë angazhuar dëshirat e kësaj jete nga të vërtetat e ahiretit të përhershëm.

Ti që ke shijuar ëmbëlsinë e besimit, kujdes nga shijimi i hidhurisë së mëkatit, bëhu i mirë dhe i devotshëm edhe pas Ramazanit, ashtu siç ke qenë gjatë Ramazanit.

Dije, vëllau im musliman, se ai që ka agjëruar Ramazanin, e pastaj e pason me agjërimin e gjashtë ditëve të muajit Shevval, i shënohet shpërblim sikurse të kishte agjëruar tërë vitin, siç na ka treguar Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. (Muslimi).

Ashtuqë është e pëlqyshme agjërimi i gjashtë ditëve të Shevvalit, kurse ai që ka ditë për të kompenzuar, kompenzimi është më meritë për përparësi.

Dijeni se All-llahu u ka urdhëruar që të dërgoni salavate dhe selame mbi Pejgamberin bujar.

Husejn Alu Shejh

Imam dhe hatib në xhaminë e Pejgamberit, alejhis-selam, në Medinë.

Përktheu: Bekir Halimi

10.12.2002

Agjërimi i gjashtë ditëve të Shevvalit dhe dobia e agjërit të këtyre ditëve

Imam Muslimi transmeton nga Ebu Ejub El-Ensariu, radijall-llahu anhu, i cili tregon se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Kush agjëron Ramazanin, pastaj e përcejell me agjërimin e gjashtë ditëve të Shevvalit, i regjistrohesh sikur të kishte agjëruar tërë vitin”. (Muslimi).

Në bazë të këtij hadithi shumica dërmuese e dijetarëve islam e preferojnë agjërimin e këtyre ditëve që pasojnë pas muajit të Ramazanit.

Dijetarët që e kanë preferuar agjërimin e këtyre ditëve kanë disa mendime rreth mënyrës se si të agjërohen këto ditë:

1- Disa thonë se është e pëlqyeshme që të agjërohen në fillimin e muajit edhe ate rend një pas një. I këtij mendimi është Imam Shafiu dhe Ibën Mubareku.

2- Të tjerët kanë thënë se nuk është me rëndësi a i agjëron rend, ditë pas dite ose i ndanë gjatë tërë muajit. I këtij mendimi është Imam Ahmedi dhe Vekiu.

3- Nuk preferohet agjërimi menjëher pas ditëve të bajramit, sepse janë ditë të ushqimit dhe pijes, por agjërohet tre ditë para ditëve të bardha dhe tre ditë pas tyre. I këtij mendimi është Muameri dhe Abdur-Rezaku.

Mirëpo shumica e dijetarëve janë të mendimit se nuk ka ndonjë pengesë nëse fillohet me agjërimin e këtyre ditëve që nga dita e dytë e fitër bajramit. (shiko: Letaiful-Mearif, fq. 390- 391)

Dijetarët kur kanë folur për shpërblimin që e fitojnë me agjërimin e gjashtë ditëve të Shevvalit kanë thënë: “Nëse e agjërojmë muajin e Ramazanit, i cili i ka tridhjet ditë, nëse këto ditë i shumëzojmë me dhjetë, atëherë dalin treqind ditë, e kur tja shtojmë këtyre ditëve edhe gjashtë ditët e shevvalit të shumëzuar me dhjetë, del treqind e gjashtëdhjet ditë. Edhe pse sipas kalendarit lunar, viti i ka treqind e pesëdhjet e pesë ditë.

Disa e kontestojnë këtë duke thënë se disa herë muaji i Ramazanit mundet me qenë njëzet e nëntë ditë. Mirëpo ata u përgjigjen duke u thënë se në këtë rast me rëndësi është vlera e këtyre ditëve dhe e zakonshmeja.

Këtë e thonë duke u mbështetur na hadithin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:

“Dy muajtë e bajrameve nuk pakësohen: Ramazani dhe Dhil-Hixhxeja”. (Buhariu dhe Muslimi).

Dijetarët kanë thënë, nuk janë të mangëta në vendim edhe pse janë të mangëta në llogari, ose zakonisht janë të plota, e rrallë herë janë të mangëta. (Xhamiul-Usul; 6/ 283).

Dobia nga agjërimi i këtyre ditëve

Vazhdimi i agjërit të këtyre ditëve pas Ramazanit ka shumë dobi. Në vijim do t'i përmendim disa prej tyre:

1- Agjërimi i këtyre ditëve pas Ramazanit të mundëson të fitosh shpërblimin e agjërit të tërë vitit, siç treguam më lartë.

2- Agjërimi i Shevvalit dhe Shabanit është sikurse falja e sunneteve para dhe pas na-

mazeve farz. E me këtë plotësohet mangësia që ndodh gjatë faljes së farzeve, sepse farzet në ahiret plotësohen me veprat tona vullnetare.

3- Vazhdimi i agjërimit pas Ramazanit është shenjë se All-llahu e ka pranuar agjërimitin e Ramazanit, sepse kur All-llahu e pranon nga robi ndonjë vepër, i mundëson që ta bëjë edhe një vepër tjetër të mirë pas sajë. Siç kanë thënë disa dijetarë: “shpërblimi i një të mire, është një e mirë pas sajë, ai që e vepron një vepër të mirë dhe pastaj e pason me një vepër tjetër të mirë, kjo është shenjë se All-llahu ia ka pranuar këtë të mirë, e nëse pas ndonjë vepre të mirë ka bërë një vepër të keqe, kjo është sinjal se All-llahu ia ka refuzuar atë vepër të mirë”.

4- Agjërimi i Ramazanit shkakton shlyerjen e mëkateve që janë bërë më herët, kurse shpërblimin e marrin në ditën e fitër bajramit, e cila është dita e shpërblimeve dhe dhuratave. Andaj agjërimit pas këtyre ditëve është falënderim për këto dhunti, sepse nuk ka dhunti më të madhe se sa shlyerja e mëkateve. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, falej aq shumë derisa iu ënjtën këmbët. I thanë: pse lodhesh kaq shumë, kur All-llahu ti ka falur mëkatet që i ke bërë dhe që do ti bësh? Tha:

“A nuk duhet të jem rob falënderues”. (Buhariu dhe Muslimi).

All-llahu, subhanehu ve te’ala i ka urdhëruar robërit e Tij që ta falënderojnë për dhuntinë e agjërimit të Ramazanit duke e publikuar përmendjen e Tij, duke thënë:

“...Që të plotësoni numrin, ta madhëroni All-llahun për atë se ju udhëzoi dhe që të falënderoni”. (El-Bekare: 185).

Nga falënderimi i robit për Zotin që i ka mundësuar ta agjërojë Ramazanin, i ka ndihmuar gjatë agjërimit dhe ia ka falur mëkatet, është që pas ditës festive, të agjërojë sërish.

Disa adhurues nga gjeneratat e para të devotshme (selefus-Salih) kur arrinin sukses për tu ngritur natën që të falin namaz nate, ditën që vijonte e agjëronin në shenjë falënderimi ndaj All-llahut për këtë ndihmesë.

Kur e pyetnin Vuhejb ibën Verdin për shpërblimin e ndonjë vepre të mirë, siç është tavafi, ose diç tjetër, u thoshte: Mos pyetni për shpërblimin, por pyetni për falënderimin që duhet ta bëjë njeriu, të cilin i është mundësuar ky adhurim, që t’ia shtojë suksesin dhe dhe ta ndihmojë në këtë adhurim.

Çdo dhunti që All-llahu ia ka dhënë besimtarit, qoftë e kësaj bote ose e ahiretit duhet të falënderohet. Vetë falënderimi është dhunti tjetër për të cilën sërish duhet falënderim, po edhe falënderimi i tretë është dhunti e cila sërish kërkon falënderim, e kështu me rradhë. Andaj, besimtari asnjëher nuk mundet arrijë kulmin e falënderimit. Për këtë dijetarët kanë thënë:

“Realiteti i falënderimit është pranimi se je i paaftë për ta falënderuar”. (Letaiful-Mearif, fq. 395).

Nëse dhuntinë e agjërimit të muajit të Ramazanit e pasojmë me mëkate, kjo është përbuzje e dhuntive të All-llahut.

Ai që e fillon agjërimitin e Ramazanit me nijet që pasi të përfundojë Ramazani sërish të kthehet në mëkatet, le ta dije se agjërimiti i tij është i refuzuar dhe dera e Mëshirës është e mbyllur përpara tij.

5- Veprat që i ka bërë besimtari gjatë Ramazanit nuk përfundojnë me përfudnimin e Ramazanit, ato mbesin derisa të jetë gjallë robi.

Disa njerëz gëzohen me përfundimin e Ramazanit, sepse u ka ardhur rëndë agjërimit dhe janë mërzhitur nga ditët e gjata e tij. Ky njeri e ka vshtirë të kthehet me të shpejtë në agjërimit. Kurse ai që e fillon agjërimitin me kalimin e ditës së bajramit, kjo tregon vullne-

tin që e ka për të agjëruar dhe se nuk e ka lodhur agjërimi e as që e ka mërzhitur.

I kanë thënë Bishrit: Disa njerëz shumë bëjnë adhurime gjatë Ramazanit. Tha: sa të këqinjë janë ata të cilët nuk i njohin obligimet e tyre ndaj All-llahut vetëm se në Ramazan. I mirë është ai që gjatë tërë vitit bënë adhurime dhe përpjeket në këto adhurime.

Shibliun e kanë pyetur: cili muaj është më i mirë, Rexhebi ose Shabani? Ai ka thënë:

Bëhu njeri i lidhur për Zotin e jo për Shabanin. (Letaiful-Mearif, fq. 396).

Nëse dëshirojmë të dimë praktikën e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në adhurime, këtë më së miri na e tregojnë këto hadithe:

E kanë pyetur Aishen, radijall-llahu anha: A e veçonte Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ndonjë ditë me adhurim? Ajo tha:

“Jo, veprat e tija ishin të vazhdueshme”. (Buhariu dhe Muslimi).

Thoshte:

“Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, nuk shtonte as në Ramazan e as jashta Ramazanit ma shumë se njëmbëdhjet rekate”. (Buhariu dhe Muslimi).

Pastaj porosia e madhe e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:

“Veprat më të dashura te All-llahu janë ato të vazhdueshmet, edhe në qoftë se janë pak”. (hadith sahih).

Vepra e besimtarit nuk përfundon

Vepra e besimtarit nuk përfundon derisa nuk përfundon ymri i tij.

Hasan Basriu, rahimehull-llah, thotë: “All-llahu, subhanehu ve te’ala, nuk i ka caktuar afat veprës së besimtarit përveç vdekjes”, pastaj lexoi ajetin:

“Dhe adhuroje Zotin tënd deri të vijë ty e vërteta (vdekja)”. (El-Hixhr: 99).

Këto vite, muaj, ditë dhe netë janë masë matëse e exheleve dhe kohë e veprave, pas-

taj me të shpejtë kalojnë dhe të gjitha përfundojnë. Kurse ai që i ka shpikur, i ka krijuar dhe i ka veçuar me vlera është i Përherëshëm, nuk kalon, i Vazhdueshëm nuk ndryshon. Ai në të gjitha kohërat është Një Zot dhe kontrollor e dëshmitar i veprave të robërve. I lartësuar qoftë All-llahu i Cili i rrotullo në kohë të ndryshme mes detyrave e shërbimeve, që të lëshon mbi ta dhuntitë më të vlefshme dhe të sillet me ta me bujarinë dhe fisnikërinë kulminante. Pasiqë përfunduan tre muajtë e ndershëm, që fillojnë me muajine parë prej muajve të shenjtë (eshhuril-hurum), e përfundojnë me muajin e agjërimin, pas tyre vijojnë tre muajtë e haxhxit. Nëse ai që agjëron dhe e kalon këtë muaj në namaz i falen mëkatet që i ka bërë më herët, ashtu edhe ai që e kryen haxhxin, e nuk fol fjalë të ndyta dhe nuk bën mëkate, kthehet nga haxhxi i pastër nga mëkatet sikurse në ditën që e ka lindur nëna. Besimtari çdo moment që e kalon nga jeta e tij, në atë çast ka obligime, detyra, shërbime dhe adhurime. Muslimani rrotullohet mes këtyre detyrave dhe i afrohet All-llahut me to, nën shpresë dhe frikë. (Letaiful-Mearif, fq. 398).

I dashuruari në All-llahun, nuk lodhet duke u afruar me vepra vullnetare te Zoti i tij dhe asgjë tjetër nuk shpreson përveç afërsisë dhe kënaqësisë së Tij.

Çdo kohë që e boshatisë besimtari nga adhurimet ndaj Zotit të tyre, e ka të humbur, çdo orë në të cilën është i shkujdesur nga përmendja e All-llahut, në ditën e Kijametit do të bëhet pishman. Vaj për kohën që nuk e kalon në adhurime dhe që nuk kalohet në shërbime ndaj Tij!

Shenjat e pranimit të një vepre

Kush e kryen një adhurim, shenjë e pranimit të tij është ta ndërlihdë me një adhurim tjetër, kurse shenjë e refuzimit është ta pason me mëkat. Sa e mirë është e mira e cila

vjen pas të keqes, e cila e shlyen ate. Kurse më e mirë se kjo është e mira, të cilën e pason një e mirë tjetër. Ska më keq se kur ta bëjnë ndonjë të keqe pas një veprës së mirë e cila, e shlyen atë të mirë. Një mëkat pas teubes është më i keq se shtatëdhjetë mëkate para pendimit. Recidivi është më i vështirë se vet sëmundja, ndoshta edhe e shkatërron njeriun.

Kërkoni nga All-llahu përqëndrim në adhurime deri në vdekje, strehohuni te All-llahu nga ndryshimi i zemrave dhe nga lajthitja pas udhëzimit.

Sa i keq është nënçmimi i mëkatit pas krenarisë së respektit edhe ma keq se kjo është varfëria e lakmisë pas pasurisë së maturisë.

Mëshironi njeriun krenar të një populli, i cili me mëkate u mposht dhe të pasurin e një populli, i cili me gabime u varfërua.

Djelmoshat e pendimit, mos u ktheni në epshet pas largimit prej tyre. Edhe pse largimi nga epshet kërkon durim në hidhurinë e largimit prej tyre, e nëse duroni e kompenzoni me ëmbëlsinë e besimit në zemrat e juaja.

Nëse e leni ndonjë gjë për hirë të All-llahut, All-llahu ua kompenzon me diç më të mirë se ajo:

“...se posa të vërejë All-llahu ndonjë të mirë (besim të drejtë e të singhtë) në zemrat tuaja, Ai ju jep edhe më shumë të mira nga ajo çka është marrë nga ju, j'ua falë gabimet, se All-llahu falë pa masë, se është mëshirues i madh”. (El-Enfal: 70).

Kjo ka të bëjë me djelmoshat, kurse pleqtë nëse u kthehen mëkateve pas Ramazanit, kjo është edhe më keq, sepse ekziston shpresa për kthim dhe pendim te djelmoshat në fund të ymrit të tyre, edhe pse edhe ai është në rrezik, ngase vdekja ka mundësi ta befasojë, kurse plaku ka arritur në bregdetin e detit të shpresave, nuk ka çka të shpresojë më shumë?!

Ta vajtojmë hijen e rinisë së thinjur
Të ka thirrur në emër të tjetërkujt
Bëhu gati për thirrjen e përfundimit
Se çdo gjë që vjen është afër
A nuk i shohim epshet e shpirtit
Harxhohen, kurse neve na mbesin mëkatet
Frikohen vetvetes ata që pendohen,
E si do të jetë gjendja e atyre që nuk pendohen.

(Letaiful-Mearif; fq. 400).

Bekir Halimi
14.12.2002

Kuptimi i dëshmisë së besimit

Dëshmia e besimit është kriteri vendimtar nga i cili njeriu gjykohet si një musliman apo një jobesimtar.

Kjo dëshmi është themelimi mbi të cilin është bazuar Islami. Koncepti i jetës, universit dhe njeriut është shpërndarë nga ai dhe mbi të është bazuar mesazhi i të gjithë të dërguarve duke filluar me Nuhun dhe duke përfunduar me Muhammedin, sal-lall-llahu alejhi be sel-lem.

All-llahu i Madhëruar thotë:

Ne nuk dërguam asnjë të dërguar para teje e të mos i kemi shpallur atij se: nuk ka zot tjetër përveç Meje pra më adhuroni. [El-Enbija:25]

All-llahu ka krijuar njerëzit dhe xhinët dhe pjesën tjetër të krijimit mbi llogarinë e dëshmisë së besimit nuk ka të adhuruar tjetër përveç All-llahut.

Si pasojë çdo gjë në këtë univers i nënshtrohet adhurimit të All-llahut të cilit i Takon krijimi dhe autoriteti.

Ai është i ditur për çdo gjë.

Kuptimi i dëshmisë së besimit

Dëshmia, 'La ilahe ila All-llah' përfshin dy koncepte: mohimin dhe pohimin.

E para: Dëshmia e besimit mohon atributet e hyjnisë të çdo njeri dhe çdo gjë tjetër përveç All-llahut, të Madhëruarit.

Te gjithë të tjerët përveç All-llahut të tillë si melekët, peygamberët dhe pjesa tjetër e njerëzimit, idhujt dhe rregjimet politike në botë, këto nuk janë zota dhe as që duhet të adhurohen.

Kështu mohimi në këtë aspekt nuk është mohimi i ekzistencës së zotave falls por mohimi i hyjnisë që i atribuohet atyre.

E dyta: Dëshmia e besimit pohon dhe ia jep hyjninë All-llahut të Vetëm. Që do të

thotë robi duhet të besojë që All-llahu është Zoti i Vetëm i vërtetë dhe të mos adhurojë askend tjetër përveç All-llahut.

Derisa adhurimi me të gjitha aktet dhe ritet duhet ti dedikohet vetëm një Zoti që e meriton atë, atëherë Zoti i vërtetë të cilin e adhurojmë duhet ti dedikohen disa attribute disa prej tyre janë:

1. Hyjnia, Njëshmëria e All-llahut i Cili është i njohur si Zot i vetëm, i vërtetë, i Cili nuk ka partner për të ndarë atributet e Tij hyjnore apo në dominimin e Tij

Ai është Një për të cilin të gjitha krijesat kanë nevojë.

2. I Vetmjaftueshëm. All-llahu nuk ka nevojë për askend. Ai nuk ka nevojë për ndonjë ndihmës as për një grua ose një djalë.

3. Ai ka aftësinë për të bërë çdo gjë. Nuk ka asgjë që asgjëson aftësinë e Tij. Ai bën çfarëdo që dëshiron pa lodhje ose mbështetje. Nëse Ai dëshiron të bëjë diçka, Ai vetëm i thotë asaj "Bëhu" dhe bëhet.

Ai ka një jetë absolute e cila nuk zhduket. All-llahu është i Fundit dhe Ai është i Përhershëm.

5. Ai është Vigjilent. All-llahu nuk fle as nuk është i pakujdesshëm, Atë nuk e zë gjumi dhe as shkatërrimi.

7. Ai është i Gjithëdijshmi. Dituria e All-llahut përfshin të gjithë universin madje edhe grimca nuk i ikë dijes së Tij. Ai është i njohur me të fshehtat dhe të dukshmet, të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen dhe Ai është i njohur me mendimet e brendëshme të njeriut.

8. Krenaria dhe Madhështia i përkasin All-llahut. Nuk ka asgjë më të madhe se All-llahu as se esenca e Tij as se Supremacia e Tij.

9. Ai është më i Mëshirshmi. All-llahu nuk gabon në asgjë dhe nuk dënon padrejtësisht. Ai i do të devotshmit e Tij dhe falë mëkatet e atyre që pendohen tek Ai.

Pra një gjë që posedon atribute të tilla meriton të adhurohet si Zot. All-llahu i Madhëruari, pas së gjithash është i vetmi që posedon atribute të tilla.

Ai është Mbreti, i Gjithfuqishmi, i Urti, i Vetmi, që njih të dukshmen dhe të padukshmen i Mëshirshmi, Mëshirëploti.

Vetëm Atij që i përkasin atributet hyjnore. Ai është një Zot i vërtetë i cili e meriton adhurimin dhe të cilin i gjithë krijimi e madhëron. Mu për këtë arsye dëshmia e besimit mohon të gjitha hyjnitë e tjera përveç All-llahut dhe pohon All-llahun e Vetëm sepse Ai është Zoti i vetëm i vërtetë.

All-llahu i cili është larg çdo papërsoshmërie dhe posedon atributet hyjnore.

Kjo hyjni përfshin:

E drejta për të vendosur ligje. All-llahu është Një i cili vendos ligjet për krijesat e Tij pra me këtë askush nuk mund të vendosë ligje për vetveten ose për të tjerët që nuk përkon me ato të All-llahut ose atyre të dhëna nga të dërguarit e Tij e askush nuk mund të formulojnë një tip adhurimi ose një rregullim për sjellje për individ dhe grupe.

Askush nuk ka të drejtë të vendosë për gjërat e lejuara ose të ndaluara sipas mendjes së tij.

E askush nuk ka të drejtë të vendosë një ligj dënimi sipas mendjes së tij por e drejta e tillë i takojnë vetëm All-llahut. Kushdo që i jep të drejtën vetes për të drejta të tilla ai supozohet sikur dëshiron të ngrisë vetëveten si Zot.

Kushdo që i bindet atij e ka marr atë për një zot në vend të All-llahut.

All-llahu i madhëruar ka përmendur që kristianët kanë marrë dijetarët dhe njerëzit e urtë si zota të tjerë përveç All-llahut vetëm

sepse ata i bindeshin atyre kur të njëjtit ndalonin gjërat që All-llahu i Ka lejuar dhe lejonin gjërat që All-llahu i ka ndaluar.

Ata e bënin këtë edhe pse e dinin që All-llahu është Zoti i vërtetë të cilit duhet ti dedikohet adhurimi edhe e dinin që All-llahu i pranon vetëm ato vepra adhurimi të cilat janë vendosur nga Ai dhe i Dërguari i Tij.

Pra ne duhet të njohim veprat e adhurimit kështu që t'ia dedikojmë ato vetëm All-llahut të Vetëm.

Tani që e dimë këtë ne e dimë që Ai ka krijuar krijesat që ta adhurojnë Atë.

Njeriu si pjesë e krijesave të Tij duhet t'ia dedikojë të gjithë jetën e tij adhurimit të All-llahut ai duhet t'i njohë ligjet e All-llahut duke i respektuar ato, kështu që çdo gjë të lejueshme që e bën me qëllim që t'i afrohet All-llahut e kthen në një vepër adhurimi.

Adhurimi është një përbërje e cila përfshin çdo fjalë dhe vepër të dukshme ose të fshehtë që All-llahu e do.

Duke pasur mundësinë për të lexuar këtë mesazh të shkurtër rreth kuptimit të dëshmisë së besimit dhe urdhëresave të saj ju jeni ndofta në padurim për ta deklaruar atë dhe për të aplikuar urdhëresat e kësaj dëshmie që janë të obliguara mbi personin që e deklaron atë?

Këto janë:

1. Besimi që All-llahu është një Zot i vërtetë të cilit vetëm duhet t'i dedikohet adhurimi. Ai është Një i cili i posedon të gjitha atributet e përsosura dhe i cili është larg nga çdo mospërsoshmëri e tillë si të ketë një partnere ose një djalë.

2. Besimi që All-llahu është Krijuesi i gjërave ekzistuese, Mbajtësi, Ai i cili i jep jetë dhe vdekje, Pronari i universit, i Vetmi Sundimtarë dhe Legjislatorë.

3. Besimi që All-llahu posedon atributet e perfektshmërisë dhe larg nga çdo të metë siç na ka informuar All-llahu në Kur'an dhe

Muhamedi, i Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në traditën e tij. Dy burimet e vetme nga të cilat ne njohim atributet e All-llahut.

Nëse Muhammedi do të gënjente kundër All-llahut, All-llahu defenitivisht do ta kishte dënuar atë.

Në të kundërt All-llahu e mbështeti atë me mrekulli që kanë provuar vërtetësinë dhe sinqeritetin në përhapjen e mesazhit nga Zoti i tij.

All-llahu thotë:

Sikur të trillonte ai (Muhammedi) për Ne ndonjë fjalë. Ne do ta kapnim atë me fuqinë tonë, e pastaj do t'ia këputnim atij arterien e zemrës. [El-Hakka : 44,45,46]

4. Marrja e besimtarëve për shokë dhe mbështetja e tyre.

All-llahu thotë:

“Muhammedi është i dërguari i All-llahut e ata që janë me të (sahabët) janë të ashpër kundër mosbesimtarëve, janë të mëshirshëm ndërmjet vete ti i sheh ata kah përulen (në ruku) duke rënë me fytyrë në tokë (sexhde) e kërkojnë prej All-llahut që të ketë mëshirë dhe kënaqësinë e tij ndaj tyre. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e gjurmës së sexhdes. Përshkrimi i cilësive të tyre në Teurat dhe po ky përshkrim është edhe në Inxhill. Ata janë si një farë e mbjellë ku mbin filizi i vet e ai trashet e forcohet dhe qëndron në trunqun e vetë ajo e mahnit mbjellesin. (All-llahu i shumoi) Për t'ua shtuar më ta mllëfin jobesimtarëve. All-llahu atyre që besuan dhe bënë vepra të mira u premtoi falje të mëkateve dhe shpërblim të madh. [El-Fet : 29]

5. Shmangja nga jobesimtarët dhe qëndrimi larg prej tyre.

All-llahu thotë:

Ju e keni shembullin më të mirë të Ibrahimit dhe te ata që ishin me të kur i thanë popullit të vet:

“Ne tërhiqemi prej jush dhe asaj që adhuroni pos All-llahut nuk besojmë tuajën, prandaj ndërmjet nesh dhe jush është e hapet armiqësia e urrejtja derisa ta besoni Vetëm All-llahun Një. (Nuk e keni shembull) Me përjashtim të fjalës së Ibrahimit thenë babait te vet: Unë do të kerkojë falje për ty te All-llahu! Zoti ynë vetëm Ty të jemi mbështetur vetëm nga Ti jemi të kthyer dhe vetëm nga Ti jemi të kthyer dhe vetëm te Ti është e ardhmja! [El-Mumtehine : 4]

Të mësipërmet janë disa urdhëra të dëshmisë së besimit si dëshmi e cila konsiderohet hyrje dhe pranim i Islamit dhe baza e tij.

Kushdo që e pohon atë me sinqeritet dhe aplikon urdhëresat e saj do të futet përfundimisht në xhennet me vullnetin e All-llahut.

Nëse një person i tillë ka bërë mëkate dhe ka vdekur pa u penduar është për All-llahun, Ai ta falë atë ose ta dënojë atë me zjarr por më vonë do ta nxjerr jashtë nga aty dhe do ta fusë në xhennet pasi që është pastruar nga mëkatet e tij.

Është përmendur në një hadith që Musa i Dërguari i All-llahut alejhis-selam e pyeti All-llahun për t'i treguar atij një vepër adhurimi dhe ta bëjë atë praktikë të tijën.

All-llahu i madhëruar e ka urdhëruar atë: ‘O Musa thuaj: Nuk ka zot që e meriton adhurimin përveç All-llahut. Musai tha: Zoti im! Të gjithë robërit tuaj e dëshmojnë këtë dëshmi.

Për të treguar kuptimin e dëshmisë së besimit All-llahu atëherë ka thënë: ‘O Musa sikur shtatë qiejt dhe shtatë tokat dhe të gjitha çfarë përmbajnë ato ti vendosim në një anë të peshores dhe “Nuk ka të adhurar tjetër përveç All-llahut do të vihej në anën tjetër të saj ajo do të peshonte me shumë nga ato.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem ka thënë:

“Ai i cili e përfundon jetën e tij me përmendjen e dëshmisë së besimit që të jenë fjalët e fundit para vdekjes ai do të futet në xhennet.”

Pohimi i dëshmisë së besimit duhet të bashkohet me përbushjen e kushteve të saj:

1. Dituria e cila konsiston në njohjen e All-llahut si Zot i vetëm i vërtetë të Cilit duhet ti dedikohet adhurimi dhe refuzimi i të gjithë zotave të adhuruar si të rrejshëm dhe që ata prej tyre nuk mund të përfitojnë e as të dëmtohen aspak.

2. Bindja që besimi në All-llah nuk duhet të njolloset me asnjë dyshim.

3. Pranimi i të gjitha kushteve të saj.

4. Nënshtrimi që është në përbushjen e kushteve të tij dhe i kënaqur me All-llahun si Zot dhe Muhamedin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, si i dërguari i Tij.

5. Besnikëria... që është përbushja e urdhërave me besnikëri.

6. Sinqeriteti që është të jetë i sinqertë në adhurimin e All-llahut duke i dedikuar të gjitha veprat e adhurimit Vetem Atij.

7. Dashuria për All-llahun të Madhëruarin dhe dashuria për të Dërguarin e Tij Muhamedin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem dhe dashuria për të devotshmit e All-llahut dhe njerëzit që i binden Atij.


Së fundi duhet të shoqërohet me dashuri në ndaj Tij, frikën e dënimit të Tij dhe Shpresën për shpërblimin e Tij, kërkimin e faljes dhe marrjen e mësimave të Pejgamberit të Tij Muhamedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është i fundit nga të Dërguarit e All-llahut dhe Sheriatin e Tij (ligjet dhe ritet fetare) i cili anulon të gjitha ligjet e mapërparshme (ligjet të cilat i janë zbritur pejgamberëve tjerë) dhe ritet fetare.

Ai përmban më të mirën e çdo sheriatit të mëparshëm.

Hamud M. El-Lahim

Përktheu: Ammar Ardit Kraja

14.11.2003



Abdullah Ibën Abbas në debat me Havarixhët

Debat i vjetër, mësim të vlefshme

Ekstremizmi gjithmonë ka qenë pjesë e shoqërive, feve dhe ideologjive, tek çdo njëri prej tyre. Disa mund të thonë se ai është pjesë e natyrës njerëzore – një pikë e dobët dhe e keqe në të – sepse njeriu ka treguar se është i aftë për ekstremizëm që më përpara në kohën kur Kabili vrau Habilin. Ai incident na tregon se sa injorant dhe intolerant mund të jetë njeriu. Moderniteti nuk e ka ndihmuar njeriun shumë për ndalimin e tij nga ekstremizmi i dhunës kundër qënieve njerëzore përmes koncepteve të tilla si skllavëria, kolonializmi, gjenocidi, holokausti dhe më aktualisht në formën e individit, grupit dhe madje megjithëse rrënjët e ekstremizmit gjithmonë brenda individit ose tërësisë së tij, jashtë faktorëve politik, ekonomik etj., mund të kenë një impakt të konsiderueshëm mbi kohën, intensitetin dhe gjrësinë e ekstremizmit. Dhe gjatë të kuptuarit të fakteve të tilla është e nevojshme për trajtimin e efektshëm ndaj ekstremizmit dhe nuk duhet të na bëjë ne që t'i mbivlerësojmë rreziqet e tij. Nëse është i vetë infektuar, brenda të njëjtës shoqërie ose feje, ekstremizmi i dhunshëm është i gabueshëm dhe duhet gjithomë të dënohet.

Si të gjithë të muslimanët e tjerë e kanë përjetuar pjesën e tyre të ekstremizmit, të brendshëm dhe të jashtëm. Shumë më para sesa incidenti i tmerrshëm i 11 shtatorit 2001, shumë musliman, në vende muslimane dhe jo-muslimane i kanë kundërshtuar dhe për një kohë të gjatë, të gjitha format e ndryshme të ekstremizmit, më të rëndësishmit që mund të përmenden janë grupet opo-

zitare që kanë qëllim për të ndryshuar qeveritë e vendeve të tyre. Çfarë i dallon këto grupe nga të tjerët (nga grupet e mëparshme) është që ata janë detyruar për të përdorur veprime militante ndaj qeverive të papërgjegjshme tirane që jo vetëm kanë grabitur lirinë e njerëzve dhe burimet e vendeve por tragjikisht e kundërshtuan opozitën me metoda çnjerëzore dhe vrasje aq të tmerrshme sa edhe vetë sasia e padrejtësisë. Kjo i ka çuar ata të zgjedhin një sy për një sy si metodë drejtësie. Si rezultat ekstremizmi i tyre arriti kulmin kur ata filluan t'i quanin këto qeveri dhe ata që ishin pjesë e tyre si jobesimtarë. Këto grupe të cilat i bënë këto qeveri dhe ata që i mbështesin ata, të brendshëm dhe të jashtëm, shënjestra legjitime të sulmeve të tyre. Ky lloj ekstremizmi ka një precedent në historinë tonë.

Analizat e këtyre grupeve, veprat e tyre, pse ata janë shfaqur dhe si t'i trajtojmë ata nuk është qëllimi i këtij artikulli. Ndërsa qëllimi i artikullit është për të parë një incident të ndodhur në të kaluarën e historisë tonë me qëllim të kërkuarit të urtësisë dhe mësimave që duhen marrë nga ai.

Havarixhët

Havarixh do të thotë “ata që janë prerë” ose “ata që janë ndarë”. Ata ishin një grup ekstremist i cili ishte në ushtrinë e Ali Ibën Ebu Talib kundër Muavijut. Kur Aliu halifi i katërt i drejtë i islamit dhe kushëri i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ranë dakord për të gjykuar midis vetes së tij dhe Muaviut, këta ekstremist u ndjenë të fyer që “Ligjet njerëzore ishin zgjedhur për gjykim ndërsa gjykimi ishte vetëm për Allahun”. Por

çfarë bëri Aliu nuk ishte në kundërshtim me ligjin e All-llahut ndërsa ai e përfshiu atë duke pasur për qëllim interesin më të mirë për komunitetin musliman. Qëllimi i tij ishte për të shmangur gjakderdhjen me çdo kusht. Duke mos qenë të aftë për të kuptuar veprat e tyre, Havarixhët e quajtën Aliun si një jobesimtarë dhe pastaj më vonë edhe e vranë atë. Megjithëse Aliu e dinte se ata përbënin një rrezik ai nuk ndërmori asnjë veprim ushtarak ndaj tyre duke thënë që ata ende nuk kanë kryer ndonjë krim.

Havarixhët e distancuan veten e tyre nga Xhemati (komuniteti) musliman, pikëpamjet e tyre u bënë më tepër e më tepër ekstreme dhe ata filluan ta shikonin çdo musliman që nuk ishte nga ata si një jobesimtarë dhe një shënjestër legjitime për të vranë.

Si të gjithë fanatizmat e tjerë, fanatizmi i tyre ishte vetë-shkatërrues. Devijimi i tyre politik i çoi ata të devijojnë në besim deri në atë pikë që ata e konsideruan çdo kënd i cili kishte kryer gjynahe të mëdha si një jobesimtarë. Megjithëse dukshëm ata ishin vështrues rreptë të detajeve të fesë dhe dukshin si të devotshëm, veçanërisht Havarixhët ishin një nga kërcënimet më të mëdha me të cilat ndonjëherë është ballafaquar ky Ummet.

Ka mësim të jashtëzakonshme që duhen mësuar nga shembulli i tyre i tmerrshëm. Ekstremizmi, fanatizmi dhe injoranca janë të këqija të mëdha që duhen shmangur dhe urreyer. Ne duhet të kuptojmë që ata shpesh shfaqen sikur janë të veshur me drejtësi dhe devotshmëri.

Diskutimi me Havarixhët

Kur Havarixhët u rritën në numër dhe ata formuan një ushtri me rreth 6.000 burra të cilët ishin gati të luftonin halifin legjitim, Aliun, radijall-llahu anhu, më vonë si një lider i përgjegjshëm, duke menduar se ata meritonin një shans për të shprehur shqetësimet e tyre dhe që t'i përgjigjen nga qeveria e tij, ai

vendosi të dërgojë një dijetarë, Ibën Abbasin, i cili kishte një reputacion të madh për të diskutuar çështjen me ta.

Tregimi i mëposhtëm i atij debati midis Abdullah Ibën Abbasit dhe Havarixhëve është i raportuar nga shumë burime muslimane autentike. Ky incident është i rëndësishëm sepse ka ndodhur në kohën e halifëve të drejtë dhe për shkak se ka përshkruar një situatë që është e njëjtë me situatën që ka prekur gati çdo musliman në dy dekadat e fundit.

Ibën Abbasi dijetari i madh i Kur'anit, një sahabë i të dërguarit të All-llahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka diskutuar me këta ekstremist në një mënyrë të zgjuar dhe të bukur si dhe gabimin e tyre e bëri të qartë për ta përmes dijes së tij të madhe.

Ibën Abbas transmeton:

“Kur 6.000 rebel të fuqishëm u grumbulluan për të rrëzuar Ali Ibën Ebu Talibin dhe përkrahësit e tij nga mesi i sahabëve të Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, njerëzit erdhën tek Ali Ibën Ebu Talibi për ta paralajmëruar për rrezikun e madh duke thënë: “O prijës i besimtarëve, ata njerëz me të vërtetë po bëhen gati për tu rebeluar kundër jush”. Ai iu përgjigj pyetjes “Lëri të veprojnë ashtu sepse unë nuk do të jem i pari që do ta ngrejë shpatën edhe pse unë e di se ata do ta ngrejë të tyren”.

Kështu një ditë unë iu drejtova Aliut: “O prijës i besimtarëve, a do ta vonosh faljen me xhemat pak për të më dhënë kohë për të shkuar tek ata njerëz dhe për t'i folur atyre? Ai i tha: “Unë frikësohem për sigurinë tënde”. Por unë e sigurova atë. “Jo, inshaAll-llahu” dhe “unë kam qenë një person shumë i edukuar i cili nuk i ka bërë dëm askujt”.

Unë pastaj u veshja në mënyrën më të bukur (Ebu Zamili ka transmetuar që Ibën Abbasi ishte një njeri i pashëm dhe një

ligjërues i rrjedhshëm me një zë të fuqishëm dhe hyra në vendin e rebelëve gjatë kohës që ata ishin duke pushuar gjatë mesditës së nxehtë. Kur unë erdha tek ata unë i gjeta ata në adhurim të devotshëm kur këmbët e të cilëve ishin bërë me kallo dhe fytyrat e tyre kishin shenja nga gjatësia e tyre e qëndrimit në sexhde. Veshjet e tyre ishin të ashpra në thurje dhe qerret e fytyrave të tyre tregonin për qëndrimin e gjatë në faljen e natës.

Kur unë hyra ata më përshëndetën mua "Mirëerdhe Ibën Abbas. Çfarë të solli këtu? Dhe çfarë është kjo që ke veshur?"

Unë i thashë "Çfarë më shihni keq në veshjen time të jashtme". Unë kam parë Pejgamberin sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, të vishte veshje më të mira, kurse All-llahu ka thënë:

"Thuaj: "Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e mira që All-llahu i krijoi për robtë e vet?". Thuaj: "Ato janë në këtë botë për ata që besuan, e në ditën e kijametit janë të posaçme për ta. Kështu i sqarojmë argumentet një populli që kupton. [Surah Araf :7:32]"

Ata pastaj thanë "Epo kush të solli këtu?"

Unë i thashë: "Unë kam ardhur të flas me ju rreth sahabeve të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem të cilët janë me dhëndërin e Pejgamberit salallahu alejhis ua selam. Shpallja u zbrit midis tyre dhe janë ata që e dinë më mirë kuptimin e saj dhe përmbahuni se asnjëri prej tyre nuk është midis jush. Dhe unë isha paralajmëruar ndaj diskutimit me ju sepse All-llahu ka thënë:

".... ata janë njerëz ngatërrestarë. [Surah Zuhruf:43:58].

Por pak kishte nga ata që më këshilluan të vij dhe të flas me ju".

Unë i thashë atyre: "Më tregoni se çfarë keni kundër kushëririt të Pejgamberit Sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i cili ishte gjithashtu edhe dhëndëri i tij dhe i cili ishte i pari

të besojë në të dhe kundër sahabeve të cilët janë me të? Ata thanë: "Tre ankesa".

Unë i thashë që të mi thonin dhe ata u përgjigjën: "Ai lejoi gjykimin njerëzorë kur All-llahu ka thënë:

"...vendimi (gjykimi) nuk i takon kujt, pos All-llahut". [Surah Jusuf:12:40].

Çfarë roli kanë qeniet njerëzore kur All-llahu e ka kufizuar gjykimin vetëm për veten e Tij?

Unë i pyeta ata për ankesën e dytë kështu ata thanë: "Ai luftoi por nuk mori dhe nuk i robëroi të kapurit (të burgosurit e luftës) dhe as nuk mori plaçkë lufte. Nëse ai luftoi kundër jobesimtarëve atëhere orenditë e tyre ishin plaçkë lufte për ta dhe nëse ata ishin besimtarë si mundet të derdh gjakun e tyre?"

Së fundi unë i pyeta ata për ankesën e tretë dhe ata u përgjigjën: "Ai e ka larguar titullin "Udhëheqës i besimtarëve". Nëse nuk është udhëheqës i besimtarëve atëhere ai duhet të jetë udhëheqës i jobesimtarëve".

Unë i pyeta ata nëse kishin ankesa të tjera por ata thanë që këto ishin të mjaftueshme. Kështu unë i pyeta që nëse unë do t'i recitoja atyre versete nga Kur'ani dhe t'i transmetoja atyre nga hadithe të pakundërshtueshme të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, çfarë do të refuzojë argumentet e tyre, a do të ndryshonin mendimet e tyre dhe a do ta ndalnin rebelimin e tyre? Ata u përgjigjën në mënyrë afirmative – pohuese.

Unë i thashë: "Përsa i përket argumentit tuaj të parë, Allahu ka thënë:

"O ju që besuat, mos e mbytni gjahun (në lojë apo argëtim), duke qenë ju në ihram.....për këtë çështje vendosin dy njerëz të drejtë nga mesi juaj..."[Surah Maide 5:95].

Dhe Ai ka thënë rreth një gruaje dhe burrit të saj:

"Nëse i frikësohen përçarjes mes tyre (burrit e gruas), dërgoni një pari të drejtë

nga familja e tij dhe një pari të drejtë nga familja e saj. Nëse ata të dy (ndërmjetësuesit) kanë për qëllim pajtimin, All-llahu ju mundëson afrimin mes tyre (burrit e gruas). All-llahu është i dijjeshëm, është njohës i mirë”. [Surah en-Nisa:4:35].

Unë ju pyes ju cila është më e rëndësishme. Lejimi i ndërmjetësimit në lojra dhe çështjet e martesës apo lejimi i tij në çështjet e bashkimit dhe shpëtimit të jetëve të muslimanëve? Dhe ju e dini shumë mirë se nëse All-llahu do të kishte gjykuar mbi ato çështje që në fillim do ta kishte ndaluar çdo ndërmjetësim që në fillim”. Ata u përgjigjën: “Në çështje të bashkimit dhe shpëtimit të jetëve të muslimanëve”. Unë e pyeta: “A e pranoni argumentin tim?”. Ata thanë: “Uallahin. Ne e pranojmë”.

Unë i thashë: “Përsa i përket kundërshtimit tuaj mbi faktin që ai nuk robëroi të burgosurit dhe nuk mori plaçka lufte, a do ta kishit burgosur ju nënën tonë, Aishen? Apo a do t’ia kishit lejuar vetes që ta robëronit atë? Nëse do t’ia kishit lejuar vetes këtë ju nuk do të kishit qenë musliman dhe nëse ju thoni që ajo nuk është nëna e besimtarëve atëhere ju prapë nuk do të ishit musliman. All-llahu ka thënë:

“Pejgamberi është më i ndjeshëm ndaj besimtarëve se sa ata ndaj vetë vetvetes së tyre, ndërsa gratë e tij janë në vend të nënave të tyre”. [Surah Ahzab:33:6].

Ju shkëmbeni midis dy gënjeshtrove në mënyrë kontradiktore, kështu zgjidhni për veten tuaj. A e pranoni ju këtë argument? Ata e shikuan njëri-tjetrin dhe pastaj thanë: “Uallahin, Ne e pranojmë”.

Unë i thashë: “Përsa i përket titullit të “Udhëheqës i besimtarëve” unë do t’ju përgjigjem kësaj ankese me një gjykim që ju do ta gjeni të kënaqshëm. Kur Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, i ka pyetur Kurej-

shitët për të firmosur marrëveshjen e Hudejbijes, ai sal-lallahu alejhi ve sel-lem, dhe të dy Suheil Ibën Amër dhe Ebu Sufjani që prezantonin jo-besimtarët ishin zgjedhur si përfaqësues të njerëzve të tyre për të firmosur këtë marrëveshje. Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, i ka thënë Aliut të shkruaj: “Kjo është çfarë Muhammedi, Pejgamberi i All-llahut ka rënë dakord” por ata (duke nënkuptuar jobesimtarët) e kundërshtuan këtë thënie: “Po të kishim besuar që ti je Pejgamber i All-llahut, ne nuk do të bllokoni hyrjen tënde tek Shtëpia e All-llahut dhe ne nuk do të kishim luftuar me ty. Ali, shkruaj Muhammed Ibën Abdullah”. Ai iu përgjigj: “Unë jam me të vërtetë Pejgamber i All-llahut megjithëse ju e refuzoni atë. Shkruaj o Ali, Muhammed Ibën Abdullah. Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem ishte shumë më i mirë sesa Aliu dhe mospërmendja e titullit të Pejgamberit (gjatë kohës së firmosjes së marrëveshjes) nuk e zhvlerësoi Pejgambersinë e tij. A e pranoni këtë argument? Ata thanë: “Uallahin, Ne e pranojmë”. [Musannefu i Abdur-Razakut, Bejhakiu dhe Ahmedit].

Nga aspektet kryesore që ne kemi nevojë t’i njohim mbi këtë debat janë argumenti dhe kundër argumenti me përshkrimin e atyre rebelëve sipas Ibën Abbasit dhe mënyrës së operimit (menhexhit) të rebelëve dhe sesi ata dukeshin si shumë të devotshëm.

Le të ecim përmes këtij transmetimi me qëllimin për të fituar një pikëpamje brenda asaj se si muslimanët e parë u përballën me sfidat më të mëdha që i dolën para dhe të mësojmë mësimet që mund të na ndihmojnë për të depërtuar përmes vetë sfidave tona.

Të kuptuarit sipërfaqësor mund të jetë shkatërrues.

Të kuptuarit e Havarixhëve mbi verset e Kuranit dhe fakteve ishte sipërfaqësorë, i pa

kompletuar dhe i bazuar vetëm mbi kuptimet sipërfaqësore të teksteve. Përfundimet e tyre ishin naive dhe sipërfaqësore për shkak se ata nuk u përpoqën të mësonin urtësinë dhe kuptimin e plotë të këtyre verseteve dhe si rezultat ranë pre e pasigurive të vetvetës së tyre e të përfundonin në rezultate të tmerrshme që ishin irracionale dhe shkatërruese.

Ata u mbështetën mbi fakte të pjesëshme dhe ishin injorant ndaj pjesës tjetër ose dështuan t'i vendosnin ata në vendin e tyre. Të bazuarit e gjykimit në fakte të pjesëshme shkatërron qëllimin e të kërkuarit të vërtetës dhe arritjes së parimeve të drejta. Kur Ibën Abbasi i prezantoi rebelët me fakte të tjera që anuluan ankesat e tyre, ata nuk mundën t'ia kthenin atij mbrapsht argumentet. Imam Esh-Shatibi ka treguar arsyet pse disa metoda të "nxjerrjes së gjykimit" me siguri çojnë në gjykime të gabuara kur ka thënë se "Injoranca e qëllimeve finale dhe e urtësisë së Sheriatit dhe hamendja (ndryshe nga vendosja racionale) dhe joutësia e plotë e faktit, mungesa e të kuptuarit dhe kërcimi në përfundime pa një llogaritje të qartë nuk janë shenja të një dije të shëndoshë". Ky fakt i vetëm ishte shkaku i rrëzimit të shumë sekteve në islam, duke përfshirë ata Havarixhët me të cilët Ibën Abbasi diskutoi. Gati të gjitha grupet që përkrahin dhunën sot vuajnë nga këto shenja. Çfarë është e vështirë për çdo person të kuptojë sesi ata mendojnë se vrasja kuturu dhe shpërthimet janë korrekte nga nja pikëpamje islame ose se do t'i ndihmojnë në çështjen e tyre? Por kur ne shohim faktin se ata vazhdojnë të bëjnë të njëjtën gjë madje edhe pasi dijetarë të famshëm i kanë kundërshtuar metodat e tyre dhe madje edhe pse ata e panë ndikimin negativ të veprave të tyre dikush e gjen të lehtë për të kuptuar çfarë Pejgamberi, sal-

lall-llahu alejhi ve sel-lem ka thënë duke përshkruar Havarixhët "ata dalin nga mbulesa e islamit në të njëjtën mënyrë si një shtizë që shkëputet nga shigjeta".

Bashkimi i muslimanëve

Bashkimi i muslimanëve është një qëllim sublim i liderit musliman. Qëllimi i Ali Ibën Ebu Talibit mbi çështjen ishte shmangia e konfliktit me çdo kusht. Dhe nëse rebelët nuk do t'i shpallnin luftë atij ai ishte i vendosur se nuk do t'i luftonte ata. Lufta midis muslimanëve vetëm shërben për t'i dobësuar ata.

Ky qëllim ishte i njëjtë edhe në qendër të përpjekjes së Ibën Abbasit për konsultim. Ai nuk e humbi asnjë përpjekje për tu takuar me rebelët, dëgjimin e argumenteve të tyre, diskutimit me ta, duke i informuar ata për të keqkuptuarit të tyre përsa i përket qëndrimin të Ali Ibën Ebu Talibit dhe përpjekjes për bashkimin me maxhorancën. Kjo mënyrë veprimi është e nevojshme për të gjithë anëtarët e Ummetit në mënyrë për të penguar dobësimin e muslimanëve dhe për të siguruar bashkimin e tyre.

Bashkim, por në rrugën e drejtë

Ky mesim është mesimi më i rëndësishëm i këtij trasmetimi, mënyrat dhe rrugët drejt arritjes së bashkimit të Ummetit musliman. Gjëja e parë që vjen në mendje është që bashkimi i muslimanëve nuk mund të arrihet përveç përmes rrugëve dhe mënyrave që janë në vijë me qëllimet e kësaj feje dhe në përputhje me parimet e përgjithshme dhe kufizuese. Muslimanët adhurojnë vetëm All-llahun duke u përpjekur për tu bashkuar nën udhëzimin e tij dhe muslimanët e adhurojnë vetëm All-llahun me çfarë Ai i ka urdhëruar. Rrugët dhe mënyrat që janë në kundërshtim me mesimet e islamit nuk mund të mbështetemi për të bashkuar muslimanët.

Si rrjedhim muslimanët duhet të kthehen mbrapa tek burimet dhe t'i shmangen mëny-

rave devijuese. Ata duhet të jenë të veshur me të kuptuarit të drejtë, të udhëzuar nga urtësia e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem dhe sahabeve të tij të cilët ishin më afër burimeve të islamit dhe ishin të veshur me veglat e nevojshme të njihnin më së miri urtësinë. Një shembull i shkëlqyeshëm i rru-gëve se si muslimanët e kanë parë bashki-min në kohëra të vështira është i parë në transmetimin e Ibën Abbasit.

Qëllimi i Ibën Abbasit ishte të bashkonte rebelët me pjesën tjetër të Ummetit musliman. Për të arritur këtë qëllim ai së pari paraqiti bazat për debatin e tij me ta, pastaj ai dëgjoi ankesat e tyre dhe pastaj ai vazhdoi të demaskojë argumentet e tyre të dobëta. Bazat e Ibën Abbasit të cilat iu paraqitën atyre ishte mbështetja mbi dy burime të islamit të quajtura Kur'an dhe Sunnet. Pastaj ai i paraqiti atyre parimin udhëzues të këtij debati i cili ishte interpretimi i një versi dhe një hadithi ata u kthyen mbrapa në të kuptuarit e sahabeve të Pejgamberit salallahu alejhis ua selam. Ne e pamë sesi ata e pranuan korrektësinë e argumenteve që Ibën Abbasi prezantoi. Si rezultat për ata që e ndjekën duke pranuar, ishte bashkimi i tyre me pjesën tjetër të Ummetit musliman, por ata që vetëm verbalisht i pranuan por që qëndruan me mendimin se vetëm ata janë korrekt, përfunduan në lufta dhe duke humbur shumë.

Rruga e Bashkimit të muslimanëve është e shtruar me dy burime të kësaj feje. Çdo rrugë tjetër që mund të marrin mund të çojë në humbjen e tyre. Është shumë e rëndësishme që muslimanët të mos e shikojnë bashkimin si një përfundim për të përdorur çfarëdo mënyre. Bashkimi i muslimanëve që përfshin besime jo-muslimane dhe praktika nuk do të kenë efekt dhe rreshtat që rezul-

tojnë nga një bashkim i tillë do të jenë të shpartalluar.

Të konsiderojmë se çfarë ka thënë All-llahu:

“Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e All-llahut, e mos u përçani! Përkujtojeni nimetin e All-llahut ndaj jush, kur ju (para se ta pranoni fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij aguat të jeni vëllezër. Madje ishit në buzë të greminës së xhehennemit, e Ai ju shpëtoi prej tij. Po kështu All-llahu ua sqaron juve argumentet e veta që ju të gjeni të vërtetën e lumtur”. [Sure Ali Imran 3:103]. Esh-Shatibi ka komentuar këtë verset duke thënë: “Bashkimi është një rezultat i të kapurit të të gjithëve me vendosmëri tek një litar por nëse çdo grup njerëzish mbahen për litarë të ndryshëm, përçarja është si rezultat”.

Kjo është e shpjeguar edhe në këtë verset:

“Dhe se kjo është rruga (feja) lme e drejtë (që e caktova për ju), pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t'ju ndajnë nga rruga e Tij. Këto janë porositë e Tij për ju, ashtu që të ruheni”. [Surah En-Am 6:153].

Ndjekja e rrugëve të cilat nuk i përkasin rrugës së vërtetë të All-llahut nuk janë produktive dhe nuk mund të arrijnë bashkimin e dëshiruar. Çdo musliman dëshiron të bashkohet me vëllezërit dhe motrat musliman dhe çdo musliman ndien dhimbjen e përçarjes dhe sëmundjen që ka rënë. Dhe çdo muslimani i vjen keq për gjendjen e tashme të Ummetit musliman por përgjigjeja e kësaj dileme të cilën All-llahu e ka përshkruar nuk mund të gjendet përveçse aty ku All-llahu e ka shpallur dhe aty ku i dërguari i Tij e ka shpjeguar.

Pikëvështrimi islam është shenjtërorë

Ne mësojmë nga ky transmetim metodën e vlerësimit të njerëzve për qëllim të sigurimit të rolit të tyre në këtë Ummet. Havarixhët me të cilët Ibën Abbasi bisedoi ishin të devotshëm në adhurimin e All-llahut por kjo nuk i përmbush gjithmonë të gjitha shkaqet e mjaftueshme për t'i besuar atyre përgjegjësinë e këtij Ummeti. Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem i dha një shembull njerëzve që do të vijjnë të cilët ishin shumë të njëjtë, në mënyrat e tyre të adhurimit, me Havarixhët: "Ju do të keni një opinion të ulët për namazin tuaj kur do ta krahasoni me të tyrin". Ibën Abbasi i ka përshkruar Havarixhët me fjalë të njëjta kur ai ka thënë: "...unë i gjeta adhurues të devotshëm të cilëve duart i ishin bërë me kallo dhe fytyrat e tyre mbanin shenjat e sexhdeve të tyre të gjata". Për kundër kësaj devotshmërie këto Havarixhët mbjellën farën e përçarjes dhe rebelimit që shkaktoi vuajtje të mëdha dhe gjakderdhje. Dijetarët i përmendin ata me të vetmin qëllim për t'i paralajmëruar muslimanët nga ekstremizmi i tyre dhe për të ndriçuar arsyet që i ka çuar ata atje.

Metodologjia e qartë islame në vlerësimin e njerëzve është një pikëpamje e shenjtë që nuk bën dallim midis besimit të një individit me veprat e tij apo asaj; të dyja duhet t'i përmbahen esencës së besimit islam dhe të ndjekin etikën dhe kufijtë. Së pari në rregullin e përgjithshëm vjen Imani (besimi). Besimi i muslimanit duhet të jetë i lirë nga besime të mjegullta dhe dogma të shtrembëra dhe kur kjo është e siguruar, aspekte të tjera të sistemit të besimit dhe vepra duhen konsideruar. Nëse ne i konsiderojmë havarixhët të devotshëm ndaj All-llahut pa i hulumtuar planet e veprave të tyre dhe mënyrën e tyre metodologjike ne duhet t'i rradhisim ata me muslimanët më të drejtë të të gjitha kohërave. Vlerësimi i sistemit të besimit të Havarixhëve

është përkrah veprave të tyre së bashku me praktikën e përditshme të jetëve të tyre është metoda korrekte e studimit të çështjes së tyre dhe mësimi nga ai.

Një tjetër mësim që del nga ky transmetim është që ne nuk duhet të vendosim askënd në një pedestal dhe ta konsiderojmë atë si një martir apo si dikënd që i janë fshirë të gjitha gjynahet për shkak të devotshmërisë së tij.

Të kuptuarit e drejtë (të metodës islame) sjell stabilitet dhe siguri

Është e qartë që nga fillimi i debatit të transmetuar më sipër madje edhe pas vetëm një ankese të përgjigjur që çështja e rebelëve ishte një çështje sipërfaqësore. Kjo pikë ka nevojë për më tepër hetim.

Ne shohim që ata të cilët shprehin një ide si kjo tepër sipërfaqësore pa e hulumtuar dhe ndjekur metodologjinë korrekte, kërcejnë nga një vagon në tjetrin. Një musliman i cili është duke u përpjekur në rrugën e Allahut ose për të rindërtuar shoqërinë ose për të përmirësuar statusin e islamit midis muslimanëve, duhet të armatoset me të kuptuarit e drejtë të fesë dhe urtësisë së saj. Është e dukshme që muslimanët e rinj të cilët lëvizin kryesisht me emocione ose do ta humbin këtë entuziazëm të tërin ose do të vazhdojnë të ndryshojnë aleancën. Një shembull i mirë për të parë dhe për të mësuar sesi të konsolidojmë burimet autentike të islamit në mëndjet dhe zemrat e një muslimani është historia e Kab Bin Malikut (njërit nga tre sahabet i cili ishte dënuar për mos marrjen pjesë në luftën e Tabukut me bojkotimin e tërë nga muslimanët) kur ai mori një ftesë për azil larg nga shtëpia e tij. Ai thjeshtë e hodhi ftesën në zjarr përkundër vështirësive të mëdha që ai i përjetoi ato ditë.

Objektiviteti dhe drejtësia

Fakti që Ibën Abbasi nuk ndau ideologjinë e Havarixhve por ishte në fakt kundër tyre, nuk e pengoi atë të përmend virtytet e mira të tyre. Ky është një mësim që duhet mësuar nga ata të cilët përpiqen të thërrasin njerëzit tek All-llahu, të tregohen të drejtë me ata të cilët janë në kundërshtim, t'i identifikojnë të mirat e tyre dhe të bëhen të sigurtë për të ndërtuar mbi të kur t'i thërrasin ata tek rruga e drejtë.

Rëndësia e faljes me xhemat

Mësimet e mësuara nga ky transmetim natyrisht do të ishin vetë-shpjeguese. Megjithatë çdokush e gjen të rëndësishme për ta sjellur dhe për ta detajuar në pika me shpresë që do të na kujtojnë ne të gjitha pikat e rëndësishme që gjenden.

Një pikë më shumë rëndësi është e transmetuar nga Ibën Abbasi duke pyetur Ali Ibën Ebu Talibin për të vonuar pak faljen me xhemat për t'i dhënë atij kohë për të shkuar të bisedojë me Havarixhët. Përkundër rëndësisë së madhe të misionit të tij për këshillim, Ibën Abbasi u sigurua se nuk do ta humbte asnjë dalje me xhemat me muslimanët.

Mësimi i nxjerrë këtu është që një musliman duhet të respektojë të gjitha detyrat e tjera fetare dhe të mos sakrifikojë një për një tjetër veçanërisht kur çështja në fjalë është një nga prioritetet e kësaj feje, të tilla si namazi.

Mësime për ata të cilët i ftojnë të tjerët tek Allahu

Muslimanët të cilët janë duke i thirrur të tjerët në islam, duke përfshirë këtu edhe muslimanët nuk duhet të dorëzohen lehtësisht dhe të dëshpërohen nga misioni i tyre. Madje edhe kur një grup i muslimanëve devijon nga rruga e drejtë dhe insiston në të vepruarit kështu deri tek një pikë ekstreme është e mundshme që shumë prej tyre do të kthehen mbrapa tek islami i vërtetë duke i dhënë kohë, përpjekje dhe durim. Një tjetër aspekt nga kjo është fakti që shumë lider të sekteve të devijuara do të pengojnë ndjekësit e tyre për të dëgjuar të tjerët, nga frika se mos ata gjejnë greminat e tyre e vetë mënyrave të tyre.

Mësimet që nxjerren nga ky transmetim nuk janë të kufizuara tek vetë tetë pikat e mësipërme por shumë të tjera janë lënë për lexuesin të mendojë. Ne do të tregojmë në mënyrë të shkurtër vetëm pak prej tyre:

1. Si të debatohet me grupet të cilat kanë devijuar nga rruga e drejtë.
2. Individët e kualifikuar mund të dalin vullnetarë për misione të rëndësishme të mëdha.
3. Sinqeriteti është i pamjaftueshëm për korrektësinë e veprës.
4. Një musliman i cili i thërret njerëzit tek All-llahu duhet të përziehet me njerëzit dhe të jetojë ku ata jetojnë dhe rrinë.
5. Ai nuk duhet të zemërohet nëse kritikohet personalisht.
6. Rëndësia e kërkimit të lejes liderit kur përpiqemi të kryejmë një vepër.

Marrë nga: Revista "El-Xhumua"
Përktheu: Ammar Ardit Kraja
21.11.2003

Gruaja - shoqe dhe bashkëshorte

“Dhe nga treguesit e Tij se Ai ju krijoi juve gra në mesin tuaj, që ju të gjeni prehje tek ato dhe Ai vendosi mes jush dashuri e mëshirë.” (Err-Rrum, 21)

Shumë njerëz gabojnë dhe gruan e tyre e konsiderojnë vetëm si objekt seksual. Me këtë, ata jetën e tyre dhe të grave të tyre e bëjnë të shkretë dhe të vobektë. Burrat e lumtur janë ata të cilët gratë e tyre i zënë shoqe me plotkuptimin e fjalës. Këtë shoqëri e miraton edhe vargu i shenjtë kur'anor dhe e quan dashuri e mëshirë. E ka qëlluar ai që ka thënë: “Martesa e cila nuk i jep bashkëshortëve më tepër se kënaqësinë seksuale, nuk meriton të quhet martesë. Lumturia në martesë shpeshherë vazhdon të ekzistojë edhe në qoftë se në mes të bashkëshortëve mungon lidhja seksuale për ndonjë arsye. Logjikisht, sikur martesë të mos themelohej në bazë tjetër veç në lidhje seksuale, ajo do të ishte burim i një vuajtjeje të madhe, sepse që të ngopen shpirtërat para se të ngopen trupërat, martesë duhet të qëndrojë në themel më të thellë se sa lidhja seksuale.”

Dikush tjetër ka thënë: “Nuk është e drejtë thënia se gruaja është mjet kënaqësie në dorën e burrit. Dashuria për të mbjellet në zemrën e tij qysh në ditët e fejesës, dhe ai nis ta ndërtojë atë dashuri vazhdimisht. Kjo dashuri vazhdon më tutje kur ajo bëhet grua dhe shoqe e jetës së tij dhe nënë e fëmijëve të tij. Burri i cili interesohet për lumturinë e gruas së tij, prej së cilës – pa

dyshim – varet edhe lumturia e tij, duhet ta dijë se lumturia i tejkalon kënaqësitë e shqisave. Lumturia do të thotë më shumë se sa kjo. Lumturia është bashkim i zemrave, shkëmbim i ndjenjave të dashurisë dhe përkujdesje që të sigurohet gruaja me dashuri e dhembshuri që të fitohet besimi i saj.” Sa e bukur është jeta e bashkëshortëve që në të njejtën kohë janë edhe shokë. Dhe sa e shëmtuar është jeta e bashkëshortëve të cilët aktrojnë në teatrin e jetës së shtazëve!

Gruaja nuk duhet të kërkojë shkurorëzim pa të drejtë

“Aroma e xhennetit është e ndaluar për secilën grua që kërkon shkurorëzim pa arsye.” (El-Hakimi, Et-Tirmidhiu, Ibën Maxhe. Sahih)

Shpërblimi për gruan e cila i bindet burrit të saj

“Gruaja e cila i fal pesë namazet (ditore), e agjëron muajin (ramazan), e ruan organin e nderin e saj dhe i bindet burrit të saj, le të hyjë nga cila portë e xhennetit që të dëshirojë.” (Ebu Naimi në El-hilje. E arrin gradën hasen dhe sahih)

Nga Husajn Ibën Muhsan përcillet të ketë thënë: “Më ka treguar halla ime: - Shkova tek i Dërguari i All-llahut për një nevojë, e ai më pyeti: - A ke burrë? Thashë: - Po. Më tha: - Po si je me të? Thashë: - Nuk kam vërejtje në bindje dhe shërbim për të, aq sa të kam mundësi. Tha: - Shiko se si je me të, sepse ai është xhenneti dhe xhehenemi yt!” (Et-Tirmidhiu me sened Sahih)

“Çdo grua e cila vdes dhe burri i saj është i kënaqur me të, hyn në xhennet.”(Et-

Tirmidhi, Sahih)

Muhammed El-Istanbuli

Marrë nga: Libri me titull "Tuhfetularus"

Përktheu: Gëzim Selaci

27.06.2003

Porositë e para për fëmiun

Imam Ibënul-Kajjimi në librin e tij Tuhfetul-mevdud bi ahkamil-mevlud thotë: “Kur të afrohet koha për fëmiun që të flasë, në mënyrë që t’ua lehtësojmë e t’u ndihmojmë në të folur mund t’ua lagim gjuhën me mjaltë. Kur të nisin të flasin, le t’u shqiptohet atyre La ilahe il-lall-llahu, Muhammedun resulull-llahu, dhe fjalët e para që u trokasin në vesh le të jenë: All-llahu Lavdiplotë, teuhidi (Teuhid është besimi themelor islam që tregon të qenurit e All-llahut Zot i vetëm, i pashoq dhe kuptimet tjera që tërheq ky pohim), se All-llahu është mbi Arshin (fronin) e Tij, se Ai i sheh ata dhe dëgjon fjalët e tyre dhe se Ai është me ta kudo që të jenë.”

Pejgamberi e ka porositur Ibën Abbasin kur ky ishte ende i vogël me këto fjalë: “Djalosh! Po t’i mësoj disa fjalë: ruaje (respektoje etj.) All-llahun e Plotfuqishëm dhe Ai të ruan ty; ruaje (respektoje etj.) All-llahun, do ta gjesh në anën tënde! Kur të kërkosh,

kërko nga All-llahu; e kur të nevojitet ndihma, kërko nga All-llahu! Dhe dije se poqë se i gjithë populli mblidhet për të të bërë një të mirë, nuk do të kenë mundësi të të bëjnë asnjë të mirë që nuk ta ka caktuar All-llahu; dhe sikur të mblidhet gjithë populli për të bërë një të keqe që nuk ta ka caktuar All-llahu, nuk do të kenë mundësi të bëjnë asnjë të keqe. Janë tharë lapsat dhe janë ngrihur fletët.” (Ahmedi në El-Musned, Et-Tirmidhiu. Sahih).

Ky hadith përmban themelet më të mëdha të teuhidit, duke porsitur për respekt dhe bindje ndaj All-llahut, për kërkimin e ndihmës vetëm nga Ai, për besim dhe mbështetje tek Ai, për besim në paracaktimin e Zotit që mbjellin në zemër krenari, vetëbesim, vullnet për punë dhe drojë nga All-llahu dhe nga askush tjetër pos Tij. Krahaso gjendjen faktike të shumicës së muslimanëve sot me këtë porosi të artë pejgamberike!...

Muhammed El-Istanbuli

Marrë nga: Libri me titull "Tuhfetularus"

Përktheu: Gëzim Selaci

04.07.2003

Vallëzimi i grave

Së pari: Një grua që vallëzon përpara burrit të saj

Së dyti: Vallëzimi i saj përpara grave të tjera

Së treti: Dabka e kryer nga burrat

Përsa i përket pjesës së parë kur gruaja vallëzon përpara burrit të saj. Nëse vallëzimi i saj është natyral dhe jo profesional (dukë kuptuar me këtë që ajo ka mësuar të vallëzojë siç është e modës në këtë kohë) madje edhe nëse i shton dëshirat e burrit atëhere nuk ka tekst (nass) që mund të gjendet që ndalon këtë. Por është kusht që kjo të ndodh vetëm midis saj dhe burrit të saj. Për sa i përket rastit kur ajo ka mësuar të vallëzojë dhe ajo e aplikon principet e vallëzimit modern atëherë kjo nuk është e lejuar. Kjo ngase unë besoj që nëse ajo e bën atë përpara burrit të saj atëhere ajo mund ta bëjë gjithashtu përpara burrave të tjerë krahas burrit të saj.

Për sa i përket vallëzimit të saj përpara grave të tjera atëhere unë gjithashtu them nëse objektivi i saj në vallëzim është të vallëzojë këtë vallëzim modern atëherë është e qartë që nuk është e lejuar. Dhe nëse është thënë: "Cila është fakti për të cilën ke folur?" unë them: Moderimi në çështjet është i rrallë; ose ka teprim ose ka neglizhencë. Kjo është veçanërisht rasti me njerëzit të cilët kanë jetuar një periudhë të gjatë kohore në devijimin e një natyre specifike. Atëhere kur bëhet e qartë atyre që kjo çështje ishte një devijim dhe që feja e refuzon atë, ata kthehen nga ajo dhe prezantojnë në vend të saj një reagim të ashpër.

Kjo është çfarë na ka rënë në në kohën e sotme për sa i përket çështjes së kërkimit të faktit në vend të çlirimit të ndjekjes së verbër (Taklidit). Muslimanët, që të dy palët, të veçantët dhe të zakonshmit kanë jetuar gjenerata të gjata pa ditur asgjë për medhhebin e filanit

dhe filanit dhe medhhebin e filanit dhe filanit - katër medhhebet, medhhebet e Ehlul Sunne vel Xhema. Dhe kjo nuk përfshin medhhebet e tjera ato që kanë devijuar nga Sunneti dhe Xhemati. Për sa i përket të mbështeturit me atë që Allahu dhe i Dërguari i Tij, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kanë thënë atëhere kjo është vetëm e gjetur në gjeneratat që e kanë marrë dëshminë e shkëlqimit të tyre. Atëhere ajo çështje erdhi në fund të saj në një kohë derisa erdhi koha e Ibën Tejmijjes dhe studentëve të tij të cilët ishin të devotshëm ndaj tij. Kështu ata i informuan muslimanët për obligimin e kthimit tek ajo çfarë selefët kanë ndjekur të tillë si mbështetja në Kur'an dhe Sunnet.

Nuk ka dyshim se thirrja e Ibën Tejmijjes dhe studentëve të tij kishte një efekt pozitiv. Megjithatë thirrja e tij ishte shumë e dobët gjatë kohës së tij dhe pasiviteti intelektual (mbi reflektimin e fakteve) u përhap dhe u bë dominant midis klasave të veçanta të njerëzve duke mos përmendur të zakonshmit.

Atëhere ata ndoqën gjeneratat e ardhshme në të cilat ky ri-zgjim i Ibën tejmijah-s u shua. Dhe muslimanët iu kthyen edhe njëhere indeferencës së të kuptuarit të fakteve deri në kohën tonë dhe një kohë të shkurtër përpara saj sepse shumë dijetarë u ngritën për të marrë barrën për ringjalljen e Daut-s për shkak të nevojës për t'iu kthyer Kur'anit dhe Sunnetit. Ata ia kanë dalë me sukses në disa prej tyre nga Muhammed Ibën Abdul Uehab sepse në realitet ai foli për kthimin në Kur'an dhe Sunnet. Por duke parë zonat në të cilat Arabët e Nexhdit gjatë kohës që Shejkh Muhammed Abdul Uehab jetonte në atë vend dhe duke konsideruar paganizmin që zuri vend në vendet e tyre përpjekja e tyre më e madhe ishte shqetësimi i madh për Teuhidin.

Dhe është shumë natyrale në mëndimin tim që të tilla ku aftësia e njerëzimit është e kufizuar ai nuk ishte i aftë për të shpallur luftën e tij në cdo front siç ata thonë. Kështu për shkak të saj të gjitha përpjekjet e tij u konsumuan drejt përhapjes së thirrjes për Teuhid dhe duke i shpallur luftë paganizmit dhe idhujtarisë. Dhe ai fitoi sukses në atë dhe thirja e tij e shkëlqejshme ishte përhapur pastaj mbi të gjithë botën islame. Dhe kjo ishte edhe madje fatkeqësisht kur ndodhi luftimet midis tij dhe kundërshtarëve të tij. Por ky është Sunneti i Allahut përsa i përket krijimit të tij. Dhe ju nuk do të gjeni asnjë ndryshim në Sunnetin e Allahut.

Megjithatë në kohët e sotme dijetarët e kanë ringjallur thirrjen e tyre në Kur'an dhe Sunnet dhe kështu shumë nga njerëzit e veçantë dhe të zakonshëm në vendet arabe janë dukë u ringjallur. Për sa i përket vendeve jo-arabe atëhere faqteqësisht ata janë ende në një gjendje gjumi.

Këto vende arabe janë sprovuar nga një prapsim të cilin e kam treguar më parë e tillë sa disa prej tyre nuk ndalen në pikën e mësme të moderimit. Në vend të kësaj ata e dinë një gjë dhe janë injorant për një gjë tjetër. Kështu ju do t'i shihni njerëzit e zakonshëm të cilët nuk kuptojnë asgjë kur ai pyet dijetarët mbi këtë subjekt : "Çfarë është gjykimi i kësaj?" duke mos pasur parasysh se përgjigjja mund të jetë një mohim dhe refuzim ai fillon me pyetjen e tij: "Çfarë fakti ke?"

Dhe ngandonjëherë dijetari nuk është i aftë për të gjetur një fakt vecanërisht nëse fakti është i marrë dhe i adoptuar përmes kërkimesh dhe nuk është e dëshmuar në një tekst të vecantë në Kur'an dhe Sunnet. Kështu në çështjet e kësaj natyre nuk është e saktë për pyetësin për të shkuar thellë dhe të thotë: "Çfarë fakti ke?" Dhe është e kërkuar që pyetësi e di vetë. A është ai nga njerëzit që e kupton faktin apo jo? A ka ai ndonjë pjesë në dituri e

përgjithshme dhe specifike, të kufizuar apo jo të kufizuar, të abroguarën (nasikh) dhe atë që është abroguar (mansukh). Kështu nëse personi nuk e kupton asnjë prej këtyre gjërave atëhere cfarë dobie ka nga thënia: "Çfarë fakti ke?" Për cfarë? " Për gjykimin e një gruaje e cila vallëzon përpara burrit të saj ose vallëzimi i saj përpara motrve muslimane nëse është e lejueshme apo e ndalueshme! Dhe dabkah e burrave! Ai dëshiron fakt për të! Por në realitet nuk ka tekste (ose fakte) nga i dërguari i Allahut salallahu alejhis ua selam mbi këtë çështje që ekziston tek ne. Ky është vetëm një hetim, e nxjerrë dhe e marrë nga të kuptuarit e tij.

Për shkak të kësaj ne themi në kohë të ndryshme: "Jo cdo çështje ka një fakt të qartë që mund të prezantohet në detaje të cilin cdo musliman mund ta kuptojë nëse ai është një person analfabet ose një nxënës dijet. Por kjo nuk është për të gjitha çështjet, kjo është pse All-lahu subhanehu ve te'ala ka thënë: "Pyet ata që dinë".

Nga ekstremizmi që ne e treguan më sipër dhe për shkak të tij pjesa më e madhe e njerëzve kanë filluar ta hedhin faktin - është që shumë nga ata ia atribuojnë veten Kur'anit dhe Sunnetit. Ata besojnë që dijetari kur është i pyetur mbi një çështje është e obligueshme për të ta lidh "Allahu ka thënë dhe i dërguari i Tij salallahu alejhis ua selam ka thënë" me këtë përgjigje.

Unë them që kjo nuk është një obligim dhe nuk është nga dobitë e përkatësisë së metodologjisë së selefus sahih (të parëve të drejtë), dhe më tepër biografitë e tyre dhe fetuat e tyre është një fakt në vepër për cfarë unë kam thënë. Kështu duke u bazuar në këtë përmendja e faktit është e obligueshme kur situata ka nevojë për të megjithatë nuk është një obligim mbi të që kur pyetet të thotë "Allahu ka thënë këtë dhe këtë" ose "i Dërguari i All-lahut, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, ka thënë këtë dhe këtë". Dhe kjo

është veçanërisht nëse çështjet janë nga ato që kanë nevojë për detaje dhe përfshinë çështje të Fikhut (jurisprudencës Islame) në të cilën ka ndryshime në mendime.

Si rezultat thënia e Allahut: "Pyet ata që dinë" është përpara së gjithash në sensin e pa kufizuar kështu e gjitha që duhet të bësh është të pyetësh dikë të cilin ti e ndjen se është nga njerëzit e dijes. Dhe kur ju dëgjoni përgjigjen nga ai atëhere është për ty për ta ndjekur derisa ti ke një dyshim rreth saj për shkak se ke dëgjuar diçka nga një dijetarë tjetër. Nuk ka asnjë dëm apo mëkat nëse ti i'a përmend atij. Kështu në atë pikë dijetari duhet të përpiket me dijen që ka ta heq këtë dyshim të prezantuar nga pyetësi.

Si përfundim: një grua që vallëzon përpara burrit të saj krahas me kushtet e përmendura më parë është e lejueshme. Përsa i përket vallëzimit të saj përpara grave të tjera atëhere është dy formash gjithashtu siç ne e kemi dëshmuar më parë. Për sa i përket një gruaje që vallëzon përpara burrit të saj atëhere nëse vallëzimi i saj nuk është i shoqëruar me profesionalizëm por është vetëm një lëvizje e duarve. Dhe nuk ka tundje të belit ose atyre pjesëve që shtojnë dëshirat atëhere nuk ka problem me këtë vallëzim. Nëse është korrekte për ta quajtur një vallëzim!

Por nëse ndonjë prej këtyre gjërave të këqija të përmendura më sipër janë prezente atëhere frenimi nga ato paraqet parimin origjinal. Për sa i përket dabka-s së burrave atëhere nëse është një imitim i vallëzimeve të cilin ne i shohim se normalisht janë të bashkuara me muzikë duke mos përmendur që ka fjalë të përmendura në të e që nuk janë nga feja; atëhere kjo është nga dëshirat e kota

dhe nuk është e inkurajuar. Ndryshe është e inkurajuar për t'iu larguar asaj siç ka thënë Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem: "Çdo dëshirë e kotë e birit të Ademit që kryen është e gabuar përveç të luajturit me gruan e tij, të luajturit me kalin e tij, gjuajtjen me shigjetë dhe mësimin e notit". Kështu përshkak të këtij hadithi ne mbajmë opinionin që është e gabuar.

Kështu nëse kjo është një gjëndje e dëshirave të kota ne jemi të inkurajuar që të largohemi nga ajo dhe ajo nuk është nga çështjet e drejta atëhere ne themi se është e lejuar aq gjatë sa nuk është e shoqëruar me diçka që kundërshton fenë. Megjithatë, është një lejim që duhet peshuar me hadithin që unë përmenda pak më lart.

Por opinioni im dhe All-llahu e din më së miri pasi që unë nuk i kam dëshmuar këto dabka nuk është e mundshme për të qënë i pastër nga të kundërshtuarit e fesë. Dhe kjo është pasi që ne për shembull e kemi dëgjuar dabkanë në të kaluarën dhe kjo nuk është e vetme. Por ne krahas saj e kemi dëgjuar edhe muzikën, thirrjen e muezinit dhe Imamin duke recituar Kur'an me zë të lart. Dhe ata nuk e kanë për asgjë tjetër por në vend të kësaj ata janë të zënë me dëshira të kota. Si rezultat dabkasë është nga dëshirat e kota që mund të peshohen dhe të përkufizohen. Dhe ne nuk themi që është haram përderisa të mos jetë e kombinuar me diçka që shkon kundër fesë nga një aspekt sepse atëhere do të kthehet pa asnjë dyshim në diçka të ndaluar.

Shënim:

Dabka në arabisht është një vallëzim në të cilin njerëzit mbajnë një rrjesht duke mbajtur njëri-tjetrin dorë për dorë. Dabka këtu i referohet vallëzimit të burrave.

Shejh Muhammed Nasiruddin Albani

Marrë nga: El-Asalah nr.8

Përktheu: Ammar Ardit Kraja

31.10.2003

Kur gruaja sfidon burrin e saj

Ka flijuar për shkak të burrit të saj, mirëpo kjo vetëm se e ka larguar prej tij. Ka qenë e butë për te, mirëpo kjo vetëm se ka shkaktuar injorim të saj. Ka duruar, mirëpo kjo vetëm ka shkaktuar shtim të zullumit dhe tiranisë...

Edhe përskej këtyre vuajtjeve, të cilat e shkrijnë shkambin, shpirti mbeti i qetë, zemra e rehatshme, e cila shkaktonte shndërrimin e fytyrës së saj me dritën e shpresës, zemra i mbushej me besim që është sekret i qendresës, çelësi i rrugëdaljes, baza e lumturisë, themeli i qetësisë dhe kënaqësisë.

Kjo armë e cila ka sfiduar tiraninë e burrit të saj dhe ahmakllëkun e tij, i cili duke iu kërcënuar, sikurse të posedon tokën dhe çka ka mbi te, i ka thënë: do të shkatojë vuajtje në jetë!!

Iu përgjigj me qetësi dhe epërsi: nuk ke mundësi të më bësh fatzi, ashtu sikurse nuk ke mundësi të më bësh të lumtur!!

Tha i hidhëruar: pse skam mundësi ta bëjë këtë?

Iu përgjigj: sepse po të ishte lumturia në rrogën time, do të kisha mundësi të ma ndërpreje, ose në stolitë dhe veshmbathjet, do t'i mi merje, ose në ndonjë ceremoni ose dëfrim, e do të më ndalje prej tyre, mirëpo është në diçka të cilën nuk e posedon as ti e as njerëzit në përgjithësi...

Burri i habitur tha: çka është ajo?!

Me bindje të paluhtashme dhe besim të thellë tha: lumturinë time e gjej në besimin tim, besimin e kam në zemër, kurse zemrën time

se posedon askush tjetër përveç Zotit tim!

I tillë është besimi, rehati të ndërgjegjes, qetësi të shpirtit dhe zemërgjërësi. Njeriu me te sheh rrugën e udhëtimit të tij dhe i përforcon në të vërtetë këmbët e veta...

Nuk e dridhin sprovat sa do që janë të mëdha, nuk e mashtrojnë epshet, sa do që janë të zbkuruara:

“Është për tu habitur çështja e besimtarit; e gjithë çështja e tij është mirësi. Nëse e godet ndonjë e mirë, ai falënderon, e kjo është mirë për te, e nëse e godet ndonjë e keqe, duron, e kjo është mirë për te. Kjo nuk është për askend tjetër përveç se për besimtarin”.

Kush i shikon ndryshimet e kohës me këtë sy, pa dyshim se jeton i lumtur, i qetë, pa marrë parasysh sa i ngushtohet dynjaja, e sulmojnë sëmundjet ose vështirësitë! Madje mund që të përjeton lezet gjatë lutjeve që ia bën All-llahut gjatë këtyre telasheve, të cilat nuk mund ti përjeton as në rastet dhe ditët e rehatisë. Besimtarët kanë shprehur këtë ndjenjë dhe lumturi duke thënë: Jam në një lumturi, saqë po ta dinin mbretërit ose bijtë e tyre kënaqësinë në të cilën gjindemi, do të mundoheshin të na e marrin me shpata...!!

Shiko, sasinë e besimit në zemrën tënde?

Dhe çfarë ndikimi ka në jetën tënde?

Është melhem i jetës dhe dritë, e cila e qetëson njeriun e frikësuar, e qetëson të trishtuarin, e gëzon të mërziaturin, e ngop të eturin, e siguron të brengosurin, e forcon të dobëtin, e udhëzon të lajthiturin, mere këtë të jesh e lumtur në dynja dhe ahiret.

Autor: Mazin El-Furejxh

Marrë nga: naseh.net

Përktheu: Bekir Halimi

21.11.2003

Abdurr-Rezzak ibën Afifi ibën Atije

Dallohej më kujtesën e fortë që e kishte, aftësinë për kuptimin e gjërave dhe palodhshmërinë në kërkim të diturisë. Vazhdimisht i zgjeronte dituritë e tij posaçërisht në lëmitë e gjuhës, tefsirit, akidës, hadithit dhe fikhut. Ai që e dëgjonte kur fliste fitonte përshtypjen se ky njeri është ekspert në të gjitha lëmitë e fesë. Shumë njerëz përfituan prej tij dhe tubimet e tij ishin përplot me nxënës...

Ky njeri braktisi atdheun e vet dhe u shpërngul në tokën e Dy Xhamive të Shenjta duke bartë me vete diturinë nga e cila përfituan shumë dijetarë që më vonë u bënë Imam të dijës. Ibën Uthejmini, Salih Feuzani, Ibën Xhibrini dhe shumë tjerë ishin nxënësit e tij. Nuk i pritonte punës dhe ishte i zellshëm në të. Ibën Uthejmini thotë: Me njohuri të thella, mësues i aftë dhe mendime në të cilët shihet qartë frymëzimi hyjnor. Kush është pra ky njeri...

Quhet Esh-Shejh Abdur-Rezzak ibën Afifi ibën Atije me prejardhje egjiptase. Është lindur në vitin 1323H në vendin Shanshur në komunën Manufijje në Egjipt.

Gjitha nivelet e mësimit i vazhdoi pranë Universitetit El Az-har në Kairo (një prej universiteteve më të vjetër në botë) pranë të cilin diplomoi në vitin 1351H që të vazhdojë mësime specializuese në katëdrën e Fikhut dhe bazave të tij. Në këtë vend ai fitoi diplomë e cila është në nivel të titullit doktor i shkencave në terminologjinë bashkëkohore.

Pas diplomimit u emërua si mësues pranë Instituteve shkencore të universitetit El Az-

har. Në vitin 1386H (1949G) u transferua në Arabinë Saudite ku u vendos në postin e mësuesit pranë shkollës Darut-Teuhid në qytetin e Taifit. Pas dy vitesh, në vitin 1370H u bë mësues pranë institutit shkencor në qytetin e Unejzes ku punoi 5 vjetë e që mandej të transferohet në kryeqytetin Rijad në vitin 1375H ku punoi në shkollat të cilat ishin nën mbikqyrjen e muftit Muhammed ibën Ibrahim Alu Shejh. Më vonë u bë mësues në fakultetet e Sheriatit dhe Gjuhës. Në vitin 1385H u emërua si drejtor i Institutit të lartë për drejtësi që më vonë u transferua në Kryesinë e përgjithshme të drejtorisë për hulumtime shkencore, thirrje, udhëzim dhe fetva ku u formua komisioni i dijetarëve më të mëdhenj ku ai ishte anëtar.

Disa fjalë të dijetarëve për të:

Al-lameja Ibën Baz, rahimehull-llah thoshte: Shejhun e nderuar Abdur-Rezzakun e njoh si njeri me modesti të jashtëzakonshme, me njohuri të gjëra...

Ishte i përpiktë dhe i vendosur që punën që kërkohet prej tij ta kryen në mënyrën më të mirë...

E konsideroj prej dijetarëve më të dalluar i cili kaloi mbi 50 vjet në thirrje (davet) dhe mësim. E lus All-llahun që të shumëfishon shpërblimin e tij dhe të lartëson gradat e tij në xhennet duke e lutur që ta zëvendson me zëvendës të mirë dhe t'i ruan pasardhësit e tij.

Ibën Uthejmini, rahimehull-llah thoshte: Ishte njeri i mençur, vizionist... Heshtja ishte cilësi e tij përpos në raste kur bëhej fjalë

për çështjet e hajrit të cilët i don All-llahu, subhanehu ve te'ala. Me njohuri të thella, mësues i aftë dhe mendime në të cilat shihet qartë frymëzimi hyjnor. All-llahun e lus që të shumëfishon shpërblimin e tij dhe të na bashkon me të në gradat e larta të xhennetit se bashku me vëllëzërit tanë besimtar; All-llahu, subhanehu ve te'ala është Dhurues i begative.

Al-lameja Albani, rahimehull-llah, e përshkruante kështu: Shejhu Abdur-Rezzak El Afifi është prej dijetarëve me vlerë, prej pakicës tek e cila shihen cilësitë e dijetarëve, edukata e tyre, butësia, mosnxitimi dhe kuptimi. Jam takuar me të në disa raste gjatë Haxhxit dhe në përgjigjet e tij të urta shihej qartë përcjellja e menhexhit të selefit. All-llahu e mëshiroftë.

Abdul Aziz Alu Shejh thotë: All-llahu ia bëri të mundshme të bëhet edukues i disa gjeneratave, kishte dijëni të gjëra në lëmitë e hadithit, tefsirit, fikhut, usulit dhe gjuhës...

Ligjeratat e tij ishin plotë dobi...

Ishte shëmbull i dijetarit i cili vepron sipas diturisë. All-llahu e mëshiroftë.

Salih Es-Sedlani thotë: Ishte mësuesi im në disa nivele të shkollimit tim... Çdo herë që uleja pranë tij përfitoja dobi të reja, ishte i qartë dhe mësuesi më i aftë që kam parë... njerëzit e donin shumë dhe këtë e vërteton prania e shumë njerëzve të shtresave të ndryshme shoqërore në xhenazën e tij.

Nxënësit më të njohur që përfituan prej tij:

- Al-lameja Muhammed Salih Uthejmin, rahimehull-llah

- Abdull-llah El Gudejjan

- Salih El Feuzan

- Salih ibën Muhammed El Luhejdan

- Abdull-llah ibën Abdur-Rahman ibën

Xhibrin

- Abdul Aziz Alu Shejh

- Abdull-llah ibën Abdur-Rahman El Bessam

- Abdull-llah ibën Hasen ibën Ku'ud

- Abdull-llah ibën Sulejman ibën Meni'

Shumica e këtyre dijetarëve janë apo kanë anëtarë të Komisionit të përhershëm për fetva dhe Komisionit të dijetarëve më të medhenj.

All-llahu e mëshiroftë mësuesin e mësuesve tanë. Amin.

Përshtati: Talha Kurtishi,

31.10.2003

AbdulAziz ibën Abdull-llah Ibën Baz

Ishte njëri prej figurave më të shquara të shekullit të 20-të, kryemuftiu i Arabisë Saudite, Imami i kohës së tij. Vendimet (fetvatë) e tij ishin të padiskutueshme dhe ishte autoriteti fetar të rangut më të lartë në vendin e tij dhe në botën islame. Modestia e tij, sinqeriteti, bujaria, fisnikëria dhe kujdesi për çështjet e muslimanëve e bënë të dashur

tek miqtë dhe ata të cilët ndoshta nuk pajtoheshin me të. Paraqitja e tij shkaktonte respektin e pushtetbartësve. Ishte humanist që asnjëherë nuk i harronte të varfurit, jetimët dhe të vejat dhe vazhdimisht kujdesej për ta. I palodhshëm në punë. Jeta e tij është një shëmbull i shkëlqyeshëm se si duhet të vepron thirrësi.

Quhet Abdul Aziz ibën Abdull-llah ibën Abdur-Rahman ibën Muhammed ibën Abdull-llah ibën Baz. Shejhu, Al-lameja, Eminenca e tij është lindur në qytetin e Rijadit në vitin 1330H në një familje që ishte e njohur me interesin e saj për shkencat e Islamit.

I ati i tij ndërroi jetë në moshën 3 vjeçare të shejhut dhe kështu barra e plotë e edukimit dhe rritjes u transferua tek e ëma e tij e cila sipas fjalëve të shejhut vazhdimisht e ka inkujuar të mësojë shkencat e fesë. Ajo ka qenë motivuesi kryesor që shejhu të mëson Kur'nin përmendsh gjë të cilën e arriti në moshën 14 vjeçare. Jeta si jetim nuk ishte e lehtë për të. Si i vogël u detyrua të punon më vëllaun e tij Muhammedin i cili tregtonte me (bisht) pelerinat që janë veshje tradicionale e banorëve të Arabisë. Edhe pse roli i tij në mbeshtetjen e familjes ishte mjaft i madh, asnjë herë nuk e neglizhoi mësimin e Kur'anit, hadithit, fikhut dhe tefsirit. Në moshën 16 vjeçare iu dobësua aftësia e të pamurit për shkak të infeksionit. Në moshën 20 vjeçare u sprovua me verbëri. Etja për dituri dhe aspiratat e larta ishin motivuesi kryesor që ai të vazhdojë kërkimin e diturisë. Hendikepi i tij edhe pse në atë kohë ishte pengesë e evidente nuk e larguan nga kërkimi i diturisë. Ai tani tërë kohën ia përkushtoi kërkimit të diturisë.

Në kërkim të diturisë:

Mësimi i tij kishte të gjitha tiparët e shkollës tradicionale e cila bazohej në uljen e nxënësit para mësuesit të tij dhe në përfitimin drejtëpërdrejt prej tij. Në leximin e librave ndihmë të madhe i ofruan familja dhe shokët e tij që lexonin librat me zë që ai të mund të dëgjojë. Mësuesit e tij më të dalluar ishin:

Shejh Muhammed ibën Ibrahim Alu Shejh kryemuftiu i Saudisë tek i cili mësoi 10 vjet (1347-1357) dhe i cili e propozoi të emërohet si Kadi (gjykatës) në krahinën El Harexh.

Shejh Muhammed ibën Abdul-Latif ibën Hasan Alu Shejh.

Shejh Salih ibën Abdul Aziz ibën Abdur-Rahman Alu Shejh.

Shejh Sa'd ibën Hamed ibën Atik kadiu i Rijadit në atë kohë.

Shejh Hamed ibën Faris nga i cili përfitoi shumë në lëminë e gramatikës.

Shejh Sa' Vekas El Buhari i cili konsiderohej si dijetari me i dalluar në lëminë e texhvidit (leximi i drejtë i Kur'anit)

Postet që i ushtroi:

U emërua si kadi në krahinën El Harexh me rekomandim të muftiut të atëherëshëm. Në këtë post mbeti prej 1357H-1371H. Gjatë qëndrimit në Harexh jepte mësim të rregullta për çdo ditë përpos të martën dhe të premten. Gjatë kësaj kohe ai sponsoronte disa studentë me qëllim të aftësimit të tyre për thirrje. Më të dalluarit prej tyre ishin:

Shejh Abdul-llah El Kenhel

Shejh Rashid El Hanin

Shejh Abdur-Rahman ibën Nasir El Ber-rak

Shejh Abdull-llah ibën Hasen ibën Ku'ud

Shejh Abdur-Rahman ibën Xhelal dhe shumë tjerë.

Në vitin 1371H u emërua mësues në institutin e lartë shkencor që më vonë 1373H do të shndërrohet në Fakultetin e Sheriatit ku ishte mësim dhënës prej 1373H-1381H.

Në vitin 1381H emërohet si prorektor e më vonë si rektor i Univerzitetit Islamik në Medine.

Në vitin 1395H me dekret mbretëror emërohet si kryetar i Zyrës për Hulumtime Shkencore dhe Fetva në gradën e Ministrisë.

Në vitin 1414H merr postin e kryemuftiut dhe kryesin e këshillit të dijetarëve të mëdhenj.

Ka qenë edhe kryetar i këshillit inicues për formimin e Rabitasë.

Disa nga të arriturat e tij:

Jeta e shejhut është argument i prerë për përkushtimin e plotë të tij në shërbim të fesë Brenda vendit dhe jasht. Promovimi i Islamit dhe thirrja në të ishin dy çështje që ishin në qendër të vëmendjes së tij. Mbështetja e tij shfaqej në shumë drejtime si:

1. Sponzorimi i vazhdueshëm i organizatave për thirrje dhe qendrave islame në tërë botën.

2. Formimi dhe mbikqyrja e shkollave për mësim të Kur'anit

3. Aktiviteti humanitar dhe kujdesi për të gjitha shtresat që kishin nevojë.

4. Aktiviteti në thirrje përmes librave, audio kasetave dhe pjesmarrje të rregullt në programet e radios siç ishte emisioni javor Nurun Aled-darb ku i përgjigjej pyetjeve të shumta.

5. Derset e rregullta pas namazit të sabahut dhe pas akshamit dhe takimet e shpeshta me njerëzit e thjeshtë. Dyert e shtëpisë së tij asnjëherë nuk ishin të mbyllur dhe sofra e tij nuk mundej të paramendohej pa të huaj.

Këto angazhimet e tij u vlerësuan nga komisioni i shpërblimit "Mbreti Fejsal" dhe në vitin 1402H fitoi shpërblimin për punën e palodhshme në shërbim të fesë Islame.

Veprat e tij:

1. Mexhmu'ul fetava ku janë tubuar gjitha fetvatë e tij dhe artikujt që i ka shkruar

2. El Fevaïd El Xhelijje fi El Mesail El Faraidije në lëminë e trashigimisë (Faraid)

3. Et-Tehkik vel Idah (për rregullat e haxhxit) është përkthyer nga disa nxënës shqiptar në Arabinë Saudite.

4. Et-Tehdhir minel Bide'i (në lëminë e besimit).

5. Nakdul Kaumijje el arabijje (në lëminë e besimit).

6. Ed-da'vetu ilAll-llah ve ahlakud-duat (në lëminë e etikës) dhe shumë libra tjerë.

Një shembull i zemërbardhësisë së tij:

Këtë rast e rrëfen kontabilisti i cili tregon se një ditë tek shejhu ka ardhur një njeri i cili është ankuar për situatën e tij dhe shejhu ka vendosur që t'i ndihmon me 1000 rijal. Duke dalur njeriu në letrën e shjehut ka shtuar një zero dhe kështu shuma që duhej të pagohet u bë 10000 rijal. Kur kontabilisti e pa letrën ju duk shuma e madhe dhe e morri në telefon shejhun i cili kur kuptoi se çfarë kishte bërë nuk u hidhërua as që e qortoi, me zë të qetë tha: Jepja ato të hollat që i kërkon sepse ndoshta nevoja e madhe që e ka e ka detyruar të gënjen. Kështu ishte mësuesi ynë me mendim të mirë për çdo musliman në zemrën e tij nuk kishte vend për dyshime dhe urrejtje për vëllezërit e tij muslimanë. O All-llah mëshiroje mësuesin tonë dhe rritja gradët në xhennet dhe na jep durim në kërkim të diturisë. Amin.

Vdekja e tij:

Në mengjez me 13 maj të vitit 1999 në moshën 90 vjeçare ndërroi jetë Shejh Ibën Bazi në xhenazën e tij morrën pjesë afro 1,000,000 njerëz duke e përfshirë udhëheqësinë më të lartë të vendit. All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e Tij të gjërë.

(referencë kryesore është faqja e shejh Ibën Bazit në internet)

Marrë nga: www.binbaz.org.sa

Talha Kurtishi

06.11.2003

Abdull-llah Ibën Abbas

Abdull-llah Ibën Abbas, radijall-Llahu anhu Abdullah ibën Abbasi ka qenë mufessiri më i dalluar prej shokëve të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. U rrit në afërsinë e Resulullahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, gjë që i mundësoi edukim të llojit më të lartë. Krahas kësaj All-llahu, subhanehu ve te'ala, i dhuroi aftësi të rrallë të kujteses dhe kuptimit. Tërë kohën e kaloi në kërkim dhe përhapje të diturisë. Ishte i dalluar edhe në lëmi tjera siç janë: hadithi, fikhu, gjuha arabe, historia e popullit arab dhe poezia paraislame.

Quket Abdull-llah ibën Abbas ibën Abdul Muttalib El Hashimij El Kureshij. I ati i tij ishte xhaxhai i të Dëruarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Është lindur në vitin e tretë para Hixhretit në kohën kur tërë fisi i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, Benu Hashim ka qenë i izoluar në vendin Shi'ab në afërsi të Mekkes. Ky izolim ka pasur për qëllim që fisi i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, të distancohet prej tij ashtu që Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, të humb për-krahjen të cilën e gëzonte. Tezja e tij Mejmune ka qenë njëra prej grave të Pejgamberit dhe kjo i mundësoi që shpesh të vjen në shtëpinë e të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe të mëson prej tij. (Et-Tefsir vel Mufessirun fq.65)

Lutja e të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem

Dhuntitë e All-llahut që ia kishte dhuruar All-llahu ishin të qarta. Ka qenë i talentuar me zgjuarsia që dallohej. Nëse kësaj ia bashkangjesim faktin se për të ka bërë lutje i Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve

sel-lem, do të kuptojmë se cili është sekreti i diturisë së tij. Si ndodhi kjo gjë:

Një natë kur i dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kaloi natën te Mejmuneja. Ibën Abbasi ishte zgjuar para tij dhe ia ka përgatitur ujin e abdestit. Kur i Dërguari i All-llahut morri abdest e pyeti gruan e tij kush e ka përgatitur ujin. Kur ajo i tha se atë e ka bërë Ibën Abbasi, bëri lutje për të dhe tha: O All-llah bërja të mundshme ta kuptojë fenë dhe mësoja komentimin e Kur'anit. (El Isabe fi temjizi sahabe 2/322-323)

Në praninë e të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ai ka mësuar shumë hadithe të cilët më vonë ua ka transmetuar gjeneratave pas tij. Edhe pse në kohën kur i Dërguari i All-llahut ndërroi jetë ishte 13 vjeçar ai vetëm se ishte bërë dijetarë i dalluar në mesin e shokëve të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Pas vdekjes së Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ai ka vazhduar kërkimin e diturisë duke vizituar shokët e Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, që të përfitojë prej tyre. Në shumë raste ai ka kaluar kohën e drekës (vapën e madhe) duke pritur para dyerve të tyre që të mos i shqetëson. Kur ata zgjoeshin prej gjumit të drekës i thonin pse na zgjove prej gjumit që të të shërbejmë o kushëri i Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ose pse nuk dërgove njeri që ne të vijmë të ty. Ai përgjigjej. Të diturit janë ata tek të cilët duhet ardhur. (El Isabe fi temjizi sahabe 2/323)

Buhariu, Muslimi dhe tjerët prej tij transmetojnë 1660 hadithe. (El A'lam li Zirikli 4/95)

Ibën Abbasi ka pasur aftësi fascinante që të mësojë përmendsh çdo gjë që dëgjon. Transmetohet se çdo ajet apo hadith të cilin e ka dëgjuar e ka mësuar (Hajatus-Salihin fq.159). Kur Ibën Ebi Rebi'a para tij lexoi një kaside të përbërë prej 80 vargje e mësoi përmendsh (Hajatus-Salihin fq.159). Edhe njohja e gjuhës arabe ka qenë element që ndihmoi që ky njeri të pasurohet me dituri të gjërë. Sipas kësaj që përmendëm gjërat kryesore që ia mundësuan mësimin e kësaj diturie janë:

1) Lutja e të Dërguarit dhe kontaktet e shpeshta me të.

2) Aftësitë mendore që ja dhuroi All-llahu, subhanehu ve te'ala.

3) Shoqërimi i as-habëve të ditur pas vdekjes së Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

4) Njohuritë e gjëra në lëminë e gjuhës arabe dhe poesizë paraislame.

5) Aftësia e veçantë për vërejtjen e gjërave dhe për nxerjen e dispozitave të shariatit. Ka qenë trim dhe qëndronte pas mendimeve të tij.

Si argument i diturisë dhe respektit që e gëzonte do të përmendim rastin kur para shtëpisë së tij u tubuan njerëz të cilët nuk mundin të hynë në shtëpi sepse ishte përplot me njerëz. Kur Ibën Abbasi pa se çfarë ka ndodhur urdhëroi që së pari të hyjnë ata që kanë pyetje për Kur'anin dhe mënyrat e leximit (kiraetet). Ata ishin aq shumë saqë u mbush shtëpia e tij. Pas kësaj urdhëroi që të hyjnë ata që kanë pyetje në lidhje me komentimin e Kur'anit. Edhe ata ishin aq shumë saqë u mbush shtëpia e tij. Pas tyre hyrën ata që patën pyetje për çështjet e hallallit dhe haramit, pastaj për feraidin (trashigiminë) dhe në fund ata që patën pyetje të gjuhës. Pas kësaj ndodhie për çdo lëmi caktoi një ditë. (Suver min hajatis-sahabe fq. 181-182)

Ibën Abbasi si mufessir:

Nuk ka dyshim në faktin se Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, ka qenë më i dalluari prej shokëve të Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në komentimin e Kur'anit. Për këtë shkak është quajtur Terxhumanul Kur'an (Komentuesi i Kur'anit) Bahr (Deti) dhe Hibrul Umme (Ngjyra e ummetit) (El Itkan fi Ulumil Kur'an 4/205)

Ibën Mes'udi, radijall-llahu anhu, thotë: Sa komentues i mirë i Kur'anit është Ibën Abbasi.

Muxhahidi nxënësi i tij thotë: E quanin Deti për shkak të diturisë së tyre. (Mebahith fi Ulumil Kur'an fq.382)

Gjithashtu thoshte: Kur e komentonte Kur'anin në fytyrën e tij shihej dritë. (Et-Tefsir vel mufessirun 1/69)

Aliu, radijall-llahu anhu, thoshte: Kur e komentonte Kur'anin sikur shikonte gjabin pas perdes.

Katër halifet e drejtë e zgjedhën si këshilltar edhe pse ishte shumë i ri. Kur Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, jepte mendimin e tij Omeri e pranonte atë pa pyetur më gjërisht. (El A'lam 4/95)

Tavusi thotë: Jam takuar me 70 prej sahabëve të cilit për pyetje i drejtoheshin Ibën Abbasit.

Nxënësit e Ibën Abbasit, radijall-llahu anhu:

Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, ka qenë aktiv edhe në veprimtarinë arsimuese dhe pas vete la shumë nxënës që përfaqësojnë shkollën e Mekkes së tefisirit.

Nxënësit më të dallur të tij ishin:

- Se'id ibën Xhubejri
- Muxhahidi
- Ikrimeja
- Tavus ibën Kejsan El Jemani
- Ata ibën Ebi Rebbah (El Mebahith fi Ulumil Kur'an 338-339)

Angazhimi shoqëror i Ibën Abbasit, radijall-llahu anhu:

Angazhimi me çështjet e diturisë ka qenë angazhimi kryesor i Ibën Abbasit, radijall-llahu anhu. Krahas kësaj ai fuqimisht është angazhuar edhe në jetën shoqërore. Ka qenë këshilltar i halifëve, udhëheqës i haxhëve, emiri i Basrasë. Ka marrë pjesë në lirin e Afrikës veriore në vitin 27H. Ishte përkrahësi i Aliut, radijall-llahu anhu, në luftë kundër Havarixhëve dhe ai i cili u takua me të për të diskutuar rreth dyshimeve që i kishin. Në rastin kur 24.000 ushtarë të Aliut, radijall-llahu anhu, u larguan prej tij Ibën Abbasi u takua me të dhe 20.000 prej tyre u kthyen në rradhat e ushtrisë pasiqë u bindën në fjalët e tij. (Suver min hajatis-sahabe 176-179)

Veprat e tij:

Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, nuk ka lënë ndonjë vepër të shkruar. Transmetimet

e tij rreth komenimit i kanë shënuar gjithë komentuesit e Kur'ani si Taberiu, Ibën Kethiri, Begaviu, Buhariu dhe tjerët. Gjitha transmetimet e Ibën Abbasit, radijall-llahu anhu. Fejruzabadi i ka tubur në një libër të cilën e ka quajtur; Tenviril Mikjas min tefsiri Ibën Abbas. (El Mebahith fi Ulumil Kur'an 360)

Vdekja e tij:

Në fund të jetës humbi shiqimin dhe u vendos në qytetin e Taifit ku ndërroi jetë. (El A'lam 4/95)

Mendimi më i saktë është se ka vdekur në vitin 68H. Xhenazën ia kanë falë një numër i madh i sahabëve dhe tabi'inëve. Trupin e tij në varr e zbriti Muhammed ibën Hanefijje biri i Aliut, radijall-llahu anhu. Pasiqë e varrosën tha: Pasha All-llahun sot ka vdekur dijetari i tërë Ummetit.

Marrë nga: www.dzemat.org

Pëshatati: Talha Kurtishi

14.11.2003



Tavus ibën Kejsan

Alimi i Jemenit Tavus Ibën Kejsan
Emri dhe prejardhja e tij:

Quket Tavus ibën Kejsan Ebu Abdur-Rahman El Farisi pastaj El Jemeni El Xhenedij El Ebnavi. Ka prejardhje persiane prej ushtrisë të cilën Kisra e përgatiti për ta pushtuar Jemenin ashtuqë familja e tij është vendosur në Jemen. Ka qenë rob i liruar i fisit Benu Himjer për këtë shkak thuhet meula Himjeri. Në disa burime shkruan se emri i tij ka qenë Kejsan në kohë që njerëzit e kanë njohur si Tavus. Viti i lindjes se tij nuk dihet por me siguri dihet se ajo ka qenë në kohën e hilafetit të Uthmanit, radijall-llahu anhu, ose pak para.

Mësuesit e tij kanë qenë një grup i madh i as-habëve. Ka përfituar prej Zejd ibën Thabitit, Aishes, Ebu Hurejres, Zejd ibën Erkamit, Ibën Abbasit, Ibën Umerit dhe tjerë All-llahu qoftë i kënaqur me të.

Diturinë që e përfitoi me emanet ua përcollti nxënësve të tij të cilët e vizitonin për të përfituar prej tij. Nxënës më të njohur të tij janë: Sulejman Et-Tejmi, Dah-haku, Abdull-llah ibën Tavus (i biri i tij), Ibën Xhurejxi, Muxhahidi, Amër ibën Dinari, Zuhriu, Mekhuli, Kajs ibën Sa'di dhe shumë dijetarë të dalluar prej tabi'i tabi'inëve.

Për diturinë e tij, besimin, devotshmërinë flasin edhe fjalët miradije të cilët për ti thënë shumë dijetarë të asaj kohe do të përmendim vetëm disa:

Ibën Abbas, radijall-llahu anhu: Mendoj se Tavusi është prej xhennetlive.

Kajs ibën Sa'd: Ai për neve është sikur Ibën Sirini për banorët e Basrasë.

Amër ibën Dinar: Me ka treguar Tavusi e mos mendo se ndokush prej neve është më i sinqert se ai. Në një rast tjetër ka thënë: Nuk kam parë njeri që është sikur Tavusi.

Ibën Hibban: Ishte prej adhuresve të dalluar të Jemenit, prej tabi'inëve të zgjedhur

Ebu Nuajm El Esbehani: Fekihu i mprehtë, adhuresi i dalluar Ebu Abdur-Rahman Tavus ibën Kejsan.

Dhehebiu: Ishte koka e diturisë dhe veprimit sipas saj, alimi i Jemenit, mirrej si yrnec... Muftiu i Jemenit, begati e All-llahu për Jemenin...

Neveviu: Prej tabi'inëve të mëdhenj, prej dijetarëve të devotshëm dhe me peshë...

Disa fragmente nga jeta e tij:

Abdur-Rezzaku rrëfen: Gjatë një udhëtimit për në Haxh në fund të natës njerëzit janë ndalur për të pushuar. Gjithë u përgatitën për gjumë përpos Tavusit i cili u çu për tu falur. Kur e pyetën pse spo flen u përgjigj: A thua vallë ka njeri që flen në këtë kohë (të bekuar sepse është pjesa e fundit të natës)

Kur një njeri i tha: Bën dua për neve u përgjigj si të lutem për ty kurse zemra ime është e zbrazët prej devotshmërisë (kam turp që në këtë gjendje t'i lutem zotit për ty)

Ka thënë: Ai që fol duke u friguar prej All-llahut është më i mirë se ai i cili hesht. (sepse ai që fol i sjell dobi vetës dhe tjerëve të cilët përfitojnë e kjo është më mirë se sa të heshtet).

Shpesh herë është përgjigjur me përgjigjen nuk e di (kështu vepron dijetari i vërtetë i cili nuk flet për atë për të cilën nuk ka

njohuri dhe argumente) është thënë: Nuk e di është gjysma e diturisë.

Abdur-Rahman ibën Ebi Bekr thoshte: Në ballin e tij shiheshin gjurmët e sexhdes.

Ka thënë: Po habitem me vëllezërit e mi të Irakut të cilit Haxhxhaxhin e konsiderojnë besimtar.

Thoshte: Mësoni sepse i vogël është numri i dijetarëve besnik (sa e saktë është kjo fjalë).

Ebu Abdull-llah Shami thotë: Gjatë një vizite që ja bëra më tha pyet shkurt, nëse dëshiron do të ta mësoj Kur'anin, Tevratin dhe Inxhillin. Thash nëse mi mëson atëherë nuk të pyes asgjë. Tha: Ke frikë All-llahun më tepër se çdo gjë, shpresa yte le te jetë me e madhe se frika, dëshirova njerëzve atë që e dëshiron për vete.

Në këto fjali ai i ka përmledhur tiparët kryesore e gjitha librave të shpallura: Frika prej All-llahut, shpresa në mëshirën e tij dhe dëshira e të mirës për njerëzinë.

Thoshte: Adhurimi i të riut nuk është i plotë derisa të martohet.

O biri im ulu me të mençurit do të bëhesh prej tyre dhe largohu prej injorantëve që të mos bëhesh prej tyre...

Djali i tij rrëfen: Një ditë e vizitoi një prej havarixhëve dhe i tha: Ti je vëllau im. I tha: Vetëm unë!? Gjithë besimtarët janë vëllezër.


Është pyetur: çka është më e mira të thuhet për të vdekurin? Është përgjigjur: Istig-fari (kërkimi i faljes për të).

Në vitin 105H (sipas disave 106H) në Mekte vdiq Imam Tavusi në atë vend të cilin aq shumë e donte. (40 herë ka bërë haxhxh) All-llahu e mëshiroft me mëshirën e tij të gjërë.

Mexhdi Arefat

Përshtati: Talha Kurtishi

21.11.2003



Tema: Mbi Ushqimet

Numri: 1105

Data: 12.03.2003

Pyetja: Selamun alejkum. Deshi Zoti që përmes një shoku tim në Kosovë ta marr adresën tënde me qëllim që ta bëj një pyetje e cila na preokupon neve, disa muslimanë që jetojmë këtu në Evropë. Kemi rënë në hall në çështjen e disa artikujve ushqimorë në të cilat figurojnë disa shenja dhe numra të caktuar ("E") për të cilat disa nga muslimanët thonë se janë të ndaluara t'i hamë ato dhe për këtë qëllim edhe i kanë përhapur disa lista me numra e shenja të tilla. Ju lutemi në emër të All-llahut të na sqaroni me argumente se si qëndron e vërteta rreth kësaj problematike. Paraprakisht ju falënderojmë duke e lutur të Madhin All-llah t'ju shpërblejë për mundin e bërë. Selamun Alejkum.

Përgjigja: Ve alejkumusselam ve rahmetull-llahi ve berekatuhu!

Vëlla i nderuar!

Për të vendosur se a është e lejuar ose i ndaluar diçka nga ushqimet duhet poseduar dy kushte:

- 1- dija fetare mbi hallallin dhe haramin dhe
- 2- dija shkencore mbi përmbajtjet e ushqimeve.

Nëse një njeri që flet për këto çështje nuk është musliman i devotshëm, ka dije fetare rreth hallallit dhe haramit, edhe e di mirë shkencën që ka mundësi ti sqaron atij se çka hyn në qarkun e hallallit dhe çka hyn në qarkun e haramit, mundet të na tregojë, mirëpo varijanti se sa shperndahen ato letra, nuk e dimë se kush i ka verifikuar këto gjëra, a është musliman, a është i njohur hollësisht me hallallin dhe haramin, a e njeh shkencën mirë, etj, nuk janë valide. Sepse të flasësh për hallallin dhe haramin domethënë të futesh në kompetencat e Zotit, e të futesh në ato kompetenca pa dije është mëkat shumë i madh.

All-llahu në Kur'an thotë:

Mos i thoni asaj rrenës së gjuhëve tuaja: "Kjo është hallall e kjo është haram" e të shpifni ndaj All-llahut rrenën. Vërtet, ata që shpifin rrenën ndaj All-llahut, nuk kanë shpëtim. [Nahl : 116]

Andaj nuk ka nevojë të brengoseni për ato letra, nëse në përmbajtjen e ushqimeve nuk shkruan se ka gjëra të ndaluara në mesin e tyre, ato lirisht mundeni ti hani, ose nëse nuk vjen ndonjë musliman specialist që të tregojë se ka gjëra të cilat nuk janë të lejuara, perndryshe jo!

Bekir Halimi,

12.03.2003

Numri: 703

Data: 16.03.2001

Pyetja: Eeselamun alejkum jemi xhemati në Cyrrih në Zvicër, jemi të interesuar për një pyetje: Në këtë shtet krishter rallë ndodhet mish i therur me regullat Islame...

Përgjigjja: All-llahun e falënderojmë, paqa dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin.

Mendoj se atje ka shumë dyqane ku shiten ushqime të prodhuara në vendet muslimane, si në Arabi dhe në Turqi, po sidoqoftë, nëse nuk ka ushqime të cilat janë të prodhuara nga muslimanët, lejohet përdorimi i ushqimeve të jomuslimanëve, nëse ato i plotësojnë kushtet. Që mos të jetë ushqim i ndaluar rreptësisht, ose nëse është mish, të jenë të plotësuar kushtet e therrjes, e ato janë:

Të priten dy damarët kryesor, gabzheri dhe të rrjedh gjaku.

Nëse këto kushte janë të plotësuara ai mish është hallall të ngrënet, nëse ai që e ka therrë është ithtar i Librit, (ehlu kitab).

All-llahu e di më së miri.

Bekir Halimi,

02.04.2003

Numri: 653

Data: 09.03.2001

Pyetja: Esselamu Alejkum Bismil-lahirr Rrahmani Rrahim. Unë jam një student në Itali, normalisht nuk e konsumoj mishin e Italianëve, Elahamdulil-lah këtu nuk na mungojnë therrtoret islame, problemi që më shtrohet është për sa i perket djathit i cili prodhohet me mullën e viçit, qengjit ose kecit jo te prerë hallall. Ju kujtoj se mulla është ushqimi i fermentuar në plencin, barkun e kafshës, diçka midis bajges dhe ushqimit, me sa di unë, All-llahu Alem a hahet ky djath? Allahu ju shpërbleftë, Esselamu Alejkum

Përgjigjja: Falënderoj All-llahun, paqa dhe mëshira qofshin mbi Pejgamberin. Me sa di unë nuk ka problem të ngrënet ky djath.

All-llahu e di më së miri.

Bekir Halimi,

14.03.2001

Numri: 554

Data: 22.02.2001

Pyetja: Nëse je duke punuar në një pizzeri në shtetet perëndimore ku shumica e popullit janë krishterë, a është e lejuar nga ana e ime të punohet dhe të shitet mishi i derrat, deri sa ato e kërkojnë atë. Përhëndetje me, Eselamun-Alejkum ve Rrahmetullah

Përgjigjja: Falënderojmë All-llahun, kurse paqa dhe bekimi qofshin mbi Pejgamberin Alejhisselam.

Jo nuk lejohet të punohet në ato vende ku detyrohesh të servosh ushqim të ndaluar, edhe pse myshteritë nuk janë musliman.

Sepse haramin nuk ke të drejtë t'ia servosh askujt, as muslimanit e as jomuslimanit.

Përndryshe do të lejohej të shitet droga jomuslimanëve, mirëpo edhe kjo është rreptësisht e ndaluar. Ti duhet të kërkosh vend tjetër të punës, ku do ta fitosh rizkun hallall.

All-llahu e di më së miri.

Bekir Halimi,

12.03.2001

Numri: 550

Data: 21.02.2001

Pyetja: Eselamu Alejkum paqja dhe bekimi All-llahut qoft mbi Muhamedin, familjen e tij, Sahabët dhe gjithë ata që e pasojnë rrugen e tij. Hoxhë unë banoj në Belgjikë e më intereson se a lejohet ngrënia e mishit të therrur nga jo muslimanët kur dihen metodat me teknikë të re që i përdorin ata. Dhe ku në ajetet e Kuranit famëlart përmendet: (6:121), (5:5). Dhe ç'thotë sunneti i Resulullahut s.a.w.s. mbi këtë punë. All-llahu ju shpërbleft për këto përgjigje që po ju përgjigjeni. Eselamu Alejkum we Rahmetullahi we Berekatuhu

Përgjigjja: Falënderojmë All-llahun, kurse paqa dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin alejhisselam.

Ngrënja e mishit të kafshës e cila është therrë lejohet, pa marrë parasysh se kush e ka therrë. Nëse ajo kafshë është therrë, ka rrjedhur gjaku, kjo kafshë lejohet të ngrënet, nëse nuk është përmendur ndonjë emër të ndonjë idhulli gjatë therrjes së saj.

Pa marrë parasysh teknikën që përdorin ata, nëse kafsha thërret dhe gjaku del furishëm nga kafsha, kjo kafshë lejohet që të ngrënet. All-llahu e di më së miri.

Bekir Halimi,

12.03.2001

Origjinat e shirkut

Nga çfarë është vendosur në shariat [ligjin islam] është që njerëzimi ishte në fillim një popull i vetëm mbi Tevhidin e vërtetë pastaj shirku [drejtimi i çdo pjese ose formë adhurimi ose çdo gjë tjetër që është e drejtë e vetme e All-llahut të tjerë përveç All-llahut] gradualisht i përfshin ata. Baza për këtë është thënia e All-llahut - të gjithë Lavdëruarit dhe të gjithë Lartësuarit:

"Njerëzimi ishte një popull pastaj All-llahu dërgoi peygamber që sillni lajme të mira dhe paralajmërime. "[Sura Bekare 2/213]

Ibën Abbasi, radiallahu anhu, ka thënë:

"Në mes Nuhut dhe demit ishin dhjetë gjenerata të gjitha ato ishin mbi sheriati [ligjin islam] e vërtetë pastaj ata e ndryshuan. Kështu All-llahu dërgoi Peygamber si përcjellës të lajmeve të mira dhe si paralajmërues." [2]

Ibën Uruah el-Hanbeli [837 hixhri] ka thënë:

"Kjo thënie refuzon ata historian nga Ehli Kitab -njerëzit e librit- [çifutët dhe krishterët] të cilët thonë që Kabili dhe djemtë e tij ishin adhurues zjarri. "[3]

Unë them: Në të është gjithashtu një refuzim i disa filozofëve dhe ateistëve të cilët thonë që bazat natyrale të njeriut ishin shirku dhe që Teuhidi-besimi në një zot evoloi tek njeriu. Ajeti i mësipërm e hedh poshtë këtë teori ashtu edhe dy hadithet [thëniet apo traditat e Peygamberit

sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] autentike që vijnë më poshtë:

Së pari: Peygamberi salallahu alejhis ua selam ka thënë që ai e ka transmetuar nga Zoti i tij që:

"Unë i krijova të gjithë robërit e mi mbi fenë e vërtetë [mbi teuhidin-duke besuar në njëshmërinë e Allahut - të pastër nga shirku].

Pastaj djetë shkuan tek ata dhe i larguan ata nga feja e tyre e vërtetë. Ata i bënë të palejueshme njerëzve atë që unë ia kisha bërë të lejueshme për ata dhe u urdhëruan të shoqëronin në adhurim me Mua atë për të cilën Unë nuk e kam autorizuar askënd. "[4]

Së dyti: Peygamberi salallahu alejhis ua selam ka thënë:

"Çdo fëmijë është i lindur mbi fitranë [5] por prindërit e tij e bëjnë atë një çifutë ose një krishterë ose një adhurues zjarri. Është si rasti i një kafshe që nxjerrë në jetë një trashëgimtarë natyral. A keni parë ndonjë të lindur të gjymtuar përpara se ju t'i gjymtoni ata".

Ebu Hurejrah ka thënë:

"Recitoni nëse doni: "Fitrah e All-llahut me të cilën Ai krijoi njerëzimin. Nuk ka ndryshim në krijimin [fenë] e Allahut". [Surah er-Rum 30: 30] [6]

Pas këtij shpjegimi të qartë është shumë e rëndësishme për muslimanët të dijnë si Shirku u përhap midis besimtarëve pasi ata ishin muvah-hidin [njerëz mbi

Teuhid-besonin në njëshmërinë e All-llahut].

Përsa i përket thënies së All-llahut subhanehu ve te'ala rreth njerëzve të Nuhut: " Dhe u thanë: Mos braktisni zotat tuaj kurrsesi, mos braktisni Vedda-në, as Suvva-në, e Jeguth-in, Jeukë-n e Nesre-n." (Nuh-23)

Është e transmetuar nga një grup selefësh [paraadhësit tanë të drejtë] në transmetime të shumta që këto pesë të adhuroar ishin adhures të drejtë [besimtarë të drejtë]. Megjithatë kur ata vdiqën shejtani i pëshpëriti njerëzve të tyre t'i zbukurojnë dhe të ulen në varrezat e tyre.

Atëhere shejtani i pëshpëriti atyre që erdhën pas tyre që ata duhet t'i marrin ata si idhuj duke ia zbukuruar atyre idenë që ju do t'i kujtoni ata dhe si rrjedhojë do t'i ndiqni ata në sjelljet e tyre të mira. Atëhere shejtani i sugjeroi gjeneratës së tretë që ata duhet t'i adhurojnë këta idhuj krahas All-llahut të lartmadhëruar dhe ai i pëshpëriti atyre që kjo është ajo çfarë stërgjyshërit e tyre bënin.

Kështu All-llahu i dërgoi atyre Nuhun alejhisselam duke i urdhëruar të adhuronin vetëm All-llahun. Megjithatë asnjë nuk ju përgjigj thirrjes së tij përveç disave. All-llahu subhanehu ve te'ala e përmendi tërë këtë incident në Suren-Nuh.

Ibën Abbas transmetoi: "Me të vërtetë këta pesë emra burrash të drejtë nga njerëzit e Nuhut. Kur ata vdiqën shejtani i pëshpëriti njerëzve të tyre të bënin statuja të atyre dhe të vendosnin këto statuja në vendet e tyre të grumbullimit si përkujtues për ata, kështu vepruan edhe ata.

Megjithatë asnjëri ndërmjet atyre i adhuroi këto statuja derisa kur ata vdiqën dhe qëllimi i statujave ishte harruar.

Atëhere [gjenerata tjetër] filloi t'i adhuroj ata"[7]

Të njëjta me këto gjithashtu janë transmetuar nga Ibën Xherir et-Tabari dhe të tjerë nga një numër i selefëve, radiallahu anhum.

Në ad-Durr-al-Manthur [6/269]

"Abdullah ibën Humeid transmeton nga Ebu Muttahar i cili ka thënë: Jezid ibën el-Nuh alab ishte përmendur përpara Ebu Xhafar el-Bekiri i cili ka thënë: "Ai ishte vrarë në vendin ku të tjerë përveç All-llahut ishin adhuroar së pari. Atëherë ai përmendi Uadin dhe tha: "Uadi ishte një musliman i cili ishte i dashur nga njerëzit e tij. Kur ai vdiq njerëzit filluan të grumbulloheshin rreth varrit të tij në vendin e Babil duke qarë dhe murmuritur. Kështu [Iblisi] i pa ata duke qarë dhe murmuritur mbi atë, ai mori shfaqjen e një burri dhe ju shfaq atyre duke thënë: "Unë shoh se ju po qani dhe murmuritnin mbi atë. Kështu pse nuk i bëni një pikturë atij dhe vendoseni atë në vendet e grumbullimit që ju ta kujtoni atë. Pas kësaj ata thanë: "Po" dhe ata bënë një pikturë të atij dhe e vendosën në vendet e tyre që grumbulloheshin të cilat do t'ia kujtonin atyre atë".

Kur Iblisi i pa ata që ishin duke e kujtuar atë në një mënyrë të vazhdueshme ai i tha: "Pse nuk i bëni për çdo shtëpi nga një statujë të njëjtë ta mbani atë në shtëpinë tuaj kështu që ju mund ta kujtoni [vazhdimisht] atë".

Kështu ata të gjithë thanë: "Po". Atëhere çdo shtëpi bëri një pikturë të atij të cilin ata e adhuronin dhe e madhëronin dhe të cilët vazhdimisht ia kujtonin atyre atë.

Ebu Xhafar ka thënë: "Ata nga gjenerata e mëvonshme e panë çfarë [gjenerata e

mëparshme] bënte dhe arritën deri aty sa që e morrën atë si një ilah-zot që adhurohej krahas All-llahut. Ai pastaj tha: "Ky ishte idhulli i parë i adhuruar përveç All-llahut dhe ata e thirrën këtë idhull Uad" [8]

Në këtë mënyrë urtësia e All-llahut, subhanehu ve te'ala, u përmbush kur ai dërgoi Muhammedin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, si Pejgamberin final dhe e bëri të ndaluar në të gjitha mënyrat dhe rrugët nga njerëzit të cilët mund të bien në shirk, cili është gjynahi më i madh.

Për këtë arsye ndërtimi i përmendoreve mbi varret dhe duke pasur për qëllim udhëtimin drejt tyre duke i marrë ata si vende festimesh dhe grumbullimesh dhe betimesh mbi varre janë të ndaluara kategorikisht.

Të gjitha këto udhëheqin në vazhdimësinë e të adhuruarit të të tjerëve përveç All-llahut subhanehu ve te'ala .

Ky është rasti më i rëndësishëm në këtë kohë në të cilën dituria është duke u pakësuar, injoranca është duke u shtuar, gjinden shumë pak këshilltarë të sinqertë dhe shejtani është duke bashkëpunuar me njerëz dhe xhin për të ç'orientuar botën dhe t'i largojnë ata nga adhurimi i All-llahut të vetëm.

Shejh Nasirud-Din el-Albani

Referencat:

[1] Tahdhirus-Sajid min itikhadhil-kuburi masaxhid [f101-106]

[2] E Transmetuar nga Ibën Xherir et-Tbari në Tefsirin e tij[4/275] dhe el-Hakim [2/546] i cili ka thënë: "është autentik sipas kriterit të el-Bukharit"Edh-Dhehebi gjithashtu ka rënë dakord.

[3] El-Khauakibud-Durari fi Tartib Musnadul-Imam Ahmad'ala Abuabil-Bukhari

[6/212/1] ende gjendet në formë dorëshkrimi.

[4] E transmetuar nga Muslimi [8/159] dhe Ahmedi [4/162] nga Ijadh ibën Himar el-Muxhashi radiallahu anhu.

[5] [nga redaktori] Ibën el-Ethir ka thënë En-Nihajah [3/457]

El-Fitër, do të thotë të fillosh dhe të krijosh dhe el-Fitrah është kushti që rrjedhon prej tij. Kuptimi është që njerëzimi ishte i krijuar mbi një dispozitë dhe një natyrë e cila është e gatshme të pranojë fenë e vërtetë. Kështu nëse ai do të lihej mbi këtë atëhere do të vazhdonte mbi të. Megjithatë ata të cilët devijojnë bëjnë kështu nga ndjekja e dobësisë njerëzore dhe ndjekja e verbër e të tjerëve. . . . "

El-Hafidh ibën Haxhar ka thënë në El-Feth [3/248]

Njerëzit ndryshojnë përsa i përket çfarë është kuptimi i el-fitrah dhe thënia më e popullarizuar është që ajo nënkupton islam. Ibën Abdul Berr ka thënë: "Çfarë ishte e njohur mirë me pjesën më të madhe të selefëve [të parëve të drejtë] dhe tefsiri i dijetarëve janë të një mendimi se çfarë është kuptuar nga thënia e All-llahut, subhane ve te'ala: "Fitra e All-llahut me të cilën Ai krijoi njerëzimin" është islami.


[6] E transmetuar nga el-Bukhari [11/418] dhe Muslimi [18/52]

[7] E transmetuar nga el-Bukhari [8/534]

[8] E transmetuar nga Ebu Hakimi gjithashtu siç është në el-Kauakibud-Durari [6/112/2] i Ibën Uruah el-Hanbeli së bashku me një zinxhir i cili është i mirë [hasen] deri tek Ebu Muttahar. Megjithatë, asnjë biografi nuk mund të gjendet për të as në ed-Daulabi's el-Kunavel-esma e as në el-kunanen e Muslimit, e as në ndonjë

vend tjetër. Dhe defekti i fshehur është që | është përfshirë në el-Kunan el-Tusis nga
ai është nga Shia't por biografia e tij nuk | indeksi i transmetuesave të shia-ve.

Muhammed Nasirud-din Albani,
06.06.2003



Libri - Katërdhjet hadithe mbi moralin

4. Singëriteti dhe prania e nijetit gjatë kryerjes së veprave

Transmetohet nga Omer ibën Hattabi, radiall-llahu anhu, i cili thotë: kam dëgjuar Pejgamberin, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, duke thënë: “Veprat vlerësohen sipas nijetit dhe çdonjëri shperblehet në sajë të nijetit të tij. Ai që ka bërë hixhret (emigrim) për shkak kësaj bote do të fitojë atë që ka patur për qëllim, ose për shkak të ndonjë gruaje arrinë të martohet me te, hixhreti i tij vlerësohet sipas qëllimit që ka patur.” (Buhariu dhe Muslimi)

All-llahu, subhanehu ve te'ala, thotë: “ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin All-llahun me një adhurim të singërtë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zeqatin, se ajo është feja e drejtë.” (Bejjine – 5)

Poashtu thotë: “Tek All-llahu nuk arrin as mishi e as gjaku i tyre, por te Ai arrin bindja e juaj.” (Haxh – 37)

Imam Neveviu thotë: nijeti është qëllimi që shpreh vendosshmërinë e zemrës. (Fet-h elbari 1/13)

Hadithi i sipërpërmendur na bënë të ditur se nuk ka vepra të sakta pa nijet. Në Librin e All-llahut është theksuar tërthorazi ky realitet. All-llahu, subhanehu ve te'ala, thotë: “Nuk është ndonjë mëkat juaji ajo për çka keni gabuar, por (është mëkat) ajo që zemrat tuaja e bëjnë qëllimisht.” (Ahzab – 5), dhe fjala e All-llahut, subhanehu ve te'ala, “Tek All-llahu nuk arrin as mishi e as gjaku i tyre, por te Ai arrin bindja e juaj.” (Haxh – 37)

Ibën Abbasi r.a për kuptimin e këtij ajeti thotë: “...mirëpo tek Ai arrijnë nijetet e juaja” (Bustanul Arifin 23)

Të gjithë muslimanët njëmendësisht pohojnë vendin e lartë që ze ky hadith, dobite e shumta që nxirren nga ai dhe autenticitetin e tij. Imam Shafiu dhe dijetarët tjerë thonë: Ky hadith paraqet një të tretën e Islamit. Është argument për shtatëdhjetë kaptina të fikhut.

Disa të tjerë thonë: ky hadith paraqet një të katërtën e Islamit. Abdurahman ibën Mehdij thotë: Ai që mendon të shkruaj ndonjë libër duhet që të përmendë këtë hadith në fillim të librit për t'ia tërhequr vërejtjen kërkuesit të diturisë që të përmirësojë nijetin e tij. (Sahihul Muslim – sherh ennevevij, 13/53)

Nijeti është një nga elementet kryesore të moralit ngaqë çdo lëvizje apo moslëvizje vullnetare nuk kryhet pa tre gjëra: pa dije, dëshirë dhe vepër.

Veprat ndahen në tre grupe:

1 - vepra të mira (ta-at): vërtetësia e këtyre veprave dhe shumëfishimi i tyre është e lidhur ngushtë me nijetin.

2 - vepra që nuk qortohen e as lavdërohen (mubahat): gjithashtu këto vepra janë të lidhura ngushtë me nijetin, ato mund të bëhen vepra të mira apo të këqia varësisht prej nijetit.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: “kali për njeriun mund të jetë shpërblim, për dikend tjetër përmbushje e nevojës kurse për dikend mëkat.” (Buhariu)

3 - vepra të këqia (measi): këto vepra nuk ndërrojnë përmbajtjen e tyre për shkak nijetit. Nuk lejohet që ndonjë injorant të kuptojë nga hadithi “Veprat vlerësohen sipas nijetit” se punët e këqia (mëkatet) shndërrohen në punë të mira sipas nijetit, sikur ai që përgojon ndonjërin duke rrespektuar tjetrin, apo ai i cili ushqen një të varfër nga pasuria e huaj.

Nijeti ka fazat e tij, e ato janë:

1 – Ndërmendi apo pëshpërrima në vete: këtë njeriu nuk mund ta largojë nga vetvetja e tij. Allahu, subhanehu ve te’ala, me mëshirën dhe bujarinë e tij ia falë këtij ummeti gjërat që u bien ndërmend apo pëshpërrimën e shpirtit nëse ato nuk zënë vend tek ai duke u bazuar në hadithin e Pejgambërit a.s.: “Allahu ia falë ummetit tim atë që u pëshpërinë shpirtat nëse ata nuk e shprehin apo veprojnë.” (Buhariu)

2 – Synimi për të vepruar: në këtë fazë nëse njeriu synon të bëjë një vepër të mirë, ai shpërblehet edhe nëse nuk e vepron, e nëse e vepron shpërblehet me dhjetë të mira ose më tepër. Sa i përket veprave të këqia, aty gjejmë dallim. Ai i cili synon të bëjë një të keqe dhe nuk e bën, atij nuk i rregjistrohet asnjë mëkat, e nëse e braktisë synimin e tij për hir të All-llahut, ka një shpërblim. Nëse e vepron atë të keqe, i rregjistrohet një mëkat. Tërë kjo është nga mëshira e All-llahut ndaj robërve të tij. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: “All-llahu thotë: Kur robi im synon të bëjë një të keqe, mos e rregjistroni deri sa ta veprojë. Kur ta veprojë rregjitrioni aq sa ka bërë. Nëse e braktisë për hir Timin, rregjitrioni për të një të mirë. Kur robi im synon të bëjë një të mirë mirëpo nuk e vepron, rregjitrioni për të një të mirë, e nëse e vepron rregjitrioni për të dhjetë të mira deri në shtatëqind.” (Buhariu)

3 – Vendosmëria dhe ngulmimi për të vepruar: në këtë fazë – All-llahu e di më së miri – shpërblehet njeriu vetëm nëse paraqiten para tij pengesa objektive, jashtë dëshirës dhe fuqisë së tij dhe nuk kursen aspak mundin e tij për të vepruar atë të mirë. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në një rast duke udhëtuar për në Tebuk tha: “Njëmend disa njerëz që kanë mbetur pas nesh në Medine, nuk kemi kaluar ngushticë as luginë, e të mos jenë me ne. Ata i ka frenuar arsyeja.” Kurse në një transmetim tjetër qëndron: “na kanë shoqëruar në shpërblim” (Buhariu)

Lusim All-llahun e Madhëruar, Zotin e Arshit të nderuar që ta na i pastrojë nijetet tona, t’na i bëjë vetëm për hirë të Tij dhe punët tona të përkojnë me Ligjin e tij të drejtë.

Ahmed Muadh Hakkij

Përktheu: Agim Bekiri

(pjesë nga libri: katërdhjet hadithe mbi moralin)